



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

**RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE**

**“Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla”**

**Tiranë 2025**

	<b>Faqe</b>
<b>PËRMBAJTJA</b>	
<b>1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT</b> .....	<b>6</b>
1.1 Konteksti i problemit social.....	<b>6</b>
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	<b>6</b>
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	<b>6</b>
<b>2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM</b> .....	<b>7</b>
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	<b>7</b>
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	<b>11</b>
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	<b>14</b>
2.4 Pesha në buxhet.....	<b>14</b>
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia.....	<b>17</b>
2.6 Skema e analizës së programit auditues.....	<b>18</b>
2.7 Feedback-u i subjektit gjatë auditimit.....	<b>18</b>
<b>3. DETAJET E AUDITIMIT</b> .....	<b>19</b>
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	<b>19</b>
3.2 Objektivi i auditimit.....	<b>20</b>
3.3 Pyetjet e auditimit.....	<b>21</b>
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....	<b>21</b>
<b>4. SHITJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE</b> .....	<b>22</b>
4.1 A garanton kuadri ligjor rregullator kushte të përshtatshme për një ushtrim efektiv të rolit nga ana e oficerëve të sigurisë?.....	<b>22</b>
4.2 A i përgjigjet nevojave të shkollës aktiviteti i ushtruar nga oficerët e sigurisë?.....	<b>28</b>
4.3 A ka pasur koordinim, bashkëpunim dhe raportim efektiv midis institucioneve përgjegjëse, lidhur me aktivitetin e oficerëve të sigurisë?.....	<b>63</b>
<b>5. SHTOJCA</b> .....	<b>78</b>

## Lista e shkurtimeve

### **Shkurtimi    Emërtimi i Plotë**

<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>MAS</b>	Ministria e Arsimit dhe Sportit
<b>AS</b>	Akademia e Sigurisë
<b>DPPSH</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>ASCAP</b>	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar
<b>AKAP</b>	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar
<b>DPAP</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
<b>DRAP</b>	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
<b>ZVAP</b>	Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar
<b>AP</b>	Arsim Parauniversitar
<b>AMU</b>	Arsimi i Mesëm i Ulët
<b>AML</b>	Arsimi i Mesëm i Lartë
<b>SZHAPU</b>	Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026
<b>INTOSAI</b>	The International Organization of Supreme Audit Institutions
<b>EUROSAI</b>	The European Organisation of Supreme Audit Institutions
<b>OS</b>	Oficeri i sigurisë
<b>SPK - SPZ</b>	Specialisti i policimit në zonë - komunitet
<b>DVP</b>	Drejtoria Vendore e Policisë
<b>UNESCO</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën

## PËRMBLEDHJE

Mirëarsimimi mbetet themeli mbi të cilin ndërtohet jo vetëm e ardhmja e individit, por edhe e shoqërisë. Suksesi i këtij objektivi është i lidhur ngushtë edhe me sigurinë, që çdo nxënës dhe mësues të ndjehet i mbrojtur në mjedisin e përditshëm shkollor.

Menaxhimi i sigurisë në shkolla kërkon një ndërveprim të vazhdueshëm me nxënësit dhe stafin e shkollës, gjë të cilën policia nuk mund ta arrinte duke pasur parasysh natyrën sensitive të mjedisit shkollor. Për këtë arsye, duke synuar rritjen e sigurisë nëpërmjet ndërveprimit dhe parandalimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me anë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”<sup>1</sup>, krijuan një qasje të re nëpërmjet projektit “Shkolla të sigurta - Oficerët e Sigurisë në shkolla”.

Kjo qasje synonte të realizohej nëpërmjet krijimit të rolit të oficerit të sigurisë së shkollës. Projekti kishte si qëllim kryesor garantimin e një mjedisi të sigurt mes nxënësve brenda në shkollë, si dhe një mjedis të sigurt për ta në territorin e shkollës. Kjo qasje u vlerësua të realizohej nëpërmjet krijimit të rolit të oficerit të sigurisë së shkollës.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, ushtroi një auditim me temë “Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla”, për periudhën shtator 2021 – dhjetor 2024, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në institucionet e varësisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, ku u përfshinë dhe Drejtoritë Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucione e arsimit parauniversitar. Auditimi u shtri edhe në subjektet: Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Akademia e Sigurisë.

Nëpërmjet këtij auditimi u analizua veprimtaria e institucioneve të arsimit dhe atyre të ngarkuara me rendin publik, sipas roleve dhe përgjegjësi të gjithsecilit, për të vlerësuar nëse baza ligjore aktualisht në fuqi, politikat e parashikuara dhe praktikatat e ndjekura në vendin tonë, funksionojnë në krijimi i kushteve që nxënësit të ndjehen dhe të jenë të sigurtë në shkolla.

Në përfundim të auditimit u evidentua, se Ministria e Arsimit dhe Sportit, duhet të miratojë një udhëzues të veçantë, për mënyrën e përpunimit dhe përdorimit të të dhënave statistikore, lidhur me incidentet në shkolla dhe shërbimin e oficerëve të sigurisë, meqë statistikatat e prodhuara nga referimet e oficerëve të sigurisë në link – un e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, japin një panoramë të deformuar dhe të pavërtetë, lidhur me fenomenet dhe indikatorët e sigurisë në shkolla, duke krijuar premisa për një lexim të tjetërsuar të realitetit. Nga ana tjetër, Udhëzuesi për praktikën e punës së Oficerëve të Sigurisë e lë në diskrecion oficerëve të sigurisë, që “sipas vlerësimit të rastit” të vendosë nëse problematikën/incidentin t’ia raportojë policisë apo jo.

Miratimi i “Udhëzuesit për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë”, më datë 11.10.2023, e institucionalizoi edhe më tej rolin e oficerëve të sigurisë. Pavarësisht parashikimeve të qarta në Udhëzues, oficerët e sigurisë nga ana e tyre, nuk zhvillojnë kontrolle fizike të nxënësve ose të mjediseve, me përjashtim të ndonjë rasti sporadik. Po ashtu, përdorimi i pyetësorëve për nxënës, mësues dhe prindër, si instrumente matëse, ose mungon fare nëpër shkolla, ose edhe në rastet kur janë përdorur, nuk janë marrë rezultate dhe të dhëna, të cilat përcaktojnë ecurinë dhe nivelin e garantimit të sigurisë në shkollë. Komunikimi i oficerëve të sigurisë me drejtuesit e institucioneve arsimore, është informal dhe i padokumentuar, Procesi i planifikimit vjetor të veprimtarisë së oficerëve të sigurisë, në shumë raste mungon, sikurse dhe procesi i raportimeve të OS – së, referuar raporteve të incidenteve/problematikave,

---

<sup>1</sup> Miratuar me Nr. 2865/1 prot, më datë 01.06.2018 nga MB dhe MASR Nr, 6068 prot., më datë 01.06.2018 nga MAS

raporteve javore dhe vjetore, jo rrallë herë është i munguar, formal, i pasaktë, dhe i paplotë. Planet e masave për ndarjen e koordinuar të detyrave midis aktorëve të ndryshëm brenda shkollës, për trajtimin/zgjidhjen e problematikave të sigurisë, në të shumtën e rasteve mungojnë krejtësisht. Mungesa e logjistikës e ballafaqon oficerin e sigurisë me pamundësinë materiale për të ushtruar me efektivitet detyrimet funksionale. Të certifikuarit si oficerë sigurie, nuk shfaqin interes të punësohen në këtë detyrë.

Sa i përket procesit të koordinimit, emërtimi i njësisë, “Zyrë koordinimi dhe monitorimi” në MAS, DRAP e ZVAP, nuk është korrekt dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, meqë kjo “zyrë” nuk përfaqëson një strukturë të posaçme dhe si e tillë nuk parashikohet në rregulloret, ku do të përcaktoheshin edhe detyrat funksionale. AKAP, si institucion përgjegjës nuk ka siguruar të dhëna nga raportimi i bërë nga proceset e punës së oficerëve të sigurisë. Oficerët e sigurisë në shkolla nuk monitorohen, as nga drejtuesit e IAP-ve dhe as nga strukturat përkatëse të AKAP, DRAP dhe ZVAP. Raportet periodike vjetore të ASCAP, nuk janë shoqëruar me trajnime specifike, apo ofrimin e një ekspertize të plotë për strukturat politike, vendimmarrëse apo aktorët e tjerë të përfshirë në proces. Menaxhimi i dhunës fizike është i kufizuar, edhe për shkak të përgatitjes fizike dhe trajnimeve të pamjaftueshme që ofrohen në Akademinë e Sigurisë. DPPSH nuk ka respektuar afatin ligjor të përcaktuar në Urdhrin nr. 17, datë 10.01.2024, për lëshimin e vërtetimit të besueshmërisë,

Për këto arsye, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e varësisë nga njëra anë, sikurse dhe Ministria e Brendshme me institucionet e saj të varësisë, nga ana tjetër, duhet të inkurajojnë një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për të garantuar siguri në shkolla, duke ndërmarrë hapa në përmirësim të kuadrit rregullator, si dhe duke nxitur bashkëpunimin, monitorimin, raportimin dhe koordinimin, në mes të aktorëve të përfshirë në procesin, i cili ka si objektiv sigurinë në shkollat e vendit.

# **1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT**

## **1.1 Konteksti i Problemit Social**

Në vitet e fundit, siguria në shkolla është bërë një çështje me rëndësi të veçantë për komunitetet arsimore në mbarë botën. Në vendin tonë, problematikat që lidhen me sigurinë në shkolla në institucionet arsimore kanë tërhequr vëmendjen e publikut dhe të institucioneve përgjegjëse. Rritja e incidenteve të dhunshme, konfliktet, përdorimi i substancave të paligjshme, bullizimi, ngacmimet, siguria fizike, krizat në shkolla janë kthyer në një shqetësim serioz shoqëror, duke sinjalizuar nevojën për ndërhyrje më të strukturuar dhe efektive. Ky shqetësim i përgjithshëm i pasqyruar vazhdimisht edhe në media përfshin publikun, prindërit, komunitetin, të cilët janë të interesuar, që shkollat të jenë vende të sigurta dhe të qeta, ku nxënësit të kenë mundësi të mësojnë dhe të edukohen për t'u bërë qytetarë të denjë, të përgatitur për sfidat e botës së sotme dhe të ardhme, pa pasur frikë nga dhuna apo kërcënimet.

Prindërit duan që fëmijët e tyre të jenë të mbrojtur, stafi i shkollës kërkon një mjedis pune të sigurt dhe komuniteti lokal dëshiron një shkollë, që kontribuon në stabilitetin dhe mirëqenien e përgjithshme. Një nga masat kryesore të ndërmarra për të përmirësuar sigurinë në shkolla është vendosja e oficerëve të sigurisë. Këta profesionistë, luajnë një rol kyç në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të mbrojtur për nxënësit, stafin dhe komunitetin. Oficerët e sigurisë janë individë të trajnuar posaçërisht, për të menaxhuar dhe mbikëqyrur çështjet e sigurisë brenda institucioneve arsimore. Ata janë përgjegjës për parandalimin e incidenteve të dhunës, ndërhyrjen në situata emergjente, dhe bashkëpunimin me autoritetet lokale për të siguruar një ambient të qetë dhe të sigurt për të gjithë.

Në Shqipëri ky koncept, "Oficerët e sigurisë në shkolla", ka filluar të marrë formë më të strukturuar në vitet e fundit (nga viti 2019 e në vazhdim), duke krijuar politika dhe udhëzime specifike për rolin dhe përgjegjësitë, si dhe rritjen e numrit të tyre si nevojë e problematikave të sigurisë. Në një kohë, kur çështjet e të drejtave të fëmijëve janë në vëmendje të politikave të Bashkimit Evropian dhe mbrojtja dhe siguria e tyre zënë një vend të rëndësishëm në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, gjithë vëmendja fokusohet në garantimin e një mjedisi të sigurt për fëmijët në shkolla, nëpërmjet mbështetjes dhe ndërveprimit të të gjithë strukturave përkatëse.

Në këtë kontekst, ngjarjet e dhunës, konflikteve, bullizimeve etj, të pasqyruara në media, na shtojnë të auditojmë për të zbuluar, se deri në çfarë mase prania e oficerëve të sigurisë ka adresuar sfidat kryesore të këtyre problematikave, si dhe për të identifikuar hapësirat ku ka nevojë për përmirësim. Gjithashtu, është e rëndësishme të shqyrtohen me kujdes jo vetëm roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë, por edhe perceptimet sociale, si dhe mbështetja politike dhe ligjore që garanton suksesin e tyre, duke e pozicionuar atë jo vetëm si një element të rëndësishëm për sigurinë, por edhe si një qasje strategjike për të mbështetur një mjedis edukativ, të sigurt dhe gjithëpërfshirës.

## **1.2 Rëndësia e auditimit të performancës**

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që

marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet economiciteti, efienca dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027, miratuar me Vendimin nr. 247 datë 29.12.2022 të Kryetarit, KLSH ndërmori auditimin “Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla”, për periudhën shtator 2020-dhjetor 2024”, duke e konsideruar këtë proces si një ndër çështjet e më të ndjeshme të arsimit parauniversitar, me synim përmirësimin e sigurisë në shkolla dhe përreth tyre, për të garantuar një standard evropian dhe një formim me qytetari demokratike në shërbim të shoqërisë shqiptare. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me proceset e sigurisë në shkolla dhe rolin e oficerëve të sigurisë në sistemin arsimor. Në përfundim do të jepen rekomandimet përkatëse për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur.

### **1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në fushën e arsimit**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij audituese gjatë viteve të fundit i ka kushtuar një rëndësi gjithmonë e më të madhe auditimit të veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar një sërë auditimesh pranë subjekteve nën auditim, si më poshtë:

- Auditim përputhshmërie në zbatim të Programit të Auditimit nr.895/1, datë 14.10.2022 i ndryshuar miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 14.10.2022 deri në datë 30.11.2022, në subjektin Ministria e Arsimit dhe Sporteve (këtu e më poshtë MAS), u krye auditimi “Auditim tematik përputhshmërie” për periudhën nga 01.01.2021 deri në 30.06.2022.
- Auditimi i Performancës me temë: “Sistemi arsimor parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuara”, i miratuar në dhjetor 2023.
- Auditim përputhshmërie dhe auditim financiar të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, miratuar në prill 2022.
- Auditim performance me temë: “Orientimi për karrierë i nxënësve, në Sistemin Arsimor Parauniversitar Parauniversitar”, miratuar në shkurt 2025.

Gjetjet dhe konkluzionet e dokumentuara për këto auditime janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit.

## **2. SUBJEKTET NËN AUDITIM**

### **2.1 Hyrje në subjektet nën auditim**

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

1. Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS).
2. Ministria e Brendshme (MB)
3. Akademia e Sigurisë (AKS)
4. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH)
5. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP).
6. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar - AKAP (ish-Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar - DPAP).
  - Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP).

- Zyrat vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP).
- Institucione të Arsimit Parauniversitar.

### **Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS)**

Ministria e Arsimit dhe e Sportit është ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar. Ndër funksionet kryesore të ministrisë, sikurse përcaktuar në ligj janë: “zhvillimi i sistemit arsimor parauniversitar, nëpërmjet hartimit të politikave, programeve dhe projekteve të zhvillimit; hartimi, zbatimi dhe vlerësimi i ndikimit të kuadrit rregullator të sistemit arsimor parauniversitar; bashkëpunimi i ndërsjellë me institucionet, nëpërmjet marrëveshjeve dhe kontratave; përcaktimi i standardeve për politikën licencuese dhe kontrolluese të arsimit; financimi i sistemit arsimor parauniversitar, duke hartuar e zbatuar politikën e financimit, duke përcaktuar prioritete dhe kërkuar burime e forma të ndryshme financimi, që do të bënin të mundur realizimin e zhvillimit të arsimit, në përputhje me rregullat e përcaktuara”<sup>2</sup>.

Organigrama e MAS përfshin Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, si edhe Zyrën e Koordinimit dhe Monitorimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”, krijuar me urdhrin nr. 531, datë 04.09.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për ngritjen e zyrës së koordinimit dhe monitorimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike””, të ndryshuar. Gjatë periudhës 2020-2022 kjo zyrë ka pasur për detyrë, si më poshtë:

- a. Të hartojë kriteret mbi të cilat do të aplikojnë kandidatët për oficerë të sigurisë;
- b. Të përcaktojë procedurat e aplikimit për kandidatët për oficerë të sigurisë;
- c. Të përzgjedhë kandidatët për oficerë të sigurisë që do të kryejnë testimin me shkrim, intervistën përkatëse dhe të dërgojë këtë listë me shkrim në Akademinë e Sigurisë;
- d. Të dërgojë në Akademinë e Sigurisë, listën e kandidatëve të oficerëve të sigurisë që do të marrin pjesë në trajnim, testim dhe pajisjen me certifikata vlerësimi;
- e. Të propozojë institucionet e arsimit të mesëm të lartë publik ku do të punojnë oficerët e sigurisë për vitin 2019;
- f. Të raportojë çdo muaj te ministri përgjegjës për arsimin për ecurinë e zbatimit të marrëveshjes.

Me Urdhrin nr. 541, datë 15.09.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për ngritjen e zyrës së koordinimit dhe monitorimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”, i ndryshuar, kjo zyrë ka pasur për detyrë, si më poshtë:

- a. Të koordinojë dhe monitorojë zbatimin e detyrimeve të ministrisë përgjegjëse për arsimin, të parashikuara në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”, nr. 6068 prot., datë 01.06.2018”;
- b. Të organizojë dhe realizojë procedurat për rekrutimin e oficerëve të sigurisë në shkolla;
- c. Të koordinojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, për procedurat e punësimit dhe lëvizjen paralele të oficerëve të sigurisë;
- d. Të koordinojë dhe bashkëpunojë me Akademinë e Sigurisë dhe organizatat partnere për planifikimin e trajnimeve për oficerët e sigurisë;
- e. Të raportojë te ministri përgjegjës për arsimin dy herë në vit, për ecurinë e zbatimit të marrëveshjes.

<sup>2</sup> Ligji Nr. 69 i miratuar në datën 23.7.2018 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 56/2015 dhe Ligjin nr. 48/2018.

### **Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)**

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) është institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin parauniversitar, i cili funksionon sipas strukturës së miratuar me Urdhër nr. 69, datë 5.4.2019, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”.

“Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar ka përgjegjësi të:

- a) organizojë punën për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor parauniversitar, publik dhe privat;
- b) organizojë zhvillimin profesional dhe kualifikimin e punonjësve arsimorë, publikë dhe privatë;
- c) monitorojë sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, publik dhe privat, si dhe programet e tyre mësimore;
- ç) sigurojë zhvillimin e kurrikulës në arsimin parauniversitar, publik dhe privat”<sup>3</sup>.

ASCAP ka katër drejtori:

- Drejtoria e Performancës
- Drejtoria e Kurrikulës dhe e Kualifikimit
- Drejtoria e Vlerësimit të Cilësisë
- Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

**Drejtorja e Performancës** kryen detyrat, si më poshtë:

Vlerëson performancën e sistemit arsimor parauniversitar, efektshmërinë dhe eficiencën e masave, si dhe përmbushjen e objektivave;

Harton dhe i propozon Drejtorit të Përgjithshëm standarde, protokolle, rregulla për ofrimin e shërbimeve arsimore, si dhe vlerëson impaktin e tyre në këto shërbime;

Harton Raportet e Monitorimit të Performancës për periudhën, 4 (katër) mujore, 8 (tetë) mujore dhe vjetore mbështetur në tregues performancë të miratuara në planin vjetor të veprimtarisë dhe pas miratimit nga Drejtorit të Përgjithshëm i boton ato në faqen zyrtare të institucionit.

**Drejtorja e Kurrikulës dhe e Kualifikimit** kryen detyrat, si më poshtë:

Harton dhe boton udhëzues kurrikularë, si dhe materiale mbështetëse për zbatimin e kurrikulës në nivel kombëtar;

Vlerëson nevojat për zhvillim profesional, programet kombëtare dhe materialet mbështetëse për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;

Harton programe kombëtare orientuese për kualifikimin dhe zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar;

Realizon punë kërkimore-studimore, analiza periodike dhe u ofron ekspertizë strukturave politike e vendimmarrëse për politikën arsimore dhe reformat në fushën e arsimit parauniversitar;

Bashkërendon veprimtarinë e saj me drejtoritë dhe sektorët e tjerë të ASCAP-it, me ministrinë përgjegjëse për arsimin, si dhe me institucione të tjera të të gjitha niveleve brenda dhe jashtë vendit, për realizimin cilësor të detyrave të saj.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar<sup>4</sup> në kuadër të detyrave të veta të përgjithshme, për OS kryen detyrat si më poshtë vijon:

- a. Kryen analiza të ndryshme dhe raporte periodike vjetore mbi rezultatet e punës së oficerëve të sigurisë dhe shpërndan informacionin në strukturat përgjegjëse;
- b. Realizon punë kërkimore-studimore, analiza periodike dhe u ofron ekspertizë strukturave politike e vendimmarrëse për politikën arsimore dhe reformat në fushën e arsimit parauniversitar;

<sup>3</sup> VKM Nr. 98, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”.

<sup>4</sup> Informacioni i dërguar nga ASCAP.

- c. Harton dhe i propozon ministrit për miratim standarde, protokolle, rregulla për ofrimin e shërbimeve arsimore si dhe vlerëson impaktin e tyre në këto shërbime; ku në vitin 2023 është hartuar “Praktika e punës së oficerëve të sigurisë” dhe është miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- d. Mbështet rritjen profesionale të oficerëve të sigurisë përmes trajnimeve me fokus të ndryshëm.

### **Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar – AKAP (ish - Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar - DPAP)**

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar - AKAP (Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar - DPAP), Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar - DRAP) dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar – ZVAP, janë krijuar me VKM nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.

AKAP ka për mision ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes.

“DPAP-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në:

- a) nivel qendror, nëpërmjet *drejtorisë qendrore*;
- b) nivel rajonal, nëpërmjet *drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar*;
- c) njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë *zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar publik*”<sup>5</sup>.

“DPAP ka këto përgjegjësi:

1. Të ofrojë shërbim cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
2. Të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Të koordinojë administrimin e burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar publik, sipas legjislacionit në fuqi...”<sup>6</sup>.

Ministria e Arsimit dhe e Sportit përfaqësohet në nivel rajonal nga *Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar – DRAP-et*, të cilat janë në varësi administrative të AKAP.

*ZVAP-et* funksionojnë si njësi e ofrimit direkt të shërbimeve dhe janë në varësi administrative të DRAP-ve.

### **Ministria e Brendshme**

Bazuar në Marrëveshjen nr. 2865/1 Prot., datë 01.06.2018 dhe nr. 6068, Prot., datë 01.06.2018, ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”, MB ka për detyrë:

1. Ministria e Brendshme, nëpërmjet Akademisë së Sigurisë i trajnon kandidatët e përzgjedhur në një periudhë intensive 1 (një) mujore në Akademinë e Sigurisë.
2. Kurrikula për trajnimin e oficerit të sigurisë d të zhvillohet nga Akademia e Sigurisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Urdhri i Psikologut, në konsultim me partnerët.

<sup>5</sup> VKM nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar

<sup>6</sup> VKM nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar

3. Akademia e Sigurisë si institucioni përgjegjës i vetëm për arsimin e lartë policor, që ka për qëllim formimin, socializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe ofrimin e specializimeve dhe kualifikimeve për institucione të tjera të zhatimit të ligjit, për personat fizik dhe juridik, në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, do të përgatisë dhe trajtojë oficerët e sigurisë.
4. Akademia e Sigurisë do të përgjigjet për ofrimin e specializimeve dhe kualifikimeve, për institucionet e tjera dhe për personat fizikë, si dhe për punonjësit e personave juridikë, në fushën e rendit dhe sigurisë publike.
5. Akademia e Sigurisë do të ofrojë programe studimi për specializimin e oficerëve të sigurisë në shkollë, në fushën e rendit dhe sigurisë publike.
6. Akademia e Sigurisë, në përfundim të trajnimit, do të realizojë testimin dhe pajisjen me certifikata vlerësimi të oficerëve të sigurisë, në bashkëpunim me Zyrën e Koordinimit dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
7. Ministria e Brendshme në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të kryejë verifikimin e figurës së oficerit të sigurisë.

### **Akademia e Sigurisë<sup>7</sup>**

1. Akademia e Sigurisë është përgjegjëse për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, si dhe të personelit të strukturave të agjencive të tjera ligjzbatuese.
2. Akademia e Sigurisë ka liri akademike, autonomi financiare dhe organizative, sipas përcaktimit të ligjit për arsimin e lartë dhe organizohet e funksionon sipas parashikimeve të ligjit për arsimin e lartë.
3. Programet e studimit miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin sipas legjislacionit në fuqi, duke respektuar statusin e veçantë të Akademisë së Sigurisë.
4. Dëshmitë dhe certifikatat e përftuara në institucionet brenda dhe jashtë vendit në fushën e rendit e të sigurisë publike, në bazë të marrëveshjeve dhe që nuk mund të njihen e njësohen sipas legjislacionit për arsimin e lartë, njihen dhe njësohen në Akademinë e Sigurisë.

### **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është struktura qendrore administrative dhe teknike e policisë dhe kryen këto detyra:

- a) Menaxhon veprimtarinë e Policisë;
- b) Bashkërendon veprimtarinë mes strukturave për:
  - i) hartimin dhe zbatimin e strategjive për realizimin e përgjegjësive të Policisë së Shtetit;
  - ii) hartimin dhe zbatimin e planeve për rekrutimin, arsimimin dhe trajnimin e punonjësve të policisë;
  - iii) vënien në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare për çështje që lidhen me Policinë;
- g) përpunon dhe analizon të dhënat e mbledhura nga Policia deri në masën që është e nevojshme për përmbushjen e detyrave e të funksioneve të saj;
- h) njofton Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për llojin e të dhënave që krijon dhe administron policia, për qëllimin e këtij ligji.

## **2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim**

### **2.2.1 Kriteret politike:**

- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026<sup>8</sup>

<sup>7</sup> Statuti i Akademisë së Sigurisë

<sup>8</sup> Miratuar me VKM 621, datë 22.10.2021

- Strategjia ndërsektoriale e sigurisë në komunitet 2021–2026 dhe plani i veprimit 2021–2023”<sup>9</sup>.
- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”<sup>10</sup>
- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë<sup>11</sup> dhe Ministrisë së Brendshme<sup>12</sup> për zbatimin e Programit "Siguria e të rinjve" në shkollat 9-vjecare dhe të mesme
- Paketa e Sigurisë në Shkolla<sup>13</sup>

## 2.2.2 Kriteret teknike dhe të monitorimit

*Ligje, akte nënligjore dhe administrative:*

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 154/2014 “ Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”
- Ligji nr. 69 /2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar<sup>14</sup>
- Ligji nr.82/2024 “Për policinë e shtetit”<sup>15</sup>
- Kodi i drejtësisë Penale për të mitur<sup>16</sup>
- Vendim nr. 600, datë 9.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, i ndryshuar<sup>17</sup>
- Udhëzues për praktikën e punës së Oficerëve të sigurisë <sup>18</sup>
- Manuali i riskut të Institucioneve arsimore parauniversitare ASCAP 2023<sup>19</sup>
- Rregullore "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar
- Rregullore e Policisë së Shtetit<sup>20</sup>
- VKM nr. 98, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP).
- VKM nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar” i ndryshuar<sup>21</sup>
- Urdhër nr. 68, datë 5.4.2019, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar”
- Udhëzimi i Përbashkët nr.17, datë 16.08.2021 MAS dhe MFE, “Për vitin shkollor 2021-2022, në Sistemin Arsimor Parauniversitar”.

<sup>9</sup> Miratuar me VKM nr. 1139, datë 24.12.2020

<sup>10</sup> Shkresa nr. 6068 prot., datë 01.06.2018

<sup>11</sup> Shkresa nr.831/1 prot., datë 07.02.2022

<sup>12</sup> Shkresa nr. 1337/2 prot., datë 18.02.2022

<sup>13</sup> iniciuar nga Ministri i Brendshëm në takimin me drejtuesit e Ministrisë së Brendshme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe drejtuesit e Policisë së Shtetit, me datën 01.09.2023.

<sup>14</sup> Ndryshuar me Ligj, Nr.56/2015, dt. 28.05.2015, dhe ligjin nr. 48, datë 23.07.2018

<sup>15</sup> VKM Nr. 129, datë 6.3.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”. Ndryshuar emërtimi institucionit në Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP)

<sup>16</sup> Ligji nr.37/2017

<sup>17</sup> Vendim Nr. 553, datë 29.7.2022

<sup>18</sup> Miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të arsimit

<sup>19</sup> Miratuar nga Ministri me shkresën nr.317/2 datë 19.05.2023

<sup>20</sup> Miratuar me VKM nr.750 datë 16.09.2015, ndryshuar me VKM nr.1143 datë 09.12. 2020

<sup>21</sup> Miratuar me shkresën nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019 , nga MAS

- Udhëzimi i Përbashkët nr.22, datë 27.07.2022 MAS dhe MFE, “Për vitin shkollor 2022-2023, në Sistemin Arsimor Parauniversitar”.
- Udhëzimi i Përbashkët nr.15, datë , 24.07.2023 MAS dhe MFE, “Për vitin shkollor 2023-2024, në Sistemin Arsimor Parauniversitar”.
- Udhëzimi i Përbashkët nr.13, Datë 10.07.2024 MAS dhe MEKI, “Për vitin shkollor 2024-2025, në Sistemin Arsimor Parauniversitar”. Neni 13, Pika 1, gërmat a, b, c, d, pika 2.
- Urdhër nr. 69, datë 5.4.2019, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”.
- Urdhër nr. 144, datë 16.12.2021, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.
- Urdhër nr. 215, datë 13.12.2023, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”
- Urdhër nr. 31, datë 28.1.2020, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Urdhër nr. 32, datë 28.1.2020, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit për miratimin e rregullores “ Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit ASCAP”
- Urdhër nr. 234, datë 19.04.2019, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”.
- Urdhër nr. 689, datë 15.11.2022 e Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin Rregullores së Brendshme të MAS”.
- Urdhër nr. 531, datë 04.09.2018 “Për ngritjen e zyrës së koordinimit dhe monitorimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike””.
- Urdhër nr. 541, datë 15.09.2022 “Për ngritjen e zyrës së koordinimit dhe monitorimit për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”
- Urdhër nr. 542, datë 15.09.2022 “Për përcaktimin e institucioneve të arsimit parauniversitar të cilat do të kenë oficer sigurie”.
- Urdhër nr. 592, datë 06.12.2024 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 589, datë 03.12.2024 “Për përcaktimin e institucioneve të arsimit parauniversitar të cilët kanë shërbimin e sigurisë publike”
- Urdhër nr. 1239 datë 31.08.2023, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së shtetit “Për marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në institucionet arsimore publike e jo publike gjatë vitit shkollor 2023-2024.
- Urdhër nr. 1240 datë 31.08.2023, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së shtetit për zbatimin e programit “Siguria e të rinjve”
- Urdhër nr.1267, datë 07.09.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së shtetit “Për caktimit e përfaqësuesve të Policisë së Shtetit, si koordinatorë me autoritetet përkatëse të MAS”
- Urdhër nr.1200, datë 02.09.2024, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për marrjen e masave për rendin e sigurinë publike në institucionet arsimore publike e jo publike me rastin e fillimit të vitit mësimor 2024-2025”
- Urdhër nr. 593, datë 06.12.2024 “Për shpalljen e vendeve vakante për oficerë sigurie në institucionet e arsimit parauniversitar”
- Urdhër nr. 598, datë 5.10.2022 “Për përcaktimin e mënyrës dhe afatit të dorëzimit të dokumentacionit, si dhe për procedurat e konkurrimit për pozicionin vakant të oficerit të sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar”.

- Akte të tjera që mund të dalin gjatë auditimit.

*Kriteret e monitorimit dhe raportimit:*

- ✓ Raporte vjetore monitorimi të buxhetit,
- ✓ Analiza vjetore ASKAP, AKAP, DPPSH
- ✓ Raporte vjetore për OS nga ASCAP
- ✓ Raporte inspektimi të AKAP
- ✓ Raport monitorimi mbi zbatimin e strategjisë Qëndresa Qytetare

*Kriteret e tjera/Praktikat më të mira:*

*Konventa Evropiane për të drejtat e Fëmijëve*

Plani i veprimit për sigurinë në shkolla 2023-2026 Kosova

### **2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit**

Dokumentet kryesore të përgatitura për oficerët e sigurisë në shkolla janë: Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet MAS dhe MB, nr. 6068 prot., datë 01.06.2018 “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”, VKM nr. 600, datë 9.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, e ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore për këtë proces. Në zbatim të tyre hartohen dokumentet e punës së oficerit të sigurisë dhe garantohej një mësimdhënie cilësore në mjedise të sigurta në shkolla. Oficeri i sigurisë, për shkak të natyrës së punës së tij, ka një mundësi unike për të ndikuar pozitivisht tek të rinjtë në shkollë. Integriteti, profesionalizmi dhe diskrecioni, për vetë natyrën delikate të kësaj detyre, janë vlera të panegociueshme dhe garantojnë suksesin në kryerjen e saj..

*Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë ndikon në:*

- Krijimin e Rrethit të Sigurisë nëpërmjet parandalimit të dukurive negative që në gjenezë në bashkëpunim me stafin pedagogjik, shërbimin psiko-social të shkollës dhe prindërit.
- Forcimin e bashkëpunimit me oficerët e policimit në komunitet.
- Përmirësimin e perceptimit të oficerit të sigurisë në mesin e të rinjve.
- Përmirësimin e marrëdhënieve midis nxënësve dhe policisë.

Në zbatim të Urdhrit nr. 31, datë 28.1.2020 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar si dhe drejtoritë e institucioneve të arsimit parauniversitar, ngarkohen me përgjegjësi të posaçme për menaxhimin e procesit dhe oficerët e sigurisë në shkolla. Oficerët e sigurisë zhvillojnë veprimtari ndërgjegjësuë/informuese, sipas planifikimit vjetor, udhëzimit të fillimit të vitit shkollor si dhe rregullores së brendshme të shkollës.

### **2.4 Pesha në buxhet**

Ministria e Arsimit dhe e Sportit është ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar. Ndër funksionet kryesore të ministrisë, sikurse përcaktuar në ligj janë: “Zhvillimi i sistemit arsimor parauniversitar, nëpërmjet hartimit të politikave, programeve dhe projekteve të zhvillimit; hartimi, zbatimi dhe vlerësimi i ndikimit të kuadrit rregullator të sistemit arsimor parauniversitar; bashkëpunimi i ndërsjellë me institucionet, nëpërmjet marrëveshjeve dhe kontratave; përcaktimi i standardeve për politikën licencuese dhe kontrolluese të arsimit; financimi i sistemit arsimor parauniversitar, duke hartuar e zbatuar politikën e financimit,

duke përcaktuar prioritete dhe kërkuar burime e forma të ndryshme financimi, që do të bënin të mundur realizimin e zhvillimit të arsimit, në përputhje me rregullat e përcaktuara”<sup>22</sup>.

Referuar VKM-së nr. 600, datë 9.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë”, i ndryshuar, “Numri i oficerëve të sigurisë dhe shpenzimet përkatëse përballohen brenda numrit total të punonjësve dhe fondeve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë<sup>23</sup>, institucioni i vetëm i angazhuar financiarisht mbetet Ministria e Arsimit dhe Sportit

Për periudhën në fokus auditimi, (shtator 2021-dhjetor 2024), Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përfutur fonde buxhetore, sikurse pasqyruar në tabelën më poshtë, duke vënë dispozicion të oficerëve të sigurisë, si fonde pagash, një pjesë të tyre, e cila varion nga 0.4%, deri në 0,6% të totalit të fondeve, akorduar këtij institucioni. Pagat për periudhën shtator 2021-30 qershor 2024, janë përlllogaritur sipas, VKM nr. 175, datë 8.3.2017, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar, ndërsa pagat për periudhën korrik 2024-31 dhjetor 2024, janë përlllogaritur sipas VKM nr. 425, datë 26.06.2024, “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar dhe punonjësve të tjerë jo mësimorë, në institucionet arsimore dhe në institucionet arsimore plotësuese të sistemit asimor parauniversitar”.

**Tabela 1: Buxheti i MAS dhe ai i dedikuar për Oficerët e Sigurisë (OS), për periudhën 01.09.2021-31.12.2024**

							<i>në lekë</i>
<i>Nr.</i>	<i>Periudha</i>	<i>MAS Buxheti i programuar</i>	<i>MAS Buxheti faktik</i>	<i>Buxheti i programuar dedikuar për OS</i>	<i>Buxheti faktik dedikuar për OS</i>	<i>Pesha që zë në % buxheti i programuar për OS / MAS</i>	<i>Pesha që zë në % buxheti faktik për OS / MAS</i>
1	01.09.21-31.12.21	9,324,963,165	9,304,775,896	45,372,960	39,625,718	0,5%	<b>0,4%</b>
2	01.01.2022-31.12.2022	28,160,653,979	28,153,236,793	186,256,001	164,476,980	0,7%	<b>0,6%</b>
3	01.01.2023-31.12.2023	29,725,462,574	29,634,773,560	200,548,483	186,029,136	0,7%	<b>0,6%</b>
4	01.01.2024-31.12.2024	33,661,138,785	33,600,144,315	221,672,117	199,943,510	0,7%	<b>0,6%</b>


Burimi: MAS

Përpunoi: Grupi i auditimit

<sup>22</sup> Ligji Nr. 69 i miratuar në datën 23.7.2018 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 56/2015 dhe Ligjin nr. 48/2018

<sup>23</sup> Vendim nr. 600, datë 9.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë”, i ndryshuar, paragrafi 7.


**Grafiku 1: Buxheti total i MAS**



Burimi: MAS

Përpunoi: Grupi i auditimit


**Grafiku 2: Buxheti i dedikuar për OS**



Burimi: MAS

Përpunoi: Grupi i auditimit

**Grafikn 3: Përqindja që zë buxheti i programuar për OS, në raport me atë të MAS.**



Burimi: MAS

Përpunoi: Grupi i auditimit

## 2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

Në kuptim të këtij auditimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

“Arsimi parauniversitar”, përfshin nivelet arsimore me kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas “Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit”, të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në sesionin e 29-të të saj, në nëntor 1997, përkatësisht: a) “Niveli me kodin 0”, arsimi parashkollor; b) “Niveli me kodin 1”, arsimi fillor; c) “Niveli me kodin 2”, arsimi i mesëm i ulët; ç) “Niveli me kodin 3”, arsimi i mesëm i lartë<sup>24</sup>.

“Institucion arsimor” është kopshti ose shkolla.

“Specialisti i policimit në komunitet”, (SPK) në komisariatit e policisë është punonjës policie i nivelit të parë drejtues në PSH dhe përfaqëson strukturën administrative, operacionale me përgjegjësi për drejtimin e punës në zonën që mbulon.

“Policia e Shtetit”, (PSH) është institucion i administratës shtetërore, person juridik në varësi administrative të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike.

“Ministria e Brendshme”, është ministri përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

“Plan vjetor”, është forma e cila do të përshkruaj objektivat e punës së oficerit të sigurisë dhe treguesit të përmbushjes së secilit objektiv.

“Akademia e Sigurisë”, institucioni përgjegjës i vetëm për arsimin e lartë policor, që ka për qëllim formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe ofrimin e specializimeve e të kualifikimeve për institucione të tjera të zbatimit të ligjit, për personat fizikë dhe juridikë në fushën e rendit e të sigurisë publike, të përgatitës dhe trajnojë oficerët e sigurisë për institucionet e arsimit parauniversitar.

<sup>24</sup>Ligji Nr. 69 i miratuar në datën 23.7.2018 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 56/2015 dhe Ligjin nr. 48/2018..

“Drejtoria Vendore e Policisë”, është strukturë administrative e policisë në nivel vendor, që kryen veprimtari operacionale dhe hetimore në nivel vendor, mbikëqyr dhe kontrollon kryerjen e detyrave, si dhe bashkërendon veprimtarinë e strukturave në varësi.

“Komisariati dhe stacioni i policisë”, është strukturë bazë operacionale në varësi të drejtorisë vendore të policisë dhe ushtron përgjegjësitë e policisë në territorin që ka në juridiksion.


“Kurrikula”, është sistem i përbërë nga disa elemente, si: korniza, kurrikulare, kurrikula bërthamë, programet mësimore, vlerësimi, që, të lidhura mes tyre, lejojnë të orientohet dhe të funksionojë sistemi arsimor, nëpërmjet planeve arsimore dhe administrative. Kurrikula siguron arsimim cilësor dhe të barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, seksi, pozita shoqërore.

## 2.6 Skema e analizës së programit auditues

Ky auditim do të fokusohet në analizimin e politikave dhe veprimtarive për rolin dhe efektivitetin e oficerëve të sigurisë në arsimin parauniversitar, duke patur parasysh rolet dhe detyrat e subjekteve, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, duke u fokusuar veçanërisht në:

- Në nevojën e një vizioni të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit për oficerët e sigurisë në AP;
- Në nevojën e hartimit të politikave që garantojnë një proces efektiv për rolin e oficerëve të sigurisë në shkolla;
- Nevojën për alokime buxhetore dhe vënien në dispozicion të kapaciteteve njerëzore, në mbështetje të procesit të sigurisë në shkolla;
- Rolin dhe përgjegjësinë që kanë strukturat;
- Sistemin e raportimit, kontrollit dhe monitorimit të punës së oficerëve të sigurisë në shkolla.

Figura 1: Skema e analizës së programit auditues



## 2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore

Gjatë fazës studimore, subjektet nën auditim, i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë takimeve prezantuese dhe konsultuese, gjithashtu dhe i janë përgjigjur në të njëjtën mënyrë plotësisht të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, që lidhet me vjeljen e të dhënave paraprake.

Vlen të theksohet gatishmëria e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar (ASCAP), Akademisë së Sigurisë, Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e përgjithshme e Policisë së Shtetit, gjatë gjithë fazës studimore në lidhje me kërkesat e grupit të auditimit.

### **3. DETAJET E AUDITIMIT**

#### **3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit**


Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten në veprimtarinë e subjekteve nën auditim, që lidhen me fushën e sigurisë kibernetike. Analiza SWOT është një kornizë që përdoret për të identifikuar dhe analizuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten lidhur me çështjen që trajtohet. Analiza SWOT është e dizajnuar për të ofruar një qasje realiste, të bazuar në fakte dhe të dhëna e cila përdor burime të brendshme dhe të jashtme dhe përdoret si një teknikë për të vlerësuar performancën, risqet dhe mundësitë potenciale për zhvillim dhe arritjen e objektivave. Për kryerjen e analizës grupi i auditimit ka përcaktuar objektivin që synohet të arrihet përmes këtij auditimi, ka mbledhur të dhëna dhe evidenca dhe ka bashkërenduar mendimet dhe konceptet e secilit prej anëtarëve të grupit.

U përzgjedh përdorimi i analizës SWOT nisur nga fakti që kjo analizë ofron mundësinë e mirë menaxhimit të një problemi kompleks siç është efektiviteti i oficerëve të sigurisë.

Duke iu referuar evidentimit të fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve të paraqitur në analizën SWOT, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda kontrollit dhe jashtë kontrollit menaxherial.

Gjithashtu është bërë edhe kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional.

**Figura 2: Analiza SWOT**



Burimi: Grupi i auditimit

**Tabela 2: Analiza e Riskut**

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
	Përcaktim jo i qartë i roleve dhe përgjegjësi të strukturave që janë në mbështetje të OS	<b>Risk Strategjik</b>	I lartë
	Institucionalizim i pamjaftueshëm dhe i vonuar i procesit, që ka sjellë në kapërcim të kompetencave.		I lartë
	Logjistikë e pamjaftueshme	<b>Risk Financiar</b>	I mesëm
	Monitorim dhe koordinim i pamjaftueshëm midis aktorëve institucionalë të përfshirë në proces.	<b>Risk Operacional</b>	I lartë
	Formalizmi në raportime dhe mosunifikimi i tyre në praktikë, sjell analiza jo të thelluara.		I lartë
	Ndërgjegjësim i pamjaftueshëm rreth rolit të OS.		I mesëm
	Mosrespektimi i afateve ligjore në rekrutimin e OS-ve.		I lartë
	Mungesë OS në disa shkolla.		I mesëm

Burimi: Grupi i Auditimit


### 3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Roli dhe efektiviteti i oficerit të sigurisë në shkolla”, për periudhën shtator 2021- dhjetor 2024”, ka si objektivi kryesor të vlerësojë dhe analizojë efektivitetin e mekanizmave të ngritura nga institucionet përgjegjëse, lidhur me sigurinë e nxënësve në shkolla.

Në këtë mënyrë do të synohet të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi nëse rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve janë të qarta, nëse strukturat aktuale, si dhe veprimtaria zhvilluar prej tyre garantojnë një ofrim efektiv të oficerëve të sigurisë në sistemin e arsimit parauniversitar.

### 3.3 Pyetjet e auditimit

Figura 3: Piramida e pyetjeve audituese



### 3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim do të ketë si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një opinionimi mbi ecurinë e rolit të oficerëve të policisë të inkuadruar në sistemin e arsimit parauniversitar. Auditimi për shkak të kompleksitetit të tij do të ketë një qasje në nivel makro duke parë nga perspektiva e detyrimeve që subjektet kanë në lidhje me këtë proces.

Periudha e auditimit do të jetë shtator 2021 – dhjetor 2024. Gjatë këtij auditimi do të fokusohemi në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e shumë institucioneve të arsimit parauniversitar, të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit, Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Akademisë së Sigurisë. Numri i lartë i institucioneve që do i nënshtrohen auditimit, do krijojë kushte për të pasur një panoramë më të plotë lidhur me fokusin e auditimit.

Bazuar në sa më sipër, auditimi do fokusohet në përgjegjësitë dhe veprimtarinë e subjekteve, lidhur me oficerin e sigurisë në shkolla në arsimin parauniversitar, duke pasur mundësi të vlerësojmë shkallën e zbatimit të politikave qeveritare, sipas parashikimeve në Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit 2021 – 2026.

#### 4. SHITJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE

**Pyetja kryesore: A është garantuar siguria në shkolla, përgjatë periudhës shtator 2021 – dhjetor 2024, nga oficerët e sigurisë?**

##### Mesazhi i auditimit

Siguria në shkolla përgjatë periudhës shtator 2021 – dhjetor 2024, ka rezultuar një proces jo efektiv, si rezultat i mangësive të kuadrit rregullator, mos ushtrimit siç duhet i rolit të oficerëve të sigurisë, e mungesës së monitorimit të tyre, si dhe mos koordinimit të institucioneve pjesë e këtij procesi.

Kuadri rregullator, nuk ka përcaktuar rregulla të qarta sa i përket, mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave mbi incidentet në shkolla.

Aktiviteti i ushtruar nga oficerët e sigurisë, nuk u përgjigjet nevojave të shkollës, sepse nuk përdoren “instrumente matës” për të njohur këto nevoja dhe nuk ushtrohen kontrole fizike të nxënësve ose mjediseve të shkollave. Raportimi zyrtar midis aktorëve pjesë e këtij procesi ka mangësi të theksuara duke rezultuar i pa saktë e i pa plotë. Mos mbulimi i të gjitha shkollave me oficerë sigurie ka cënuar gjithashtu sigurinë në shkolla.

Koordinimi dhe bashkëpunimi midis Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe Akademisë së Sigurisë, nuk është në nivele të duhura. Oficerët e sigurisë në shkolla nuk monitorohen, as nga drejtuesit e IAP-ve dhe, as nga strukturat përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar. Pavarësisht problematikave të konstatuara mbi sigurinë në shkolla, inkurajohet ndjekja dhe zbatimi e rekomandimeve të lëna në këtë auditim, me qëllim përmirësimin e situatës në tërësi.

#### 4.1 A garanton kuadri ligjor rregullator kushte të përshtatshme për një ushtrim efektiv të rolit nga ana e oficerëve të sigurisë?

Siguria në shkolla në vendin tonë është një aspekt i rëndësishëm, që synon krijimin e një mjedisi të qetë dhe të sigurtë për zhvillimin akademik dhe social të nxënësve.

Në këtë kontekst, është shumë pozitive që Shqipëria ka ndërmarrë hapa konkretë ligjor për të integruar shërbimin e oficerëve të sigurisë në sistemin arsimor, duke e konsideruar një praktikë që garanton sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve në institucionet arsimore. Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në vendin tonë oficerët e sigurisë në shkolla kanë përgjegjësi për garantimin e një mjedisi të sigurt për nxënësit brenda dhe rreth shkollës, monitorimin e mjediseve për minimizimin e risqeve dhe përmirësimin e marrëdhënieve me komunitetin duke përfshirë policimin lokal, stafin pedagogjik dhe prindërit.<sup>25</sup>

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ka iniciuar projekti “Shkolla të sigurta – Oficerët e Sigurisë

<sup>25</sup> Udhëzues i praktikës së punës së oficerëve të sigurisë në shkolla miratuar me shkresën nr. , ASCAP viti 2023 ( faqe 10)

në shkolla”.<sup>26</sup> Vendosja e oficerëve të sigurisë në shkolla është iniciuar fillimisht si projekt pilot më 15 mars 2018 në gjimnazet e Tiranës duke përfshirë dislokimin e oficerëve të trajnuar posaçërisht nga Akademia e Sigurisë. Pas pilotimit projekti është zgjeruar edhe në shkollat e tjera të vendit. Shërbimi i sigurisë publike në shkolla në vendin tonë është formalizuar si shërbim në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe pozicioni; përcaktimi i kriterëve ligjore; rekrutimi; numri dhe shpërndarja e oficerëve të sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar është rregulluar me akt nënligjor në tetor të vitit 2018.<sup>27</sup> Në mars të vitit 2019 ka nisur procesi i rekrutimit të grupit të parë të oficerëve të sigurisë në shkolla që do të përmbushnin detyrat e tyre bazuar në një strukturë ligjore.<sup>28</sup>

Në kuadër të zbatimit të programit “Siguria e të rinjve”, ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Brendshme, është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit institucional me mbështetjen nga Policia e Shtetit, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (AKAP), Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.<sup>29</sup> Programi “Siguria e të rinjve” përcakton rolet e Oficerëve të Sigurisë në shkolla ku përfshihet edukimi ligjor i nxënësve, formimi i tyre si qytetarë të përgjegjshëm, pa *ndërhyrë në masat disiplinore ose kontrollat e mjediseve shkollore përveç rasteve emergjente* me qëllim garantimin e një ambient më të sigurt dhe të mbështetur për nxënësit, për parandalimin e fenomeneve të dëmshme si bullizmi, dhuna dhe sjelljet antisociale, duke ndikuar në promovimin e një kulture pozitive brenda komunitetit shkollor. Programi i shtrin efektet e zbatimit në shkollat 9-vjeçare të vendit me pjesëmarrjen e oficerëve të Policisë së Shtetit, *ndërsa në shkollat e mesme zbatohet nga oficerët e sigurisë në shkolla*, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Manuali i Riskut të IAP-ve është dokumenti i cili siguron një pasqyrë të proceseve të menaxhimit të riskut në IAP në bashkëpunim me specialistët e ZAVP-ve përkatëse dhe përcakton udhëzime praktike për menaxhimin e tij.

Bazuar në legjislacionin shqiptar, përvojat ndërkombëtare dhe kontekstin e arsimit parauniversitar, vlerësimi i riskut të IAP-ve kategorizohet në 9 tregues të riskut, që mbështesin vlerësimin e përgjithshëm të riskut. Manuali i riskut në treguesin e riskut “Mirëqenia e nxënësve” ndër të tjera ka përfshirë rrisqe lidhur me Oficerin e sigurisë në shkollë, duke kategorizuar dhe nivelin e riskut.<sup>30</sup>

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor rezulton se “Oficerët e sigurisë (pjesë e policisë së shtetit) janë dislokuar në shkolla më datë 15.03.2018 dhe kanë qëndruar deri në përfundim të vitit akademik parauniversitar duke raportuar për incidentet apo situatat e hasura në shkollë. Në tetor të vitit 2023 është miratuar Udhëzuesi për praktikën e punës së Oficerëve të Sigurisë në shkolla i cili ka përfshirë udhëzime për rolin dhe përgjegjësinë e oficerëve të sigurisë për të garantuar një mjedis të sigurt në shkollë. “Dokument është mbështetur në praktikën e punës së oficerëve të sigurisë që prej fillimit të funksionimit të këtij shërbimi, në praktikat ndërkombëtare, në nevojat e identifikuar të punonjësve dhe në raport me rolin e tyre në institucionet arsimore (IA)”.<sup>31</sup> Referuar udhëzuesit “raportimi incidenteve nga oficerët e sigurisë tek strukturat përkatëse nga viti 2018, deri në tetor 2023 është bërë sipas disa formave të raportimit të vendosura në dispozicion nga grupi i punës i MAS (MASR në atë kohë), ku raportohet për incidentet apo situatat, nëpërmjet raportimit javor, vjetor dhe memo. Gjatë kësaj periudhe oficerët e sigurisë e kanë kryer raportimin në mënyrë periodike pranë

<sup>26</sup> Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet MB shkresa nr.2865/1 prot, datë 01.06.2018 dhe MASR 6068 prot, datë 01.06.2018

<sup>27</sup> VKM nr. 600, datë 9.10.2018 "Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë" i ndryshuar

<sup>28</sup> Udhëzuesi i praktikës së punës së oficerëve të sigurisë në shkolla , ASCAP viti 2023 (faqe 7)

<sup>29</sup> Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet MB shkresa nr. 1337/2 prot, datë 18.02.2022, shkresa nr. 8331/1 prot, datë 07.02.2022.

<sup>30</sup> Miratuar në vitin 2023

<sup>31</sup> Udhëzues për praktikën e punës së Oficerëve të Sigurisë në shkolla, ASCAP 2023.(faqe 8)

strukturës përgjegjëse në Drejtorinë Arsimore të Qytetit të Tiranës”.<sup>32</sup> *me instrumente jozyrtare*. Hartimi dhe miratimi i Udhëzuesit në vitin 2023 formalizoi me instrumentet e nevojshme zyrtare praktikën dhe dokumentimin e punës së oficerëve në shkolla duke rregulluar situatën ligjore të krijuar. Në zbatim të udhëzuesit Oficerët e sigurisë në shkolla gjatë punës së tyre duhet të udhëhiqen<sup>33</sup> nga parime si integriteti, profesionalizmi dhe diskrecioni që garantojnë suksesin e tyre, duke qenë shembull pozitiv për të rinjtë përmes sjelljes etike dhe konstruktive.

Nga auditimi rezultoi se, Udhëzuesi i miratuar nga ASCAP është mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare, por burimi i informacionit lidhur me këto praktika nuk është cituar në udhëzues, *gjë e cila lë vend për paragjykim tek palët e interesuara për cenim të drejtës së autorit të sanksionuar me ligj*<sup>34</sup>. Auditimi evidentoi mangësi lidhur me raportimin e incidenteve nga oficerët e sigurisë gjatë vitit shkollor në link-un e krijuar nga ASCAP.

Duke qenë se një nga format e raportimit të punës së oficerëve të sigurisë është raportimi i incidenteve nga shqyrtimi dokumentacionit rezultoi se këto raporte janë hedhur nga oficerët e sigurisë gjatë gjithë vitit shkollor në link-un e krijuar për efekt metodologjie nga ASCAP, me anë të cilit janë gjeneruar raporte vjetore statistikore mbi raportimin e bërë nga ana e oficerit të sigurisë mbi konfliktet apo incidentet e ndodhura në shkollë. Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor grupi i auditimit konstatoi se link-u i krijuar për efekt metodologjie nga ASCAP nuk plotëson kriteret ligjore për të qenë një link zyrtar në përputhje me ligjin “Për bazën e të dhënave shtetërore”.<sup>35</sup> Kuadri ligjor për bazën e të dhënave shtetërore përcakton qartë se baza e të dhënave shtetërore krijohet me ligj ose me vendim të Këshillit të Ministrave. Akti i krijimit të bazës së të dhënave shtetërore duhet të përcaktojë: institucionin administrues të bazës së të dhënave shtetërore me të dhënat parësore dhe dytësore; dhënësin/dhënësit e informacionit; ndërveprimin me bazat e tjera të dhënave; nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara. Referuar ligjit administrimi i bazës së të dhënave shtetërore bëhet në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi.

- Një tjetër problematikë që u evidentua gjatë auditimit ishte se AKAP nuk dispononte të dhëna statistikore lidhur me numrin e incidenteve, problematikave të raportuara nga ana e oficerëve të sigurisë në shkolla, detyrim i cili i lind sipas aktit nënligjor përkatës për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të institucionit. Akti nënligjor përcakton qartë kriteret që duhet të zbatohet AKAP si institucioni qendror përgjegjës në rang vendi i cili siguron mbledhjen, plotësimin, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore për institucionet arsimor; kryen monitorimin dhe mbledh të dhëna nga DRAP-et dhe ZVAP-et sipas udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për arsimin.<sup>36</sup> Kjo problematikë ishte për shkak se mungonte struktura e dedikuar për përpunimin e të dhënave statistikore në rang vendi, ku përfshihen të dhëna dhe për raportimin e incidenteve në shkolla. Referuar dispozitës ligjore për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të AKAP, MAS nuk ka nxjerrë udhëzime konkrete lidhur me përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore për shërbimin e sigurisë në shkolla e cila do ndihmojë institucionet politikëbërëse në bërjen e analizave më të thelluara dhe zbatimin e tyre në praktikë nga institucionet ligjzbatuese për të ndikuar në përmirësimin e sigurisë në IAP .

<sup>32</sup> Udhëzues për praktikën e punës së Oficerëve të Sigurisë në shkolla, ASCAP 2023 (faqe 6).

<sup>33</sup> Udhëzues i praktikës së punës së oficerëve të sigurisë në shkolla , ASCAP viti 2023 (faqe 9)

<sup>34</sup> Ligj nr-35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera”

<sup>35</sup> Ligji nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazën e të dhënave shtetërore”

<sup>36</sup> Vendimi nr. 99, date 27.2.2019 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e te funksionimit te Agjencisë Kombëtare te Arsimit Parauniversitar” i ndryshuar, pika 8, germa d.

- Auditimi evidentoi mungesën e përfshirjes së rolit dhe detyrave të oficerëve të sigurisë në udhëzimet e fillimvitit shkollor<sup>37</sup> ndryshe nga strukturat e tjera mbështetëse si për shembull shërbimi psikosocial, për të cilët jepen udhëzime specifike.<sup>38</sup>
- Mungesa e përfshirjes në Udhëzimet e fillimvitit shkollor *nuk siguron një angazhim të drejtpërdrejtë të drejtuesve të shkollave për një planifikim vjetor të veprimtarisë së oficerit të sigurisë në institucionet arsimore në përputhje me udhëzuesin e MAS*<sup>39</sup> i cili përcakton se: *“Planifikimi vjetor i veprimtarisë së oficerit të sigurisë në institucionet arsimore realizohet në përputhje me nevojat e institucionit, me gjetjet e analizës vjetore të vitit shkollor të mëparshëm, të strategjive kombëtare të udhëzimit të çdo fillimi të vitit shkollor”*.
- Gjithashtu mospërfshirja e rolit dhe detyrave të oficerëve të sigurisë në udhëzimet e fillimvitit shkollor krijon mungesë të qartësisë dhe koordinimit institucional faktor i cili ndikon në bashkëpunimin dhe mbikëqyrjen e funksionit dhe rolit të Oficerëve të sigurisë, për një komponent të rëndësishëm siç është siguria fizike dhe psikologjike e nxënësve në shkolla.
- Mungesa e një mekanizmi funksional si p.sh. një platformë ose link zyrtar i dedikuar për mbledhjen dhe raportimin e incidenteve nga OS-të në shkolla nuk siguron bërjen e analizave të thelluara mbi referimin e rasteve të incidenteve nga OS.
- Një problematikë tjetër që u konstatua nga auditimi është që roli dhe detyrat e oficerit të sigurisë në shkolla nuk është përfshirë në Udhëzimet e përbashkëta të fillimvitit shkollor si dokumente orientuese dhe zbatuese me rëndësi thelbësore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare kanë si objekt *përcaktimi i masave dhe i veprimtarive që ndërmarrin institucionet e Sistemit Arsimor Parauniversitar gjatë vitit shkollor*. Këto udhëzime kanë fuqi urdhëruese, lëshohen çdo vit nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit në bashkëpunim me ministri të tjera, (Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë) dhe sigurojnë, që në nivel shkolle të zbatohen masat e reja, prioritetet politike dhe ndryshimet rregullatore, por në përmbajtjen e tyre vërehet mungesa e përfshirjes së rolit dhe detyrave të oficerëve të sigurisë, ndryshe nga strukturat e tjera mbështetëse si për shembull shërbimi psikosocial, për të cilët jepen udhëzime specifike çdo vit. ASCAP për efekt metodologjie në llogari të institucionit ka krijuar një link ku kryhet raportimi i incidenteve nga ana e oficerëve të sigurisë në shkolla duke gjeneruar raporte vjetore statistikore me të dhëna për referimin në rastet e dhunës, bullizimit, raportimin mbi numrin e incidentet. Duke qenë se një nga format e raportimit të punës së oficerëve të sigurisë është raportimi i incidenteve dhe problematikave të ndryshme nëpërmjet një formular tip raportimin nga oficerët e sigurisë janë hedhur gjatë gjithë vitit shkollor në link-un e krijuar mbi bazën e strukturës së formatit të raportimit të incidenteve dhe problematikave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor rezulton se për vitin shkollor 2020-2021 janë dhënë udhëzime specifike për oficerët e sigurisë në shkolla, më konkretisht:

- Paraqitja në shkollë bëhet në orën e përcaktuar nga drejtoria e shkollës.

<sup>37</sup> MAS, MEKI. “Udhëzim i përbashkët Nr. 13, datë 10.07.2024 “Për vitin shkollor 2024–2025 “në Sistemin Arsimor Parauniversitar.

MAS, MEKI. “Udhëzim i përbashkët Nr. 15, datë 24.07.2023” Për vitin shkollor 2023–2024” në Sistemin Arsimor Parauniversitar.

MAS, MEKI. “Udhëzim i përbashkët Nr. 22, datë 24.07.2022” Për vitin shkollor 2022–2023” në Sistemin Arsimor Parauniversitar

<sup>38</sup> “Udhëzues “Për fillimin e vitit shkollor 2020–2021” hartuar ASCAP, miratuar MASR Gusht 2023, pika 6.3 (Udhëzime specifike për shërbimin psikosocial) faqe 38.

<sup>39</sup> “Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë”, miratuar më 11 tetor 2023, <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2023/10/Praktika-e-punes-se-oficereve-te-sigurise.pdf>

- Roja/oficeri i sigurisë të mbajë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat dhe solucione dezinfektuese.
- Roja nuk duhet të lejojë prezencën e prindërve dhe të çdo individi tjetër, brenda në institucion (me përjashtim të nxënësve dhe të personelit të deklaruar të institucionit arsimor).
- Çdo kërkesë për komunikim me drejtuesin e institucionit të bëhet nëpërmjet numrit të kontaktit të drejtorit ose të stafit drejtues.
- Të kryhen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin fizik me nxënësit, mësuesit dhe sanitaret. është person mbështetës për respektimin e rregullave të sigurisë gjatë vitit shkollor 2020-2021;
- Mban një databazë të nxënësve dhe të stafit të shkollës që shfaqin simptoma, shqetësime, probleme shëndetësore, si dhe bashkëpunon me strukturat shëndetësore përgjegjëse në rastet e dyshuara ose kur evidentohen nxënës me simptoma të COVID-19;
- evidenton dhe raporton te drejtori i shkollës, raste të moszbatimit të masave të distancimit fizik dhe të higjienës nga nxënësit dhe nga stafi i shkollës;

Nga shqyrtimi dokumentacionit ligjor rezulton se në udhëzimet e fillimvitit shkollor 2021-2022,2023-2024, dhe 2024-2025 përfshihet shërbimi psikosocial në nen të veçantë por janë përjashtuar roli dhe detyrat e Oficerit të Sigurisë në shkollë.

Po ti referohemi Udhëzimit të përbashkët të fillim vitit shkollor 2022-2023 konstatojmë se neni 4 përcakton detyra dhe role konkrete për shërbimin psikosocial, si vijon: DRAP-et dhe ZVAP-et të marrin masa për funksionimin e shërbimit psikosocial në zbatim të urdhrit nr.313 datë 20.10.2020 për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të psikosocial në IAP dhe procedurat e emërimit, pezullimit, largimit nga shërbimi psikosocial i ndryshuar; Drap-et dhe ZVAP-et të monitorojnë realizimin e planit të punës të njësisë të SHPS dhe të raportojnë në DPAP në muajin janar dhe qershor 2023, për realizimin e tij. Mungesa e përfshirjes në udhëzimet e fillim së rolit dhe detyrave të oficerit të sigurisë në mënyrë ndikon në mbarëvajtjen e sigurisë në shkolla. Përfshirja e detyrave dhe roleve konkrete të oficerit të sigurisë në shkolla në udhëzimet e fillimvitit shkollor njëlloj si shërbimi psikosocial është në funksion të mbarëvajtjes së punës së shërbimit të sigurisë në shkollë, ku DPAP si institucion Qëndror duhet të raportojë në MAS njëlloj si për shërbimin psikosocial në muajin janar dhe qershor të çdo viti shkollor për realizimin e aktivitetit të oficerit në shkollë.

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, për vitin shkollor 2020-2021 janë dhënë udhëzime specifike për oficerët e sigurisë në shkolla, ku veç të tjerash parashikohet se: “Oficeri i Sigurisë nuk duhet të lejojë prezencën e prindërve dhe të çdo individi tjetër, brenda në institucion (me përjashtim të nxënësve dhe të personelit të deklaruar të institucionit arsimor)”. Për vitet në vijim udhëzimet e fillim vitit nuk kanë parashikime specifike për rolin e Oficerit, megjithëse këto udhëzime kanë një rol kyç në orientimin dhe funksionimin e institucioneve arsimore, ndryshe nga shërbimi psikosocial, për të cilët jepen udhëzime specifike çdo vit. Ky trajtim i diferencuar midis shërbimit të sigurisë, i ofruar nga Oficeri dhe ai i mbështetjes psiko-sociale, i ofruar nga psikologu dhe punonjësi social, krijon një mungesë të qartësisë dhe koordinimit institucional për një komponent të rëndësishëm, siç është siguria fizike dhe psikologjike e nxënësve në shkolla. Edhe pse roli i oficerëve të sigurisë në shkolla është përcaktuar me akte të tjera nënligjore<sup>40</sup>, mungesa e përfshirjes së tyre në udhëzimet vjetore nuk siguron një angazhim të drejtpërdrejtë të drejtuesve të shkollave për bashkëpunim dhe mbikëqyrje të funksionit të tyre. Kjo mangësi reflektohet edhe në vetë udhëzuesin për oficerët e sigurisë, ku theksohet se: *“Planifikimi vjetor i veprimtarisë së oficerit të sigurisë në institucionet arsimore realizohet në përputhje me*

<sup>40</sup> VKM-ja nr. 600, datë 9.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë” i ndryshuar, dhe Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë

*nevojat e institucionit, me gjetjet e analizës vjetore të vitit shkollor të mëparshëm, të strategjive kombëtare, të udhëzimit të çdo fillimi të vitit shkollor”<sup>41</sup>.*

**2.1 Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit, grupi i auditimit konstatoi se, link-u i krijuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), përmes të cilit oficerët e sigurisë raportojnë të dhënat mbi konfliktet dhe incidentet në shkolla, nuk është i parashikuar dhe mbështetur në asnjë akt ligjor. Si rrjedhojë, përdorimi i këtij linku nuk përbën një detyrim ligjor për oficerët e sigurisë, duke bërë që raportimi i incidenteve dhe konflikteve të regjistruara në shkolla të mos jetë i garantuar apo i detyrueshëm.

**2.2 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve që dokumentonin praktikën e punës së oficerëve të sigurisë në shkolla rezultoi se, aktualisht të dhënat për incidente në shkolla raportohen nga oficerët e sigurisë dhe mblidhen në nivel vendor nga ZVAP-të, por ato arkivohen vetëm në formën e dosjeve fizike, pa u përpunuar apo analizuar më tej. Auditimi evidentoi mungesën e një strukturë të dedikuar për përpunimin e të dhënave statistikore për institucionet arsimore në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP), i cili është institucioni përgjegjës për mbledhjen, plotësimin, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave, në Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar.<sup>42</sup> Kjo ndodh për shkak se nuk ekziston një bazë e qartë ligjore apo udhëzim që të përcaktojë rrjedhën dhe përdorimin e këtyre të dhënave nga strukturat përgjegjëse.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar si institucioni qendror përgjegjës për monitorimin e oficerëve të sigurisë nuk ka ndërtuar një mekanizëm ligjor dhe funksional, të dedikuar për mbledhjen dhe raportimin e incidenteve nga OS-të. Kjo situatë lidhet me faktin se brenda strukturës së saj mungon një zyrë e specializuar për statistika, e cila do të ishte përgjegjëse për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të marra nga Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar<sup>43</sup>. Për më tepër, AKAP si institucioni qendror përgjegjës për monitorimin e oficerëve të sigurisë nuk ka ndërtuar një mekanizëm ligjor dhe funksional, të dedikuar për mbledhjen dhe raportimin e incidenteve nga OS-të, sepse aktualisht nuk ka në strukturën e tij një zyrë të statistikave e dedikuar për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të marra nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar.

**1. Konkluzion:** Përfshirja e OS në udhëzimet vjetore të fillim vitit shkollor forcon integrimin e tyre në strukturat funksionale të shkollës, garanton një përditësim të vazhdueshëm të detyrave në përputhje me kontekstin dhe rreziqet e reja, dhe siguron një angazhim të drejtpërdrejtë të drejtuesve të shkollave për bashkëpunim dhe mbikëqyrje të funksionit të tyre.

Kjo do të garantojë një planifikim vjetor më të mirë të veprimtarisë së oficerit të sigurisë në institucionet arsimore në përputhje me nevojat e institucionit, me gjetjet e analizës vjetore të vitit shkollor të mëparshëm, të strategjive kombëtare, duke u orientuar nga udhëzimi i çdo fillim viti shkollor”<sup>44</sup>.

<sup>41</sup> “Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë”, miratuar më 11 tetor 2023. <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2023/10/Praktika-e-punes-se-oficereve-te-sigurise.pdf>

<sup>42</sup> VKM nr.99 “ Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AKAP” neni 8, gërma d.

<sup>43</sup> Vendimi nr. 99, datë 27.2.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, i ndryshuar, shkronja “d”, pika 8,

<sup>44</sup> MAS. “Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë”. (11 tetor 2023, Përgatitur nga ASCAP) <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2023/10/Praktika-e-punes-se-oficereve-te-sigurise.pdf>

**2. Konkluzion:** Mungesa e një strukture në AKAP e dedikuar për mbledhjen, plotësimin, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore për institucionet arsimore nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe ZVAP, sjell për pasojë që institucionet ligjzbatuese dhe palët e interesuara të mos kenë të dhëna të besueshme në bërjen e analizave të thelluara për të kuptuar shkaqet e mungesës së efektivitetit të OS duke ndikuar në mosfunksionimin e shërbimit të sigurisë në IAP. Ngritja e një mekanizmi funksional si p.sh. një platformë ose link zyrtar i dedikuar për mbledhjen dhe raportimin e incidenteve nga OS-të në shkolla do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe besueshmërisë nga palët e interesuara, publiku i gjerë lidhur me këtë shërbim të ofruar.

Transparenca dhe besueshmëria e të dhënave do të ndikojë në marrjen e masave konkrete për të garantuar ofrimin e një shërbimi cilësor në shkolla nga ana e institucioneve përgjegjëse e cili do të ndikojë në përmirësimin e rolit dhe efektivitetit të punës së kryer nga OS.

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit të marrë masa, që në udhëzimet e fillim vitit shkollor të përfshihen parashikime specifike mbi rolin dhe detyrat e oficerëve të sigurisë, me qëllim sigurimin e një angazhimi të drejtpërdrejtë dhe përditësimin e vazhdueshëm të këtyre detyrave, në përputhje me nevojat e sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar.

**Brenda vitit 2025**

**2.1 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit të marrë masa për ngritjen e një mekanizmi ligjor dhe funksional, një platformë ose link i dedikuar për mbledhjen dhe raportimin e incidenteve nga oficerët e sigurisë në shkolla, i cili do të ndihmojë institucionet ligjzbatuese në bërjen e analizave më të thelluara mbi referimin e rasteve të incidenteve nga oficerët.

**Brenda datës 31.07.2026**

#### **4.2 A i përgjigjet nevojave të shkollës aktiviteti i ushtruar nga oficerët e sigurisë?**

##### **➤ Krijimi i figurës së oficerit të sigurisë në shkolla.**

Lufta kundër dukurive të tilla si, dhuna fizike, bullizmi apo përdorimi i drogave në shkolla, përfaqëson tashmë një shqetësim social dhe njëherësh një sfidë për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ministrinë e Brendshme.

Ministria e Brendshme ka ndërmarrë disa nisma të cilat synojnë rritjen e sigurisë, si brenda, ashtu edhe jashtë perimetrit të institucioneve arsimore, nëpërmjet patrullimit të shpeshtë të policisë, si dhe një sërë masash të tjera. Prania e policisë është një ndër elementet e shumta të sigurisë në shkolla.

Menaxhimi i sigurisë në shkolla kërkon një ndërveprim të vazhdueshëm me nxënësit dhe stafin e shkollës, gjë të cilën policia nuk mund ta arrijë duke pasur parasysh natyrën sensitive të mjedisit shkollor. Për këtë arsye, duke synuar rritjen e sigurisë nëpërmjet ndërveprimit dhe parandalimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me anë të marrëveshjes së firmosur midis palëve, krijuan një qasje të re nëpërmjet projektit “Shkolla të sigurt - Oficerët e Sigurisë në shkolla”.

Kjo qasje synonte të realizohej nëpërmjet krijimit të rolit të oficerit të sigurisë së shkollës. Projekti kishte si qëllim kryesor garantimin e një mjedisi të sigurt mes nxënësve brenda në shkollë, si dhe një mjedis të sigurt për ta në territorin e shkollës. Projekti filloi si një projekt pilot në 15 shkolla të mesme në qytetin e Tiranës, për t’u shtrirë më vonë në të gjithë vendin. Për fazën e pilotimit të projektit në këto shkolla u dislokuan oficerë të forcave të rendit në detyrë, të cilët kishin marrë të gjitha trajnimet e nevojshme nga Akademia e Sigurisë, sipas një kurrikule të përgatitur posaçërisht për ta. Oficerët e sigurisë janë dislokuar në shkolla, më datë 15.03.2018 dhe qëndruan deri në përfundim të vitit akademik parauniversitar. Raportimi i tyre të strukturat përkatëse është bërë sipas disa formave të raportimit të vendosura në dispozicion

nga grupi i punës i MAS (MASR në atë kohë), ku raportohet për incidentet apo situatat, raportimin javor, vjetor dhe memo.

Rezultatet e përfuara nga pilotimi i hapën rrugën fillimit të procedurave të rekrutimit të oficerëve të sigurisë në shkolla, ku grupi i parë i oficerëve të sigurisë të vendosur në shkolla i përket muajt mars të vitit 2019.

Me anën e VKM-së nr. 600, datë 9.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, i ndryshuar, u përcaktuan dhe rregulluan pozicioni i oficerit të sigurisë në shkolla, numri i tyre dhe shpërndarja e tyre në institucionet e arsimit parauniversitar.

➤ ***Krahasimi i realitetit shqiptar me atë të vendeve të tjera, lidhur me aspekte të sigurisë në shkolla.***

Për të bërë një vlerësim krahasimor midis realitetit të sigurisë në shkollat shqiptare dhe atyre të vendeve të tjera të botës, u ndalëm tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Raporti i UNESCO “Pas shifrave: Fund dhunës në shkolla dhe bullizmit”<sup>45</sup>, publikuar në janar 2019.

Në këtë raport, bullizmi është kategorizuar në tre forma kryesore: dhunë fizike, dhunë psikologjike/përrjashtimet sociale dhe dhunë seksuale dhe “qëllimi i këtij raporti ka qenë të paraqesë një sintezë dhe analizë të re të provave të disponueshme mbi dhunën dhe bullizmin në shkollë, bazuar në të dhënat më të fundit dhe më gjithëpërfshirëse.”<sup>46</sup>

Sipas këtij raporti, rezulton se në Shqipëri, përqindja e nxënësve të raportuar se janë dhunuar, rezulton të jetë 19,9%, prej të cilëve, 22,6% djem dhe 17,3% vajza. Shifrat janë më të larta tek 11 vjeçarët, ku sipas raportit 23,8% kanë pranuar se kanë përjetuar bullizmin, apo dhunën në shkollë, në një nga format e tij, ndërsa tek 13 vjeçarët ky fenomen prek 20% të tyre.

Tek nxënësit e moshës 15 vjeç përqindja e nxënësve të dhunuar është 16,1%.

Gjithnjë, sipas këtij Raporti, Evropa është ndër rajonet me përqindjen më të ulët të nxënësve që kanë përjetuar dhunë në shkolla, që arrin një nivel prej 25%. Ndërkaq, në Amerikën e Veriut, përqindja e nxënësve që kanë përjetuar bullizëm (në tre format sipas kategorizimit të raportit) është rreth 31,7%.

**Tabela 3: Përqindja e nxënësve të dhunuar dhe bullizuar në vendet e përfshira në raport.**

Nr.	Vendi	Përqindja e nxënësve të dhunuar dhe bullizuar	Përqindja e djemve të dhunuar dhe bullizuar	Përqindja e vajzave të dhunuara dhe bullizuara
1	Russian Federation	42.5	45.1	40.5
2	Canada	35.4	32.6	38.2
3	Austria	35.6	39.1	32.5
4	Bulgaria	34.2	35.5	32.8
5	France	28.8	29.5	28
6	United States of America	27.9	28.4	27.4
7	Finland	27.5	30.7	24.4
8	Germany	23.3	22.9	23.6
9	Slovenia	22.1	25.5	18.8
10	Norway	21.4	22.5	20.3
<b>11</b>	<b>Albania</b>	<b>19.9</b>	<b>22.6</b>	<b>17.3</b>
12	Greece	18.3	19	17.6
13	Czech Republic	17.8	18.7	17
14	Croatia	17.1	17.6	16.6
15	Italy	15.6	17.4	13.8

<sup>45</sup> <https://www.unicef.org/media/66496/file/Behind-the-Numbers.pdf>

<sup>46</sup> <https://www.unicef.org/documents/behind-numbers-ending-school-violence-and-bullying>

*Burimi: Të dhëna të marra nga Raporti i UNESCO-s "Pas shifrave: Fund dhunës në shkolla dhe bullizmit"<sup>47</sup>.  
Përpunoi: Grupi i Auditimit*

Sikurse konstatohet nga ky raport i UNESCO-s, sa i përket nivelit të dhunës dhe bullizmit në shkolla, Shqipëria regjistron një numër rastesh dhune dhe bullizmi në shkolla, nën nivelin e mesatares evropiane, duke performuar më mirë se vende me një sistem arsimor më të përparuar sesa i joni, si: Austria, Bullgaria, Franca, Finlanda, Gjermania, Sllovenia, Norvegjia, por paralelisht, me një nivel më të lartë rastesh, se sa vende të Mesdheut, si: Greqia, Kroacia, apo Italia.

➤ ***Të dhënat statistikore janë të mangëta dhe të pasakta.***

Performanca e punës së oficerëve të sigurisë matet me ecurinë e numrit të rasteve/incidenteve të regjistruara në shkolla. Për të vlerësuar këtë aktivitet, në bazë të Udhëzuesit për praktikën e punës së Oficerëve të sigurisë<sup>48</sup>, përdoren instrumentet matës, të cilët do i trajtojmë në vijim të materialit.

*Paraprakisht, vlen të nënvizohet se nuk ka të dhëna të plota lidhur me numrin e rasteve/incidenteve të administruara në shkollat shqiptare nga oficerët e sigurisë dhe arsyet do shtjellohen në vijim.*

➤ ***Ka mungesë mbledhjeje dhe përpunimi të dhënash, nga institucionet e arsimit, sikurse ka dhe mbledhje të dhënash të pabazuar në ligj.***

Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, marrin nga shkollat ku shërbejnë OS-të, referime rastesh/incidentesh, raporte javore apo dhe vjetore të tyre, por këto të dhëna nuk i përpunojnë, analizojnë, apo përcjellin në hallkat eprore të zinxhirit organizativ.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar – AKAP (ish - Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar - DPAP), institucion në varësi të MAS, e cila e ka detyrë të saj, “të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi nuk merr dhe nuk përpunon asgjë nga kjo masë të dhënash.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), institucion në varësi të MAS, merr të dhënat e raportimeve të rasteve/incidenteve direkt nga OS nëpërmjet “link-ut <https://forms.office.com/e/kKVANT9qnZ> ku mblidhen dhe gjenerohen të dhënat mbi bazën e këtyre raportimeve. Fushat e të dhënave të një raportimi, plotësohen nga OS – të duke ndjekur gjurmën e të formatit të raportit të incidentit dhe problematikave. Ky instrument është përshtatur për të bërë të mundur mbledhjen e të dhënave nga oficerëve të sigurisë në shkolla dhe është ndërtuar në platformën *Microsoft forms*. Linku i dërgohet çdo fillimviti oficerëve të sigurisë në shkolla. Në përfundim të vitit shkollor, nga ana e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar ndërtohet raporti përkatës<sup>49</sup>.

Këto raporte (shumatore të rasteve /incidenteve) i janë përcjellë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, përkatësisht, “për:

- 2021-2022 – është dërguar me e-mail:
- 2022-2023 – është dërguar me shkresën nr. 530 prot., datë 14.06.2023:
- 2023-2024 – është dërguar me e-mail.”<sup>50</sup>

Këto raporte janë edhe të publikuara në faqen zyrtare të ASCAP<sup>51</sup>.

*Duhet nënvizuar, se procesi i transferimit të të dhënave nga OS - të tek ASCAP, mbledhja e tyre nga ASCAP dhe raportimi i tyre tek MAS, është një proces i pabazuar në akte ligjore dhe*

<sup>47</sup> <https://www.unicef.org/media/66496/file/Behind-the-Numbers.pdf>

<sup>48</sup> Miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të arsimit

<sup>49</sup> Përgjigje e pyetësorit të GA, dhënë nga ASCAP me datë 14.04.2025.

<sup>50</sup> Përgjigje e pyetësorit të GA, dhënë nga ASCAP me datë 14.04.2025.

<sup>51</sup> <https://www.ascap.edu.al/studime-dhe-raporte/>

rregullatore, ndaj vetë OS nuk e kanë detyrim ligjor të raportojnë në link-un e lartpërmendur. As “Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë”<sup>52</sup>, nuk e parashikon një detyrim të tillë. Oficerët referojnë tek ASCAP, ndërkohë që ASCAP, përgatit dhe dërgon në MAS, çdo vit raportet përmbledhëse të referimeve të rasteve/incidenteve në shkollat ku janë dislokuar oficerët e sigurisë. Që nga fillesat e shërbimit të OS – ve e deri më sot, ky është burimi i vetëm statistikor nga i cili merr informacion MAS, mbi këtë shërbim sigurie në institucionet e arsimit parauniversitar të vendit. **Ky proces përcjelljeje të dhënash, është aktiv prej vitesh, pavarësisht se i paligjëruar.**

Kjo çështje do trajtohet më thellësisht në pikën tjetër të raportit, por kjo parantezë u gjykua e nevojshme për të vënë në dukje se sa i parregulluar dhe sa i pasigurtë është procesi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, mbi të cilat Grupi i Auditimit (GA) gjithsesi do ravizojë tendenca dhe dukuri, që lidhen me sigurinë në shkolla dhe efektivitetin e rolit të OS-ve.

Gjatë auditimit u konstatua, se në data bazën e krijuar nga ASCAP, me numrin e rasteve/incidenteve të raportuara nga OS, seksioni “Shkolla” nuk plotësohet si fushë që nga viti 2022 – 2023. “Në link-un ku mblidheshin të dhënat, është hequr ky pohim, pasi oficerët e sigurisë janë shprehur, se janë ndjerë nën presionin e drejtuesve për të raportuar, pasi shkolla e tyre mund të cilësohej një shkollë jo e mirë, nëse kishte raportime të rasteve apo të incidenteve. Kjo gjë u bë e mundur që oficerët e sigurisë të ishin më të lirë për të raportuar, duke qene edhe se të dhënat e mbledhura janë të dhëna kombëtare, të cilat përdoren vetëm për qëllime statistikore.”<sup>53</sup>.

**Ky fakt provon se procesi i referimit të rasteve/incidenteve nga OS vetëcensurohet dhe nuk udhëhiqet nga kritere transparence.**

**Rrjedhimisht, përtej angazhimit të përkushtuar dhe të sinqertë të specialistit të ASCAP – it të angazhuar me çështjet e sigurisë në shkolla, të dhënat e vëna në dispozicion nga ky institucion, do merren në konsideratë me rezervë, por gjithsesi do të vlerësohen si burim evidence statistikore në dispozicion, i shtrirë në gjithë periudhën në fokus auditimi, por vetëm për aspekte të caktuara.**

➤ **Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk janë të plota.**

Nga ana tjetër, GA kërkoi informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit lidhur me pasqyrat e raportimit për situatën dhe shërbimet në institucionet e arsimit parauniversitar, për periudhën shtator 2021 – dhjetor 2024 dhe përgjigja e dhënë nga ky institucion ishte:

“1. Për vitet shkollore 2021-2022 dhe 2022-2023, nuk ka të dhëna konkrete, pasi struktura e Sektorit për Krimet në Volum është krijuar në muajin korrik të vitit 2023, ndaj dhe paketa e sigurisë në shkolla është vënë në efikasitet në muajin shtator të vitit 2023”. Ndërkaq të dhënat për vitin shkollor 2023-2024, së bashku me ato të vitit shkollor 2024-2025, për vetëm periudhën, nga shtator 2024, deri në 31.12.2024, iu vunë dispozicion Grupit të Auditimit.

“Sqarojmë se tabelat, për vitet shkollore 2023-2024 dhe 2024-2025, deri në muajin dhjetor të 2024, janë të administruara si vit kalendarik dhe jo si vit shkollor”<sup>54</sup>.

Përtej mungesës së informacionit për vitet shkollore 2021-2022 dhe 2022-2023, për të cilat s’ka të dhëna konkrete, administrimi i pasqyrave të raportimit për situatën dhe shërbimet në institucionet e arsimit parauniversitar, si vite kalendarike dhe jo si vite shkollore, e bën të vështirë krahasimin e të dhënave për mungesë të të njëjtit standard kohor pasqyrimi. Këto të dhëna do përdoren, vetëm për të ilustruar aspekte të caktuara.

<sup>52</sup> Udhëzues për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit.

<sup>53</sup> Përgjigje e pyetësorit të GA, dhënë nga ASCAP me datë 14.04.2025

<sup>54</sup> Informacion i datës 06.05.2025, përcjellë me e-mail nga DPPSH

Bashkëlidhur përgjigjes së DPPSH, u përcollën tabelat përkatëse me të dhënat të cilat japin pasqyrën e raportimit për situatën dhe shërbimet në institucionet arsimore për vitin 2023 (shtator - dhjetor 2023), pra vetëm për pjesën e parë të vitit shkollor 2023-2024.

**Tabela 4: Pasqyra e raportimit për situatën dhe shërbimet në institucionet arsimore për vitin 2023 (shtator - dhjetor 2023)**

	Drejtoria Vendore e Policisë (DVP)	Nr. i Institucioneve arsimore në territor	Nr. i punonjësve të policisë të angazhuar në shkolla	Takime e policisë me drejtuesit e shkollave	Takime e policisë me oficerët e sigurisë në shkolla	Takime e policisë me bordin e prindërve / senatin e nxënësve	Numra unik të marrë nga shërbimet policore	Problematika të evidentuara nga shërbimet e PSH, ngjarje
1	Shkodër	183	1392	3279	1041	71	814	7
2	Lezhë	84	205	306	162	1	131	0
3	Kukës	93	2253	3419	266	228	1279	5
4	Dibër	69	1052	1090	283	112	897	0
5	Durrës	378	1131	4080	1124	209	608	0
6	Elbasan	248	1580	2378	1582	38	25	26
7	Korçë	170	1340	1283	956	50	24	19
8	Fier	176	1369	1860	1056	65	157	14
9	Berat	106	2112	1003	298	40	3	3
10	Vlorë	140	797	792	160	12	120	20
11	Gjirokastrë	87	121	1208	117	18	335	0
12	Tiranë	302	2218	1884	1289	174	457	22
	<b>SHUMA</b>	<b>2039</b>	<b>15560</b>	<b>22581</b>	<b>8334</b>	<b>1018</b>	<b>4850</b>	<b>116</b>

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga DPPSH

Sikurse vërehet, gjatë periudhës shtator-dhjetor 2023, për **2039** institucione arsimore publike e private të vendit janë programuar **15560** punonjës policie të angazhuar me shërbime për sigurinë në shkolla. Në këto institucione arsimore janë organizuar **22581** takime të punonjësve të policisë me drejtuesit e shkollave, **8334** me oficerët e sigurisë në shkolla. Për periudhën 4 mujore janë marrë **4850** numra unik nga shërbimet e policisë dhe për rastet e ndodhura në lidhje me sigurinë në shkolla, janë evidentuar, **116 raste/ problematika ngjarjesh** nga Policia e Shtetit.

Gjatë të njëjtës periudhë “janë evidentuar **31** ngjarje të referuara në prokurori”<sup>55</sup>.

Për vitin 2024, i cili përfshin të dhëna që i përkasin edhe vitit shkollor 2023-2024, sikurse edhe të vitit 2024-2025, numri i konflikteve/ngjarjeve të evidentuara nxënës-nxënës, apo nxënës-të jashtëm (shkolla publike), të ndara sipas DVP, rezulton si më poshtë:

**Tabela 5: Numri i konflikteve/ngjarjeve të evidentuara nxënës-nxënës, apo nxënës-të jashtëm (shkolla publike) të ndara sipas DVP për vitin 2024**

Numri i konflikteve/ngjarjeve të evidentuara në shkolla													
DVP	TR	DR	BR	EL	FR	VL	KO	GJ	LE	DI	KU	SH	TOTAL
Nxënës-nxënës	75	4	12	14	4	12	37	2	3	19	4	7	<b>193</b>
Nxënës- të jashtëm	0	0	0	0	1	0	11	0	1	2	2	2	<b>18</b>

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga DPPSH

Përqindja e konflikteve “nxënës - nxënës” për vitin 2024 është 91.5 % e totalit të konflikteve, ndërsa pjesa tjetër prej 8,5% të rasteve, janë konflikte “nxënës - të jashtëm. Ky fakt dëshmon se perimetri i shkollës ruhet mjaftueshëm dhe krijon ndarje e siguri, ndaj këtyre të fundit.

<sup>55</sup> Informacion i datës 06.05.2025, përcjellë me e-mail nga DPPSH

Numri i konflikteve apo ngjarjeve të parandaluara nga PSH dhe Oficerët e Sigurisë në Shkolla, të ndara sipas DVP, për vitin 2024, paraqitet në tabelën më poshtë:

**Tabela 6: Numri i konflikteve të parandaluara nga PSH dhe Oficerët e Sigurisë në Shkolla, të ndara sipas DVP, gjatë vitit 2024**

Numri i konflikteve apo ngjarjeve të tilla të parandaluara nga PSH dhe Oficerët e Sigurisë në Shkolla													
DVP	TR	DR	BR	EL	FR	VL	KO	GJ	LE	DI	KU	SH	TOTAL
PSH	77	11	3	26	0	0	36	3	3	8	3	0	170
OSSH	74	5	3	8	0	0	7	1	1	13	1	0	115

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga DPPSH

Të dhënat e Tabelës 6, vënë në dispozicion nga DPPSH, po të krahasohet me të dhënat e ardhura nga ASCAP, lidhur me “administrimin e rastit”, si më poshtë, vihet re një mospërputhje.

**Tabela 7: Mbi administrimin e rastit<sup>56</sup>**

Rasti i administruar referohet se:	Viti shkollor 2021 - 2022	Viti shkollor 2022 - 2023	Viti shkollor 2023 - 2024	Viti shkollor 2024-2025, periudha shtator - dhjetor 2024
U parandalua	0	46	72	62
U zgjidh plotësisht	493	376	283	282
U zgjidh pjesërisht dhe mbahet në monitorim	192	137	165	142
Nuk është zgjidhur ende dhe mbahet në monitorim	130	46	61	49

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga ASCAP.

Nëse nga të dhënat e DPPSH rezulton se gjatë vitit 2024 (i cili kujtojmë se përfshin të dhëna që i përkasin edhe vitit shkollor 2023-2024, sikurse edhe të vitit 2024-2025) janë parandaluar 170 raste nga Policia e Shtetit dhe 115 nga oficerët e sigurisë, atëherë, totali i rasteve/incidenteve të parandaluara është **285** raste.

Nga të dhënat e sjella nga ASCAP, referuar tabelës së mësipërme, rezulton se parandalimet e rasteve/incidenteve nga shtatori 2021, deri në dhjetor 2024, janë në total **182**, shifër kjo që provon, se rastet referohen vetëm pjesërisht nga OS.

Sa konstatuar, përbën një provë shtesë që sugjeron, për t'i marrë me rezervë të dhënat e ASCAP.

Dilemat për marrjen në konsideratë të të dhënave statistikore për ligjen kur konstatohet, se edhe realitete të tjera, me një arsim parauniversitar më të përparuar se i joni, si ai i Suedisë, rezulton si më poshtë: “Nuk ka të dhëna të besueshme për dhunën në shkollat e detyruara suedeze. Meqenëse nxënësit janë nën moshën e përgjegjësisë penale, nuk ka statistika zyrtare për raportet e policisë dhe sistemet lokale të raportimit të incidenteve në shkolla të përdorura në disa komuna nuk mund të konsiderohen të besueshme pasi raportimi, nuk është i detyrueshëm.”<sup>57</sup>.

Për vitin 2024, paraqiten të dhënat e mëposhtme të cilat japin pasqyrën e raportimit për situatën dhe shërbimet në institucionet arsimore nga ana e Policisë së Shtetit.

**Tabela 8: Pasqyra e raportimit për situatën dhe shërbimet në institucionet arsimore, të ndara sipas DVP, për vitin 2024.**

<sup>56</sup> Përgjigje e pyetësorit të GA, dhënë nga ASCAP me datë 14.04.2025.

<sup>57</sup> <https://www.scup.com/doi/10.1080/14043858.2017.1393875>

Pasqyra e raportimit për situatën dhe shërbimet në institucionet arsimore, të ndara sipas DVP														
	DVP	TR	DR	BR	EL	FR	VL	KO	GJ	LE	DI	KU	SH	Total
1	Numri i IAP-ve në territor	307	125	106	192	152	140	170	100	84	75	99	190	1740
2	Numri i punonjësve të PSH të angazhuar për SSH	537	3605	622	108	3143	2255	6208	1130	26	31	4733	213	28211
3	Takime me drejtuesit shkollave	3585	10438	4143	2911	6237	3807	2798	2122	2883	101	5106	5824	49955
4	Takime me OS në shkolla	2631	6575	1146	1192	2172	600	1980	485	1029	156	441	1936	20343
5	Takime me bordin e prindërve / senatin e nxënësve	1217	137	17	154	19	17	50	48	2	24	438	16	2139
6	Numri i OS në shkolla	71	23	6	23	20	9	13	4	10	6	4	13	201

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga DPPSH

Ajo që bie në sy nga të dhënat e Tabelës 8, është fakti se ka qarqe si ai i Kukësit dhe ai i Gjirokastrës ku ka një oficer sigurie çdo 25 shkolla, ndërkohë në qarkun e Tiranës ka një oficer sigurie për çdo 4,3 shkolla. Kjo e dhënë dëshmon se në qarqet Kukës dhe Gjirokastrë shkollat kanë regjistrime më të pakta në numër, sesa Tirana.

➤ ***Të dhënat statistikore të gjeneruara nga Grupi i Auditimit.***

Nga ana e tij, Grupi i Auditimit si gjatë fazës studimore, ashtu dhe asaj të terrenit mori informacion dokumentar të drejtpërdrejtë nga shkollat, oficerët e sigurisë, drejtuesit e IAP-ve, zhvilloi intervista si me OS - të, ashtu dhe me drejtuesit e IAP-ve, verifikoi dhe vlerësoi dosjet e punës së OS-ve, si dhe shpërndau në dhjetë klasa, të pesë shkollave të ndryshme (Shkolla e Bashkuar Zejmen - Lezhë, Shkolla e Mesme të Bashkuar Gosë - Rrogozhinë, Shkolla 9 vjeçare "Fan Noli" - Tiranë, Gjimnazi "Eqrem Çabej" - Tiranë, Gjimnazi "Arben Broci" - Tiranë), pyetësorë për nxënës, të cilët matin dhe vlerësojnë gjendjen e sigurisë në to, mbi bazën e përgjigjes së 227 vetave.

Rezultatet e pyetësorëve, pas përgjigjes së nxënësve, janë përfshirë në një përmbledhëse, e cila gjendet në seksionin e shtojcave (Shtojca 1).

Këto të dhëna do përdoren herë pas here, për të vlerësuar rolin dhe efektivitetin e punës së oficerëve të sigurisë.

➤ ***Statistikat e gjeneruara nga ASCAP, mbi bazën e referimeve të problematikave/incidenteve të OS – ve në link, ofrojnë një panoramë të deformuar dhe të pavërtetë, mbi treguesit e sigurisë në shkolla***

Nga të dhënat e vëna dispozicion nga AKAP, lidhur me numrin e nxënësve të regjistruar nëpër shkollat e vendit dhe nga të dhënat e vëna dispozicion nga ASCAP, lidhur me numrin e rasteve/incidenteve të raportuara nga oficerët e sigurisë në link, arrihet tek përmbledhësja, si më poshtë:

**Tabela 9: Numri i incidenteve/problematikave të raportuara nga oficerët e sigurisë, në periudhën shtator 2021 – dhjetor 2024, në rang vendi (Sipas DRAP-eve dhe ZVAP-ve)**

		Numri i nxënësve të regjistruar në IAP-e, sipas varësisë dhe juridiksionit territorial, për vitet shkollore:				Numri i incidenteve / problematikave për vitet shkollore:			
	Shtrirja territoriale e AKAP (DRAP-e+ZVAP-e)	2021 - 2022	2022 - 2023	2023 - 2024	Deri në dhjetor 2024	2021 - 2022	2022 - 2023	2023 - 2024	Deri në dhjetor 2024
<b>I</b>	<b>DRAP Durrës</b>	<b>149025</b>	<b>142751</b>	<b>139000</b>	<b>134883</b>	<b>402</b>	<b>306</b>	<b>327</b>	<b>288</b>
1	ZVA Durrës	22780	21861	21231	20319	81	30	58	36
2	Tiranë	71983	70121	69180	68212	273	118	165	149
3	Vorë	3912	3688	3575	3575	130	36	23	26
4	Kamëz	16704	15906	15481	15247	142	45	28	25
5	Krujë	8227	7876	7663	7270	32	12	17	22
6	Bulqizë	3768	3384	3093	2946	50	36	8	9
7	Mat	2956	2746	2508	2322	35	13	11	8
8	Kavajë	4212	3872	3731	3534	17	7	7	5
9	Klos	1729	1617	1504	1412	1	0	0	0
10	Dibër	7944	7332	6981	6281	11	2	9	4
11	Rrogozhinë	2165	1868	1638	1521	12	7	1	4
12	Shijak	2645	2480	2415	2294	0	0	0	0
<b>II</b>	<b>DRAP Lezhë</b>	<b>46575</b>	<b>43684</b>	<b>41238</b>	<b>38722</b>	<b>134</b>	<b>68</b>	<b>87</b>	<b>66</b>
1	ZVA Lezhë	7504	7047	6800	6435	-	0	12	8
2	Has	2443	2322	2165	2102	-	5	9	20
3	Kukës	7171	6834	6548	6184	-	16	34	12
4	Shkodër	12940	12230	11642	10793	-	15	5	8
5	Kurbin	5756	5404	5080	4827	-	15	12	8
6	Vau dejës	2431	2218	1995	1894	-	8	15	8
7	Mirditë	1797	1643	1517	1362	-	1	0	2
8	Pukë-Fushë Arrës	1508	1328	1159	1054	-	3	0	0
9	Tropojë	2381	2239	2082	1942	0	0	0	0
10	Malësi e Madhe	2644	2419	2250	2129	0	0	0	0
<b>III</b>	<b>DRAP Fier</b>	<b>56578</b>	<b>52541</b>	<b>49079</b>	<b>45391</b>	<b>155</b>	<b>59</b>	<b>65</b>	<b>65</b>
1	ZVA Fier	12702	11862	11063	10088	49	16	15	19
2	Vlorë-Himarë	11058	10442	9867	9281	8	4	7	12
3	Lushnje	8005	7371	6802	6347	16	8	6	7
4	Mallakastër	2756	2430	2161	1856	14	8	7	6
5	Divjakë	3859	3543	3278	3021	1	0	0	4
6	Tepelenë-Memaliaj	1817	1660	1522	1387	15	9	6	4
7	Përmet-Këlcyrë	1492	1420	1306	1195	9	3	6	4
8	Sarandë-Delvinë-Konispol	4864	4538	4400	4257	18	2	8	4
9	Rroskovec	2436	2213	2053	1943	3	1	1	3
10	Gjirokastër-Libohovë	3475	3272	3110	2796	5	0	0	1
11	Patos	2231	2025	1889	1729	19	8	3	1
12	Selenicë	1374	1243	1098	944	0	0	0	0
13	Finiq-Dropull	509	522	530	547	0	0	0	0
<b>IV</b>	<b>DRAP Korçë</b>	<b>72071</b>	<b>67020</b>	<b>62608</b>	<b>57317</b>	<b>188</b>	<b>166</b>	<b>102</b>	<b>116</b>
1	ZVA Korçë+Pustec	7735	7342	6936	6554	-	19	7	7
2	Cërrik	2782	2521	2318	2137	-	28	7	24
3	Elbasan	16574	15488	14762	13427	-	52	36	24
4	Librazhd	4031	3725	3501	3030	-	9	7	10
5	Kolonjë a është Dimal ???	915	847	776	707	-	0	0	8
6	Peqin	2629	2448	2289	2092	-	6	2	8
7	Maliq	4261	4008	3758	3428	-	7	3	8
8	Kuçovë	2897	2687	2414	2249	-	21	11	7
9	Përrenjas	3561	3382	3135	2932	-	6	5	6
10	Berat	6544	6144	5767	5250	-	7	9	5
11	Pogradec	7293	6664	6120	5656	-	0	0	3
12	Devoll	2657	2420	2283	2087	-	0	0	2
13	Gramsh	2739	2523	2325	2174	-	0	0	2
14	Skrapar-Poliçan	1187	1053	922	724	-	11	0	1
15	Belsh	1883	1685	1513	1350	-	0	0	1

16	Urë Vajgurore	3407	3178	2963	2802	0	0	0	0
17	Poliçan	976	905	826	718	0	0	0	0

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga AKAP dhe të dhënave të ASCAP.

Raportin e rasteve/incidenteve për numër nxënësish (për çdo 1000 nxënës), jemi detyruar, t'a bëjmë mbi numrin total të nxënësve të regjistruar nëpër të gjitha shkollat e vendit, meqë përlllogaritja e numrit të nxënësve në shkollat, ku kanë, ose janë duke shërbyer oficerët e sigurisë, është e pamundur, për shkak të ndryshimeve të shpeshta ndër vite, qoftë të pragjeve të kuotave të nxënësve (për shkak të ndryshimeve të VKM nr. 600, datë 9.10.2018 "Për miratimin e shërbimit të sigurisë në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë", i ndryshuar), të cilat janë kusht për praninë e OS në shkolla, qoftë të vakancave, qoftë të lejeve dhe shkëputjeve për arsye të tjera nga ana e oficerëve. Rastet për t'i dhënë siguri përlllogaritjeve, në një qasje vlerësimesh krahasuese, do bëhen mbi numrin total të nxënësve të të gjithë sistemit të arsimit parauniversitar.

Numri i incidenteve dhe problematikave të raportuara për çdo 1000 mijë nxënës, në nivel Drejtorie Rajonale të Arsimit Parauniversitar, rezulton si në tabelën më poshtë:

**Tabela 10: Numri i incidenteve dhe problematikave të raportuara, për çdo 1000 mijë nxënës, për periudhën shtator 2021 – dhjetor 2024**

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar	Viti shkollor 2021 – 2022	Viti shkollor 2022 - 2023	Viti shkollor 2023- 2024	Viti shkollor 2024 – 2025, periudha shtator – dhjetor 2024	Projeksioni për vitin 2024-2025, mbi bazën e numrit të raportuar deri në dhjetor 2024.
DRAP Durrës	2,70	2,14	2,35	2,14	5,5
DRAP Lezhë	2,88	1,56	2,11	1,70	4,37
DRAP Fier	2,74	1,12	1,32	1,43	3,67
DRAP Korçë	2,61	2,48	1,63	2,02	5,19

Burimi: Të dhëna të përpunuara nga Grupi i Auditimit mbi bazën e të dhënave të ASCAP.


Katër kolonat e para numerike përcaktojnë numrin e incidenteve dhe problematikave për çdo 1000 nxënës, për 4 nënperiudhat (vitet shkollore: 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024 dhe tremestrin e parë, të vitit 2024-2025) kohore në fokus auditimi dhe janë nxjerrë nga numri i raportuar i tyre në link nga OS-të.

Por duke iu referuar raportimeve të bëra në link-un e vënë në dispozicion nga ASCAP për periudhën e parë, prej 3,5 muajsh të vitit 2024-2025, është e mundur të bëjmë një projeksion mbi ecurinë e pritur të numrit të incidenteve dhe problematikave për çdo 1000 mijë nxënës, për gjithë vitin shkollor 2024-2025, prej 9 muajsh, në mënyrë që të bëhet një vlerësim krahasimor ndërmjet viteve shkollore.

Kolona e pestë numerike, e tabelës së mësipërme, përfaqëson numrin e rasteve/incidenteve të parashikuara për vitin 2024 – 2025, nisur nga ecuria e periudhës shtator – dhjetor 2024, e vitit shkollor 2024 – 2025.

Gjithë sa parashtruar më lart vizualizohet me Grafikon 4, në vijim.

**Grafiku 4: Numri i incidenteve dhe problematikave për çdo 1000 mijë nxënës, në nivel DRAP dhe projeksioni i ecurisë së tyre për vitin 2024-2025.**



Përpunoi: Grupi i Auditimit

Për të vlerësuar nëse rritja e raportimeve varet nga rritja e numrit të oficerëve, GA ka konsideruar edhe numrin faktit të OS të punësuar, i cili ka pësuar ndryshime ndër vite, kjo për shkak se ata janë edhe burimet konkrete të informacionit, të integruar në data bazën e ASCAP.

Sikurse shihet dhe nga tabela e mëposhtme, numri i tyre ka pësuar në kohë ndryshimet si në vijim:

**Tabela 11: Numri i oficerëve të sigurisë ndër vite**

Nr.	DRAP	2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Durrës	61	54	113	103	113	100	138	104
2	Fier	23	21	37	33	37	33	44	33
3	Korçë	42	37	43	40	43	43	59	49
4	Lezhë	24	19	29	25	29	26	35	26
		150	131	222	201	222	202	276	212

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga ASCAP.

Nga tabela më sipër vërehet se fillimi i vitit 2022-2023 shënon një rritje të numrit të OS të rekrutuar, e cila nuk është shënuar me rritjen e numrit të rasteve të raportuara, gjë e cila dëshmon se numri i rasteve të raportuara për çdo oficer sigurie, ka pësuar rënie.

Nga ana tjetër kalimi nga viti 2023-2024, tek viti 2024-2025 nuk është shoqëruar me rritje të ndjeshme të numrit të OS në detyrë. DRAP-i Lezhë dhe DRAP-i Fier kanë vijuar me të njëjtin numër oficerësh sigurie. Ndërkohë që DRAP Durrës ka pasur një rritje prej 4% të numrit të tyre dhe DRAP Korçë ka shtuar numrin e tyre me 6 veta.

Referuar numrit të rasteve/incidenteve të raportuara nga OS, për vetëm periudhën shtator 2024 – dhjetor 2024, rezulton i arsyeshëm një projeksion me tendencë rritjeje, me afro dyfish e gjysmë të rasteve të raportuara për vitin 2024-2025, krahasuar me vitin 2023-2024 dhe ato të viteve të mëparshme. *Nga këto të dhëna, mund të konstatohet qartë se, gjendja dhe indikatorët e sigurisë në shkolla, kanë pësuar përkeqësim të ndjeshëm në të gjithë sistemin arsimor parauniversitar në periudhën e parë të vitit 2024-2025. Kjo fakton administrimin*

*jo efektiv të sigurisë në shkolla nga ana e oficerëve të sigurisë.* Edhe nëse kjo rritje e rasteve/incidenteve të raportuara lidhet me rritjen e alarmit dhe pasigurisë, pas ngjarjes fatale të 11 nëntorit në një nga shkollat e Tiranës dhe sensibilizimit të opinionit publik dhe mediave, atëherë deduktohet se më herët rastet nuk janë ndjekur dhe raportuar nga OS me përpikmëri, të cilët edhe në këtë perspektivë, dëshmojnë se nuk e kanë administruar sigurinë në shkolla me efektivitetin e duhur.

Sikurse u tha më sipër, përtej mangësive, të dhënat e ASCAP do na ndihmojnë të krijojmë një panoramë mbi ecurinë e ca dukurive, në shkollat shqiptare.

Lidhur me tipologjinë e incidenteve/problematikave të raportuara nga OS, për periudhën shtator 2023 – dhjetor 2024, evidenca statistikore përmbledhet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

**Tabela 12: Mbi tipologjinë e incidenteve/problematikave të regjistruara në shkollat e sistemit arsimor parauniversitar, në rang vendi, gjatë periudhës shtator 2021 - dhjetor 2024:**

Nr.	Lloji i incidentit/problematikës së ndodhur:	Viti shkollor 2021 - 2022	Viti shkollor 2022 - 2023	Viti shkollor 2023 - 2024	Viti shkollor 2024 – 2025, për periudhën deri në dhjetor 2024
1.	Përdorimi i drogës / cigares /alkoolit	30	42	21	40
2.	Posedimi/shpërndarja e drogës	15	5	3	1
3.	Armëmbajtje	9	16	9	8
4.	Zjarrvënien e qëllimshme/ fishekzjarrë	7	2	6	4
5.	Bulling (ngacmim/tallje/fyerje)	40	34	44	68
6.	Krim interneti	7	10	18	19
7.	Vjedhje/thyerje	7	8	3	
8.	Kërcënim/ shantazh/ përndjekje	62	59	27	30
9.	Ngacmim seksual	3	0	5	2
10.	Thyerja e rregullores së shkollës	32	40	39	45
11.	Sulm me armë zjarri/të tjera	5	2	5	0
12.	Ekstremizëm i dhunshëm	5	0	0	0
13.	Dhunë psikologjike/ verbale	100	92	76	65
14.	Tentativë vetëvrasje/ vetëvrasje	5	1	3	0
15.	Prishje e pronës	5	17	13	0
16.	Kërcënim me bombë	3	0	1	0
17.	Dhunë fizike	244	237	245	166
18.	Diskriminim/racizëm	11	1	1	0
19.	Vandalizëm	12	0	0	0
20.	Neglizhim	3	0	0	2
21.	Dhunë seksuale	6	1	0	0
22.	Ngjarje aksidentale	3	2	10	8
23.	Problem shëndetësor	15	15	16	14
24.	Tjetër (specifiko)	186	15	36	56

*Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga ASCAP.*

Nga raportimet e OS në link, rezulton se problematika më e shpeshtë, është ajo e dhunës fizike, me 892 raste të referuara në periudhën në fokus auditimi. Dhuna psikologjike/verbale radhitet e dyta, me 333 raste në këto vite. E treta, ndër problematikat më shqetësuese, me të

cilat ballafaqohet siguria në shkolla, është bullizmi, e cila është raportuar 186 herë, në të njëjtën periudhë.

Po ashtu shqetësim përbëjnë: kërcënimet/shantazhet/përndjekjet, me 178 raste, thyerja e rregullores së shkollës, me 156 raste dhe përdorimi i drogës/cigares /alkoolit, me 133 raste.

Po t'u referohemi të dhënave të nxjerra nga përgjigjet e dhëna nga nxënësit pyetësorëve të GA, sikurse në Shtojcën1, situata rezulton ndryshe.

Pyetjes të drejtuar nëpërmjet pyetësorit: “A keni vërejtur se në shkollën tuaj nxënësit bartin me vete?”, 227 nxënësit i janë përgjigjur si më poshtë:

**Tabela 13:** Përgjigjet e pyetjes: “A keni vërejtur se në shkollën tuaj nxënësit bartin me vete?”

	Kurrë	Një apo dy herë gjatë vitit	Një apo dy herë gjatë muajit	Një apo dy herë gjatë javës	Çdo ditë
Armë të ftohta	189	36	4	4	5
Armë zjarri	204	5	3	1	2
Drogë	194	13	3	4	3
Alkool	195	10	3	4	4
Duhan	126	36	13	16	24

Burimi: Të dhëna të nxjerra nga përgjigja e 227 nxënësve të pesë shkollave<sup>58</sup>, dhënë pyetësorit të GA.

Sikurse vihet re në tabelën e mëposhtme, të formatuar mbi rezultatet e dala nga përgjigjet e dhëna nga nxënësit pyetësorëve të GA, sikurse në Shtojcën1, shqetësuese mbeten edhe nivelet e larta të fenomeneve të dhunës fizike, bullizmit / talljes, kërcënimit dhe thashethemeve, të cilat krijojnë premisa për situata që mund të degradojnë dhe të arrijnë në rrethana ekstreme, nëse nuk identifikohen dhe trajtohen në kohë.

**Tabela 14:** Përgjigjet e pyetjes: “Që nga fillimi i vitit shkollor, sa herë në shkollë keni hasur vështirësitë në vijim?”

	Kurrë	Një apo dy here gjatë vitit	Një apo dy here gjatë muajit	Një apo dy here gjatë javës	Çdo ditë
Ju ka shtyrë dhe penguar dikush?	166	42	14	7	2
Ju ka sulmuar fizikisht (goditur)?	178	15	-	-	3
Ju ka kërcënuar dikush?	201	19	2	2	2
Ju ka prekur apo ngacmuar seksualisht?	217	5	1	-	2
Ju ka detyruar dikush që të bëni diçka kundër vullnetit tuaj?	205	12	5	1	4
Ka bërë thashetheme për ju?	113	67	17	12	9
Qeshin me ju dhe ju drejtohen me emra fyes?	174	29	6	4	2
Dikush ka shpërndarë te të tjerët përmes telefonit, internetit informacione apo foto që ju lëndojnë juve?	196	12	1	3	4
Dikush ka thyer qëllimisht diçka që ju takon juve?	201	19	2	1	3

Burimi: Të dhëna të nxjerra nga përgjigja e 227 nxënësve, dhënë pyetësorit të GA.

Po t'u referohemi të dhënave të Pyetësorit të GA, i cili iu drejtua vetëm 227 nxënësve, u konstatua se armët e ftohta janë vërejtur një apo dy herë gjatë vitit, nga 36 nxënës (sipas të dhënave të Tabelës 13), apo 15,8 % e tyre, kuptojmë se sa të mangëta janë të dhënat e referuara nga OS në ASCAP, sipas të cilave, në vitin 2022 – 2023, me numrin më të lartë të

<sup>58</sup> Shkolla e Bashkuar Zejmen - Lezhë, Shkolla e Mesme të Bashkuar Gosë - Rrogozhinë, Shkolla 9 vjeçare "Fan Noli" - Tiranë, Gjinnazi "Eqrem Çabej" - Tiranë, Gjinnazi "Arben Broci" - Tiranë

referimit të rasteve të këtij lloji, rezulton të ketë pasur vetëm 16 raste (sipas të dhënave të Tabelës 12), për të gjithë shkollat e Shqipërinë, ku janë vendosur OS – të, për më tepër qoftë për të dyja kategoritë e armëve, të ftohta dhe ato të zjarrit.

I njëjti arsyetim vlen edhe në krahasimin e të dhënave të këtyre dy burimeve të evidencave statistikore, lidhur me rastet e mbajtjes dhe përdorimit të drogës / alkoolit / duhanit, nga ku rezulton, se me këtë fenomen, nga 227 nxënësit e intervistuar, janë ndeshur një apo dy herë në viti, 59 veta (13+10+36, sipas Tabelës 11), ndërkohë që, në vitin 2022 - 2023 me numrin më të lartë të referimit të rasteve të këtij lloji nga OS - të tek ASCAP, rezulton të ketë pasur vetëm 47 (42+5, sipas Tabelës 12) raste, për të gjithë shkollat e Shqipërinë, ku janë vendosur OS - të.

Këto statistika të gjeneruara nga referimet e oficerëve të sigurisë në link – un e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, japin një panoramë të deformuar dhe të pasaktë lidhur me fenomenet dhe indikatorët e sigurisë në shkolla, duke krijuar premisa për një lexim të tjetërsuar të realitetit.

➤ ***Oficerët e sigurisë nuk zhvillojnë kontrolle fizike të nxënësve dhe mjediseve të shkollave***

Mosnjohja e realitetit problematik të sigurisë në shkollat shqiptare, kushtëzohet shumë edhe nga moszbatimi i detyrimeve funksionale nga OS - të, sikurse përcaktuar në aktet rregullatore.

Sipas Urdhrit Nr. 31, datë 28.1.2020, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Oficeri i Sigurisë “Zhvillon kontrolle fizike të nxënësve oOfise të mjediseve, vetëm në raste emergjente ose me vendim nga drejtoria e IA-së”<sup>59</sup>.

Në pesë shkollat (Shkolla e Bashkuar Zejmen - Lezhë, Shkolla e Mesme të Bashkuar Gosë - Rrogozhinë, Shkolla 9 vjeçare “Fan Noli” - Tiranë, Gjimnazi “Eqrem Çabej” - Tiranë, Gjimnazi “Arben Broci” - Tiranë) ku intervistuan OS – të dhe Drejtuesit e IAP – ve, në fazë terreni, u shtrua pyetja, se: “Sa kontrolle fizike janë zhvilluar nga OS – të gjatë periudhës objekt auditimi?”.

Referuar përgjigjeve të dhëna dhe këqyrjes së dokumenteve të dosjeve të OS - ve, u konstatua, se kontrolli fizik i nxënësve dhe ai mjedisor, për të evidentuar raste armëmbajtjeje, posedim lëndësh narkotike, apo pijeve alkoolike, përjashtuar gjimnazi “Arben Broci”, nuk ishte zhvilluar kurrë gjatë gjithë këtyre viteve, në këto shkolla.

Përjashtim bënte, sikurse u tha më lart, vetëm gjimnazi “Arben Broci”, ku u konstatua se, “më datë 16.05.2023, u ushtrua kontrolli i çantës së nxënësit E. Z. të cilit iu konstatua prania e parave dhe hashashit. Për rastin, sipas procesverbalit në dosjen e OS u thirr menjëherë policia.

Po ashtu, në datën 11.12.2024, është referuar një raport incidenti, i gjeneruar në vijim të një kontrolli fizik të nxënësit A. M. nga OS. Nxënësit i është gjetur kaçavidë dhe thikë”<sup>60</sup>.

Arsyet dhe justifikimet e dhëna nga OS gjatë intervistave për moszhvillimin e kontrolleve fizike ishin të ndryshme.

“Mundohem t’a shmang kontrollin fizik, që të evitoj konfliktin me prindërit, meqë e cilësojnë si etiketim të fëmijës. Porse dyshimet i ndaj me SPZ. Nuk kemi bërë asnjë kontroll fizik”<sup>61</sup>. – u shpreh oficeri i sigurisë të Gjimnazit “E. Ç.”.

<sup>59</sup> Paragrafi 18, i nenit 33, “Detyrat dhe përgjegjësitë e oficerit të sigurisë”, të Urdhrit Nr. 31, datë 28.1.2020, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

<sup>60</sup> Intervistë dhe kqyrje e dosjes së punës së OS më datë 06.05.2025

<sup>61</sup> Intervistë dhe kqyrje e dosjes së punës së OS më datë 30.04.2025

Në shkollat ku GA ishte gjatë fazës së terrenit, arsyet e moszhvillimit të kontrolleve, lidheshin me hezitimin e OS – ve për t’u ballafaquar me situata konflikti dhe denoncimi, që pasojnë konstatimin potencial të sendeve të lartpërmendur.

➤ ***Oficerët e sigurisë nuk përdorin instrumentet matës***

Në Udhëzuesin për praktikën e punës së Oficerëve të Sigurisë pyetësorët/instrumentet matës përcaktohen si një hallkë tjetër e rëndësishme e realizimit të detyrës së oficerëve të sigurisë. Oficerët e sigurisë mund të përdorin dhe instrumente të tjera matëse gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, përveç atyre që janë jashtë këtij Udhëzuesi, sipas nevojës dhe karakteristikave të shkollës. Pyetësi për nxënës, mund të zhvillohet në fillim ose përgjatë vitit, për të evidentuar konkretisht rreziqet me të cilat mund të përballen nxënësit, shpeshësinë e tyre, ambientet në të cilat ndodhin. Ky pyetësor shërben për të diagnostikuar situatën në të gjithë shkollën, në klasa të caktuara, gjithashtu ndikon për të ndihmuar në ndërgjegjësimin e nxënësve duke u nisur nga gjendja reale e shkollës. Rezultatet e pyetësorit mund t’i vihen në dispozicion edhe prindërve, oficerit të policimit në komunitet, kur problematikat ndodhin jashtë shkollës, për të hartuar plane masash sigurie. Ky akt rregullator parashikon edhe përdorimin e pyetësorëve për prindër, si dhe për mësues.

Grupi i auditimit gjatë fazës së terrenit, paralelisht me verifikimin e dosjeve të OS – ve, në intervistat e zhvilluara, lidhur me pyetësorët, kërkoi informacion mbi rastet e përdorimit të tyre me mësues, nxënës dhe prindër, gjatë periudhës objekt auditimi.

Lidhur me përdorimin e këtyre instrumenteve matës, gjatë periudhës shtator 2021 – dhjetor 2024, në pesë shkollat e verifikuara në fazë terreni (pas disa të tjerave të vizituara në fazë studimore), gjendja rezultoi si më poshtë:

Në Shkollën e Bashkuar Zejmen, sipas intervistës dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi, se: “Nuk ka të dokumentuar asnjë përdorim të instrumenteve matës”, pra nuk janë përdorur asnjëherë.

Në Shkollën e Mesme të Bashkuar Gosë, sipas intervistës dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi, se: “Nuk janë përdorur instrumentet matëse, mbi bazën e të cilave matet efektiviteti i aktivitetit të OS në shkollë”, pra nuk janë përdorur asnjëherë.

Në Shkollën 9-vjeçare “Fan Noli”, sipas intervistës dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi, se: “Instrumente matës/pyetësor nuk disponohen në dosje pavarësisht se i kishin shpërndarë në dy vitet e aktivitetit. Ato të 2023-2024 janë marrë nga MAS, ndërkohë që ato të fillim vitit 2024-2025 ishin në shtëpinë e oficerit të sigurisë, se po bën statistikat, - vuri në dukje OS”. Pra përtej mosdokumentimit të përdorimit të këtyre instrumenteve matës, mbetet fakt që pranohet se nuk ka asnjë rezultat apo të dhënë, të marrë prej tyre, mbi indikatorët e sigurisë në shkollë, qëllim për të cilin përdoren.

Në Gjimnazin “Eqrem Çabej” sipas intervistës dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi se: “Janë përdorur vetëm një herë në dhjetor 2024, me mësues dhe nxënës. Me prindër jo, meqë ata nuk kanë familjaritet me teknologjinë”. Pra në vitet shkollore 2021-2022, 2022-2023. 2023-2024 nuk janë përdorur, ndërkohë që hera e vetme kur janë përdorur (dhjetor 2024), nuk ka dhënë asnjë rezultat apo indikator mbi gjendjen e sigurisë në shkollë.

Në Gjimnazin “Arben Broci”, në vijim të intervistës së datës 06.05.2025 dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi se: “Nuk janë përdorur pyetësorë dedikuar sigurisë në një kuptim të mirëfilltë të fjalës, si ata të përfshirë si shtojca në udhëzues, pavarësisht se janë bërë pyetësorë nga shërbimi psikosocial për drogën dhe bullizmin”. Pra nuk janë përdorur instrumentet matës dhe në rastet e ndonjë përdorimi pyetësorësh, rezultatet nuk dokumentohen.

➤ *Mungon kriteri, se kur një referim i incidentit/problematikës, i drejtohet edhe Policisë së Shtetit*

Grupi i Auditimit që nga faza studimore e përgjatë gjithë fazës së terrenit, në kontakt me OS – të dhe drejtuesit e IAP – ve, i kushtoi vëmendje të posaçme identifikimit të kriterit mbi bazën e të cilit raporti i incidenteve/problematikave i drejtohet përveçse titullarit të institucionit arsimor dhe ZVAP - së edhe organeve të Policisë së Shtetit (sipas vlerësimit të rastit).

Trajtimi me vëmendje i këtij aspekti, gjykuam se do kontribuonte edhe për të vlerësuar nëse bashkëpunimi me Policinë e Shtetit, në administrimin e ngjarjeve, ndjek një standard të mirëpërcaktuar, apo i ekspozohet vlerësimit subjektiv të oficerëve të sigurisë.

Ky kriter i munguar në Udhëzuesin për praktikën e punës së Oficerëve të Sigurisë<sup>62</sup> lë hapësirë për diskrecion, i cili nëse përdoret pa objektivitet dhe profesionalizëm nga OS – të mund të çojë në krijimin e situatave të pamenaxhueshme dhe me pasoja ekstreme. Nga ana tjetër, ky kriter i munguar, i bën të paragjyqeshme shumë zgjedhjet e OS – ve, meqë nën dritën e sa u referua nga ASCAP, lidhur me procesin e raportimit të rasteve/incidenteve në link dhe mosevidentimin e emrit të shkollës, ku regjistroheshin rastet, u bë e qartë qasja vetëçensuruese e oficerëve të sigurisë lidhur me procesin, si pasojë e trysnisë së drejtuesve të shkollave.

Kjo qasje okultuese, që çon në mosreferimin e rasteve në link – un e ASCAP, mbetet një rrezik konkret, edhe sa i përket detyrimit për të raportuar rastet/incidentet në polici, veçanërisht në mungesë të një kriteri të prerë ligjor.

Me të tilla dilema, ndeshen edhe praktikatat e huaja më të mira, si ajo e një prej vendeve skandinave, Suedisë.

Në Raportin e publikuar me 2 janar 20218, “Police-reported school violence among children below the age of criminal responsibility in Sweden – signs of increased sensitivity and segregation? Dhuna shkollore e raportuar nga policia mes fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale në Suedi – shenja të rritjes së ndjeshmërisë dhe segregimit?”<sup>63</sup>, vë në dukje se: “*Dhuna mes nxënësve të shkollës, mund të konsiderohet në mënyra të ndryshme. Një raport policor është një mënyrë për të tërhequr vija rreth sjelljes së papranueshme. Megjithatë, mund të jetë gjithashtu një thirrje për ndihmë në një situatë të pamenaxhueshme ose një kapitullim ndaj rrethanave. Në përgjithësi, nuk ka konsensus se cilat incidente duhet të raportohen në polici si vepra penale. Numri i incidenteve të raportuara në polici si vepra penale varet jo vetëm nga sa incidente ndodhin në të vërtetë në shkolla, por edhe nga presioni i prindërve për të bërë raporte, ndryshimi i legjislacionit dhe besimi në kapacitetin e autoriteteve të ndryshme ose të familjes për të trajtuar këto probleme.*”

Pyetjes së GA, se “Mbi bazën e cilit kriter kryhet “vlerësimi i rastit” nga ana e OS - ve, sa i përket detyrimit të dërgimit të raportit të incidenteve/problematikave tek....., organet e Policisë së Shtetit ....?”, oficerët e sigurisë iu përgjigjën si në vijim.

Në Shkollën e Bashkuar Zejmen, gjatë intervistës së datës 17.04.2025 OS pohoi, se: “Dhuna ekstreme mund të jetë rasti që raportohet. Ajo e kalon kompetencën tonë për t’a menaxhuar brenda shkolle. Nuk kemi pasur raste që e kanë bërë të nevojshme ndërhyrjen e specializuar të strukturave të tjera nga jashtë shkollës.” Dhe më tej: “Rastet më madhore nuk janë bërë objekt i dokumentit të “Referimit të rastit”, ndaj dhe nuk administrohen në dosjen e

<sup>62</sup> Udhëzues për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit.

<sup>63</sup> <https://www.scup.com/doi/10.1080/14043858.2017.1393875>

OS, i cili bashkë me aktorët e tjerë i ka trajtuar brenda mjediseve të shkollës verbalisht, nëpërmjet këshillimit.”.

Në Shkollën e Mesme të Bashkuar Gosë, në intervistën e datës 24.04.2025 u nënvizua, se: “Sinjalizimi me një raport incidenti tek organet e Policisë së Shtetit, - vlerësohet nga Drejtoresha, si i nevojshëm, kur nuk ka pajtim mes palëve të përfshira në ngjarje. Në të kundërt rastet menaxhohen në shkollë. Kriter fiks nuk ka për këtë çështje.”.

Në Shkollën 9 vjeçare ”Fan Noli”, gjatë intervistës së datës 22.04.2025 me OS - në u vu në dukje, se: “Referoj rastet e dhunës fizike në polici, por jo të dhunës psikologjike. Në shumë raste referimet në polici nuk kanë vijuar me marrje masash nga ana e policisë. Atëherë shtrohet pyetja se përse duhet të referojmë rastin në polici? E kam përjashtuar referimin e dhunës psikologjike në polici, meqë kur nuk shohim masa konkrete të marra nga policia për dhunë fizike, gjykoj se nuk ka ndonjë benefit, po qe se do referoja dhunën psikologjike. Rastet e bullizmit kibernetik i referoj tek SPZ, tek zyra kibernetike e Drejtorisë së Policisë së Tiranë,” - u shpreh OS.

Në Gjimnazin “Eqrem Çabej” në intervistën e datës 30.04.2025, OS nënvizoi se: “Rast pas rasti dhe individ pas individ, bëhet vlerësimi i cili përcakton se cili incident/problematikë raportohet tek organet e Policisë së Shtetit. Kam komunikim të vazhdueshëm me SPZ - në, ndaj që edhe kur nuk e përfshij në raportimin e incidentit, unë konsultohem dhe e informoj për gjithçka, lidhur edhe me raste në dukje jo problematike”, - shprehet OS”.

Në Gjimnazin “Arben Broci”, gjatë intervistës së datës 06.05.2025, OS u shpreh, se: “Unë raporto gjithçka tek SPZ, telefonikisht apo gojarisht meqë SPZ vjen vazhdimisht në shkollë. Sharjet nuk i raportojmë jashtë shkollës. Ne dallimin e bëjmë rast pas rasti dhe individ pas individ. Verifikojmë burimin dhe vërtetësinë e informacionit. Pastaj bëhet vlerësimi i cili përcakton se cili incident/problematikë raportohet tek organet e Policisë së Shtetit. Kam komunikim të vazhdueshëm me SPZ, sikurse dhe me DVPP Tiranë”.

*Sikurse nga pohimet oficerëve të sigurisë dhe praktika e punës së tyre, mungon një kriter i qartë, lidhur me detyrimin e raportimit të problematikave/incidenteve në polici, për kategori rastesh, dhe vlerësimet dhe reagimet e OS – ve janë të ndryshme për çështjen, duke shprehur edhe skepticizëm mbi vlerën e bashkëpunimit.*

Ky kriter mungon edhe në Udhëzuesin për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë<sup>64</sup>, i cili është dokumenti udhërrëfyes për të gjithë aktivitetin e oficerëve të sigurisë në shkolla.

Vetë oficerët e sigurisë, sikurse u vu në dukje më herët nga ASCAP, pranojnë “se janë ndjerë nën presionin e drejtuesve për të raportuar” në link –un e ASCAP. Ndaj OS vetëçensurojnë raportimin, në këtë proces.

Rikujtojmë qasjen e OS lidhur me kontrollin fizik, për sa u referua më lart, kur nënvizohej, se shmangej që të evitohet konflikti me prindërit, duke lënë kështu oficeri i sigurisë pa zhvilluar me vetëdije një detyrim të parashikuar në një akt rregullator.

Atëherë shtrohet pyetja, se si do përdorej ky diskrecion, që Udhëzuesi i lë oficerëve të sigurisë, që “sipas vlerësimit të rastit” të vendosë nëse problematikën/incidentin t’ia raportojë policisë apo jo? A e ka objektivitetin dhe kompetencën profesionale një oficer sigurie, i cili kushtëzohet nga presioni i rrethanave dhe aktorëve të tjerë, duke lënë me vetëdije të pazbatuara detyrime të parashikuara qartë në akte nënligjore, që pikërisht në heshtjen e këtyre akteve, të vendosë me përpikmëri atë zgjedhje dhe zgjidhje e cila i përshtatet administrimit të rastit/incidentit, duke vendosur referimin ose jo tek policia e shtetit?

Oficerët e sigurisë certifikohen si të tillë, pasi në Akademinë e Sigurisë zhvillojnë trajnimin me afro 120 orë, ku vetëm gjysma e këtyre orëve i dedikohen formimit teorik. Me afro 60 orë teori, aspekte të tilla vështirë të sqarohen dhe kuptohen.

---

<sup>64</sup> Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit

U tha më lart, kur iu referuam rastit të praktikës suedeze, se edhe atje konstatohet mungesa e një kriteri, që përcakton se kur duhet referuar problematika/incidenti në polici. Por është kulturalisht e justifikuar, kjo mungesë kriteri në Suedi, meqë “*Vendet skandinave janë shënuar si përjashtime në krahasimet ndërkombëtare dhe evropiane në lidhje me zhvillimin e ndjeshmërisë kulturore në lidhje me krimin. Këto vende janë përgjithësisht më pak të prirura për të interpretuar konfliktet e përditshme si krim.*”<sup>65</sup>. Po ashtu duhet të kemi parasysh, se shkollat e sistemit parauniversitar në Suedi janë nën administrimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe se “Oficerët - nëpunësit e sigurisë dhe shëndetit”, janë punonjës bashkiakë, me tjetër formatim profesional dhe praktikë të mirëstrukturuar. “*Megjithatë, anketat e përsëritura dhe analizat kritike të veprave penale të regjistruara kanë treguar se ka pasur një rritje të ndjeshmërisë kulturore në vitet e fundit, madje edhe në vendet skandinave. Kjo mund të ilustron nga zhvillimi që duket se ka ndodhur në Finlandë. Pati një rritje të përgjithshme në prirjen për të bërë raporte policore...*”<sup>66</sup>

➤ ***Komunikimi jo formal ndërmjet oficerëve të sigurisë dhe aktorëve të tjerë në shkollë***

Oficerët e sigurisë të dislokuar në shkollë për herë të parë më datë 15.03.2018, vetëm në vitin 2023, me miratimin nga MAS e “Udhëzuesit për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë”, në 11 tetor 2023 arritën të pajiseshin me një akt rregullator kuadër, i cili do përcaktonte linjat udhëheqëse, të afta për të orientuar në mënyrë të qartë dhe formale, aktivitetin e tyre të përditshëm.

Oficeri i sigurisë e zhvillon aktivitetin në shkollë dhe komunikimi i tij me drejtuesit, me mësuesit, me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe me nxënësit mund të jetë formal dhe joformal. Gjatë komunikimit formal kërkohet dokumentimi i tij, në një nga format zyrtare, sipas formateve përkatëse.

Një dokument i cili kontribuon për një komunikim formal brenda institucionit të arsimit parauniversitar, ndërmjet oficerit të sigurisë dhe drejtuesit të shkollës është formati i raportimit memo. “Memorandum është një shënim, dokument a çdo komunikim tjetër që ndihmon kujtesën duke regjistruar ngjarje, sinjalizim për një situatë të caktuar, tërheqje të vëmendjes ose vërejtje mbi një temë të caktuar brenda strukturave të një institucioni arsimor”<sup>67</sup>.

Nga njohja e Grupit të Auditimit me përmbajtjen e dosjeve të punës së oficerëve të sigurisë, të pesë shkollave të lartpërmendura, gjatë periudhës shtator 2021 – dhjetor 2024, rezultoi se vetëm një herë, është përdorur kjo formë komunikimi formal, më datë 25.09.2024<sup>68</sup> kur kërkohet mbulimi me patrullim policie dhe asnjë rast tjetër.

➤ ***Planifikimi vjetor i veprimtarive të oficerëve të sigurisë është joefektiv***

“Një proces mbi të cilin mbështetet gjithë veprimtaria e oficerit të sigurisë, është ai i planifikimit vjetor të veprimtarive, të cilat i realizon brenda shkollës, në përputhje me strukturën e vitit shkollor. Oficerët e sigurisë në shkollë planifikojnë veprimtaritë që do të ofrojnë për nxënësit, për stafin e shkollës dhe për personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, pasi kanë vlerësuar nevojat e tyre. Plani vjetor është forma e cila do të përshkruan objektivat e punës së oficerit të sigurisë dhe treguesit të përmbushjes së secilit objektiv. Ky plan hartohet në fillim të vitit shkollor dhe dërgohet për miratim tek titullari i institucionit

<sup>65</sup> <https://www.scup.com/doi/10.1080/14043858.2017.1393875>

<sup>66</sup> <https://www.scup.com/doi/10.1080/14043858.2017.1393875>

<sup>67</sup> Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit

<sup>68</sup> Sipas intervistës së datës 22.04.2025 dhe verifikimit të dosjes së punës së OS

arsimor, një kopje i dërgohet ZVAP – së”<sup>69</sup>. Sikurse u tha, disa paragrafë më parë, oficerët e sigurisë me mospërdorimin e instrumenteve matës e kanë privuar veten nga marrja e të dhënave mbi gjendjen reale të problematikave, që lidhen me sigurinë në shkolla, duke e bërë më të vështirë edhe identifikimin e nevojave, që i referohen këtij objekti. Gjithsesi, përtej kësaj paranteze, Grupi i Auditimit verifikoi dhe vlerësoi këtë proces të rëndësishëm, mbi bazën e dokumentimit ose jo, të tij në dosjen e punës së OS - ve, si dhe intervistimit të oficerëve, për të sqaruar paqartësitë.

Në Shkollën e Bashkuar Zejmen, sipas intervistës së datës 17.04.2025 dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi se: “Për vitin 2021 - 2022 nuk ka asnjë planifikim vjetor të veprimtarive. Për vitin 2022 - 2023 dokumentohet një plan vjetor për shërbimin psiko-social, ku ka kontribuar në hartimin e tij edhe OS, përveç psikologes, por nuk ka një plan të veprimtarive të OS. Në dosje dokumentohet plani i vjetor i veprimtarive të OS, për vitin 2023 - 2024, i cili është miratuar më 06.09.2023, nga Drejtori i shkollës. Plan i vjetor i veprimtarive të OS për vitin 2024-2025, miratuar më 02.09.2024, nga Drejtori. Nuk ka asnjë dokument në dosjen e OS, që provon realizimin e aktiviteteve të parashikuara në planet vjetore të veprimtarive të tij”.

Si i tillë procesi i planifikimit vjetor të veprimtarive të OS, ose mungon fare, ose është formal, i pazbatuar dhe jo efektiv.

Në Shkollën e Mesme të Bashkuar Gosë, sipas intervistës së datës 24.04.2025 dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi, se: “Nuk dokumentohen në dosje e OS planet vjetore për veprimtarinë e tij për vitet shkollore, 2021 – 2022, 2022 – 2023, 2023 - 2024. Rezulton të jetë përgatitur një plan vjetor i veprimtarive për vitin 2024- 2025, por ky dokument nuk ka as firmën e OS. Nga ky planifikim vjetor, me zgjedhje u verifikua zbatimi i Objektivit 4.2 : “Njohja e nxënësve me rreziqet e lëndëve narkotike dhe penaltetet ligjore” dhe lidhur me përshkrimin e treguesit 4.2.2: “Ndërgjegjësimi i nxënësve mbi fenomenin negativ të përdorimit, shitjes, prodhimit të substancave narkotike dhe masat që legjislacioni penal sanksionon” u vërejt, se në dosje e punës së OS, nuk dokumentohet zhvillimi i veprimtarisë, gjatë tremujorit të parë të vitit shkollor 2024 – 2025, ndërkohë që veprimtaria ishte programuar të fillonte të zhvillohej, që nga muaji shtator 2024.”. Si i tillë, edhe në këtë shkollë, procesi i planifikimit vjetor të veprimtarive të OS, ose mungon fare, ose është formal, i pazbatuar dhe jo efektiv.

Në Shkollën 9 vjeçare ”Fan Noli”, sipas intervistës së datës 22.04.2025 dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi, se: “Janë përgatitur planet vjetore të veprimtarive të OS - së, për vitin 2023-2024, pavarësisht se mungon firma e tij, ndërkohë që planifikimi i veprimtarive për vitin 2024 – 2025 duket në përputhje me standardin e dokumentit, sipas Udhëzuesit<sup>70</sup>. Nga planifikimi vjetor 2023 - 2024, me zgjedhje u verifikua realizimi i Treguesit 3.1.3 “Takime me prindërit e nxënësve të identifikuar”. Sikurse rezultoi, takimet me prindërit e nxënësve të identifikuar, të planifikuara të zhvilloheshin nga shtatori, deri në qershor, nuk dokumentohet të jetë kryer si aktivitet për vitin 2023-2024, meqë nuk ka gjurmë dokumentare.”. Si i tillë, edhe në këtë shkollë, procesi i planifikimit vjetor të veprimtarive të OS, është formal dhe jo efektiv. Veprimtaritë nuk dokumentohen të jenë zhvilluar.

Në Gjimnazin “Eqrem Çabej”, sipas intervistës së datës 30.04.2025 dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi, se: “Planet vjetore të veprimtarive të OS janë përgatitur qartë dhe të detajuar, si dhe rezultojnë të kenë marrë miratimin nga Drejtoresha e shkollës. Nga planifikimi vjetor i veprimtarive të OS, për vitin 2024 - 2025, me zgjedhje u verifikua realizimi

---

<sup>69</sup> Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit

<sup>70</sup> Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit

i Treguesit 1.2.1 “Mbledhje me mësuesit në sallën e aktiviteteve”. Sikurse konstatuar, nuk ka gjurmë dokumentare në dosje, për realizimin e veprimtarisë të programuar “Diskutim në lidhje me procedurën që do të ndjekim në raste problematikash që do të krijojnë nxënës të caktuar. Ndarje dhe shkëmbim mendimesh me mësuesit e klasave kujdestare”, parashikuar në periudhën shtator – tetor 2024. Si i tillë, edhe në këtë shkollë, procesi i planifikimit vjetor të veprimtarive të OS, është formal, dhe jo efektiv. Veprimtaritë nuk dokumentohen të jenë zhvilluar.

Në Gjimnazin “Arben Broci”, sipas intervistës së datës 06.05.2025 dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi se: “Planet vjetore të veprimtarive janë përgatitur nga OS dhe janë miratuar nga Drejtoresha e shkollës. U verifikua me zgjedhje realizimi i aktiviteteve për Objektivin 8 “Jo Drogat – Alkol - Duhan”, të planit vjetor 2022-2023 dhe u konstatua mbi bazën e të dhënave dokumentare në dosje, se aktiviteti i parashikuar për muajt prill – maj është realizuar. Veprimtaria është dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore mbi formatin dhe përmbajtjen e tij. Porse në dokumentin e veprimtarisë mungojnë firmat e OS dhe SHPS, si dhe mjeku i parashikuar në plan të ishte pjesëmarrës, nuk është bërë pjesë e aktivitetit.”.

#### ➤ **Raportime të munguara, formale dhe jo të sakta**

Një nga detyrat e oficerit të sigurisë, sikurse parashikuar në Udhëzuesin për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar nga MAS, është të raportojë në vijimësi, si nëpërmjet raportimit të incidenteve/problematikave, ashtu edhe nëpërmjet raportimit javor dhe atij vjetor.

“Raporti i incidenteve/problematikave i drejtohet titullarit të institucionit arsimor, ZVAP - së, organeve të Policisë së Shtetit (sipas vlerësimit të rastit) dhe strukturave për mbrojtjen e fëmijës (për rastet kur vlerësohet fëmijës i duhet dhënë mbrojtja)”<sup>71</sup>.

“Raporti javor është formë raportimi për të përmbledhur gjithë punën javore të oficerit të sigurisë, aktivitetet e zhvilluara dhe problematikat e hasura, konkluzionet dhe përfundimet e punës së tij.”<sup>72</sup>. Ky raportim bëhet tek titullari i institucionit arsimor, ZVAP - ja dhe tek Specialisti i Policisë së Zonës.

Dokumenti është i ndërtuar nga ballina e tij që përmban një informacion të detajuar të përgjithshëm dhe në dy pjesë kryesore të tij: pasqyra statistikore javore dhe përmbledhje javore.

1. Pasqyra statistikore javore përmbledh gjithë rezultatet e punës së oficerit të sigurisë për periudhën të cilën raporton. Këto të dhëna vijnë nga raportet e problematikave/incidenteve, të cilat, oficeri i sigurisë ka hartuar për secilin incident apo problematik.
2. Përmbledhja javore përshkruan aktivitetet e realizuara për periudhën e raportimit, përshkrimin e aktiviteteve, problematikat e hasura gjatë ushtrimit të detyrës dhe përfundimet për personat të cilët ju dorëzohet ky format raporti.

“Raporti vjetor është forma e raportimit më të detajuar e oficerit të sigurisë, ku duhet të përmbledh gjithë ecurinë e punës së tij vjetore, objektivat dhe veprimtaritë e përmbushura nga plani vjetor i punës, ku dhe jep informacione për secilën nga rubrikat e sugjeruara në formatin tip”<sup>73</sup>. Ky raportim bëhet te titullari i institucionit arsimor, ZVAP - ja. Raporti vjetor hartohet sipas formatit dhe strukturës tip. Për hartimin e raportit vjetor duhet të ndiqen rubrikat që janë përcaktuar në formatin tip.

<sup>71</sup> Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit

<sup>72</sup> Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit

<sup>73</sup> Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit

Vlerësimi i proceseve të raportimeve si më lart përmendur u bë nga Grupi i Auditimit duke verifikuar dosjet e punës së oficerëve në pesë shkollat e verifikuara në fazë terreni (pas disa të tjerave të vizituara në fazë studimore) dhe duke intervistuar të njëjtët. Një pjesë e problemeve të konstatuara u lanë të përmendura në intervistat e zhvilluara. Për të qenë korrekt, Grupi i Auditimit këto intervista ua ka përcjellë në e – maillet zyrtare shkollave, pa u larguar prej tyre. Administrimi i procesit të raportimeve reflektohet nga konstatimet dhe vlerësimet e mëposhtme.

Në Shkollën e Bashkuar Zejmen, sipas intervistës<sup>74</sup> dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi, se: “Gjatë vitit shkollor 2023-2024 mungojnë raportet javore të periudhave nga 3.11.23 - 24.11.23 dhe 15.12.23 - 12.01.2024

Lidhur me përshkrimet vihet re se:

Ndërkaq tek raporti javor i përgatitur më 06.10.23, tek “Pasqyra statistikore lloji i incidenteve, referohet se ka 0 raste incidentesh/problematikash, ndërkohë tek “Përmbledhja javore”, referohet se ka raste të duhan pirjes. Pra ka mospërputhje në të njëjtin raport javor.”. Konstatohen pra, se raportimi për periudha të caktuara mungon fare dhe kur bëhet, nuk mungojnë rastet që reflektojnë se ai bëhet formalisht, meqë informacioni i përcjellë është kontradiktor, pasi të dhënat e një seksioni nuk konfirmohen tek seksioni tjetër i të njëjtit dokument.

Në Shkollën e Mesme të Bashkuar Gosë, sipas intervistës<sup>75</sup> dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi, se: “Raportet javore të oficerit të sigurisë konstatohen me problematikat, si më poshtë:

Nuk janë javore por për periudha të ndryshme ose tre, ose katër ditore;

Ka në dosje raporte javore, për të njëjtën periudhë, me informacion që nuk përputhen mes tyre (raste dublim dokumentacioni) 20.11.2023 - 24.11.2023 dhe 21.10.2024 -25.10.2024;

Mungon firma e OS;

Mungon numërtimi i rasteve, në pasqyrën statistikore;

Raporti javor firmoset nga SPZ në të shumtat e rasteve, ndërkohë SPZ nuk firmos raportet e incidenteve;

Në raportin javor 9.9.2024-13.09.2024 nuk pasqyrohen raportimi i incidentit i datës 10.09.2024. pra ka mospërputhje dhe mungon dhe proces verbali i incidentit.”.

Po ashtu: “Në raportin vjetor 2023-2024, rubrika: “Raportimi i incidenteve gjatë vitit”, nuk jep të dhëna për incidentet e regjistruara gjatë vitit shkollor. Në rubrikën: “Realizimi i planit vjetor”, nuk ka informacion dhe mungojnë firmat e OS dhe Titullarit të IA.”.

Konstatohet pra se, raportet javore nuk mbulojnë periudha aktiviteti 7 ditor kalendarik, se ka dublim raportesh me pasqyra të dhënash që kundërshtojnë njëra – tjetrën, nuk ka numër rastesh në pasqyrën statistikore, ka raporte incidentesh, të cilat nuk janë të reflektuar tek raporti javor, raporti vjetor 2023 – 2024 nuk pasqyron të dhëna as tek “Raportimi i incidenteve gjatë vitit” dhe as tek “Realizimi i planit vjetor”. Procesi i raportimeve të OS – së është formal, jo i saktë, dhe jo i plotë.

Në Shkollën 9 vjeçare ”Fan Noli”, sipas intervistës<sup>76</sup>dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi, se: “Në raportet javore mungojnë shpesh firmat e OS. Ka raste që “pasqyrat statistikore javore”, nuk përkojnë me “përmbledhjen javore”, si ai i datë 15.11.2025.

**Raporti vjetor për 2023 - 2024 ka një total prej një faqeje (si në fotokopje) i cili nuk ka asnjë rubrikë.”.** Konstatohet pra, formalizëm dhe mangësi në raportimet e oficerit të sigurisë. Nuk është aspak e justifikueshme raportimi për punën e një viti, me një faqe përshkrim, e pa asnjë rubrikë.

---

<sup>74</sup> Intervista e datës 17.04.2025

<sup>75</sup> Intervista e datës 24.04.2025

<sup>76</sup> Intervista e datës 22.04.2025

Në Gjimnazin “Eqrem Çabej” sipas intervistës<sup>77</sup> dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi se: “Dokumentacioni i administruar në dosje lidhur me raportimet javore është i rregullt dhe i saktë. Raportet vjetore janë të depozituar në dosjen e OS dhe janë plotësuar me përpikmëri rubrikat gjatë hartimit të tyre”. Konstatohet se OS e ka përmbushur me seriozitet detyrimin e raportimeve, sikurse parashikuar nga aktet rregullatorë.

Në Gjimnazin “Arben Broci”, në vijim të intervistës<sup>78</sup> së datës 06.05.2025 dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi se: “Dokumentacioni i administruar në dosje, sa i përket raportimeve javore, është i rregullt dhe i saktë, me ndonjë përjashtim, si në rastin e raportimit javor 25.09.2023 - 29.09.2023, i cili nuk e përshkruan rastin e raportimit të incidentit të 28.09.2023 datës. Raportet vjetore janë të depozituar në dosjen e OS dhe janë plotësuar me përpikmëri rubrikat gjatë hartimit të tyre”. Konstatohet dhe në këtë shkollë, se OS e ka përmbushur me seriozitet detyrimin e raportimeve.

#### ➤ *Mungojnë planet e masave*

“Plani i masave është një mjet planifikimi që përdoret për menaxhimin dhe kontrollin e detyrave pas një situatë apo problematike të caktuar në institucionin arsimor. Si i tillë, ai funksionon si një udhërrëfyes që përcakton mënyrën në të cilën grupi i detyrave të nevojshme arrin objektivat dhe qëllimet që do të organizohen, drejtohen dhe zbatohen”<sup>79</sup>. Si i tillë, ky plan është projektuar të zgjedh menaxhimin e situatës apo problematikës, duke kursyer kohë dhe përpjekje dhe duke përmirësuar performancën për të arritur objektivat e përcaktuara. Plani i masave është shumë i dobishëm për një problematikë apo situatë të caktuar pasi koordinon dhe angazhon një grup njerëzish brenda institucionit arsimor të punojnë së bashku për të arritur qëllime të caktuara.

Sikurse parashikuar në Udhëzuesin për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, plani i masave “hartohet kur vlerësohet i arsyeshëm nga oficeri i sigurisë, në rast se një situatë e caktuar, problematikë apo incident kërkon një sërë hapash dhe veprimesh të tjera për t’u ndërmarrë nga aktorë të ndryshëm brenda institucionit arsimor, dhe dërgohet për miratim tek titullari i institucionit arsimor.”<sup>80</sup>.

Grupi i Auditimit verifikoi dosjet e punës të oficerëve të sigurisë dhe komunikoi me ta, duke qartësuar panoramën e mëposhtme.

Në Shkollën e Bashkuar Zejmen, sipas intervistës<sup>81</sup> dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi, se: “Për 7 rastet e problematikave/incidenteve të cilat kanë qenë relativisht problematike, gjatë periudhë shtator 2021 - dhjetor 2024, nuk administrohet asnjë plan masash..”. Konstatohet pra, se planet e masave mungojnë krejtësisht dhe se ndarja e koordinuar e detyrave midis aktorëve të ndryshëm brenda institucionit arsimor për zgjidhjen e rasteve, nuk bëhet në mënyrë ligjore.

Në Shkollën e Mesme të Bashkuar Gosë, sipas intervistës<sup>82</sup> dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi, se: “Administrimi i rasteve problematike nuk shoqërohet me hartimin e planit të masave.”. Konstatohet pra, se planet e masave mungojnë krejtësisht.

Në Shkollën 9 vjeçare “Fan Noli”, sipas intervistës<sup>83</sup> dhe verifikimit të dosjes së punës së OS, specifikisht të vitit shkollor 2023 - 2024 rezultoi, se: “Në vitin 2023-2024 janë raportuar

<sup>77</sup> Intervista e datës 30.04.2025

<sup>78</sup> Intervista e datës 06.05.2025

<sup>79</sup> Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit

<sup>80</sup> Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit

<sup>81</sup> Intervista e datës 17.04.2025

<sup>82</sup> Intervista e datës 24.04.2025

<sup>83</sup> Intervista e datës 22.04.2025

6 raste incidentesh për të cilat është vënë në dijeni edhe policia. Planet e masave nuk janë të firmosura asnjëri dhe nuk dihet nëse personat e ngarkuar me përgjegjësinë për të ndjekur aspekte të caktuara të rasteve, të kenë informacion për atë që duhet të bëjnë.”.

Konstatohet pra, se edhe në këtë shkollë administrimi proaktiv i rasteve dhe zgjidhja e tyre, nuk bëhet duke përgatitur një plan masash.

Në Gjimnazin “Arben Broci”, në vijim të intervistës<sup>84</sup> së datës 06.05.2025 dhe verifikimit të dosjes së punës së OS rezultoi se: “Në dosjen e punës konstatohet, se në ndonjë rast nuk ka fare plan masash, si rastin e raportimit të incidentit të datës 28.09.2023, ku mungojnë planet e masave (e ndërhyrjeve në nivel klase dhe shkolle) dhe planet e sigurisë të cilat janë selektuar me tik nga OS, në raportin e incidentit. Në rastin e planit të masave të datës 26.11.2024 për trajtimin e referimit të incidentit për 4 nxënës të shkollës, në këtë plan masash, konstatohet se pavarësisht se i miratuar nga Drejtuesi i IA, nuk është firmosur nga aktorët e tjerë të përfshirë në trajtimin e rastit, si zbatues.”. Konstatohet se në këtë shkollë, në raste të caktuara, përgatitja e planit të masave mungon, ose është formal, meqë, aktorët e brendshëm të shkollës, të përmendur në plan, nuk dokumentohet të kenë dijeni se janë të përfshirë në trajtimin e rastit.

➤ ***Oficerët e Sigurisë nuk kanë logjistikë të nevojshme për punë dhe nuk janë të përfshirë në Komisionin e Disiplinës***

Një aspekt i cili u vlerësua me vëmendje nga GA, ishte edhe ai, se mbështetet dhe promovohet oficeri i sigurisë në përmbushjen e detyrimeve funksionale. Ndaj dhe u verifikuan kushtet në të cilat punojnë OS – të. Po ashtu, Drejtuesit e shkollave dhe oficerët u pyetën se: “Si e nxit dhe e mbështet shkolla dhe drejtuesit e saj, oficerin e sigurisë për të qenë edhe më efektiv në punën e tij? Si promovohet imazhi dhe vlera e punës që bën? A ka OS në dispozicion bazën materiale të nevojshme, për të kryer aktivitetin e tij?”.

Panorama e dalë nga verifikimet dhe intervistat, rezultoi si në vijim.

Në Shkollën e Bashkuar Zejmen, Drejtori u shpreh se, “ka një bashkëpunim shumë të mirë me oficerin e sigurisë, por shqetësim mbetet ndërprerja e energjisë elektrike. Oficeri i sigurisë mbështetet nga logjistika e zyrës së Drejtorit, meqë nuk ka kompjuter, printer dhe kartoleri.” Vetë OS u shpreh, se “Logjistika mungon (kompjuter, printer, skaner), energjia elektrike, mbulimi me internet është i dobët, leter A4. Premtimet e dhëna nga MAS kur jemi trajnuar nuk janë mbajtur, infrastruktura, legjislacioni i vonuar, etj. ”.

Në Shkollën e Mesme të Bashkuar Gosë, Drejtoresha dhe Oficerja e Sigurisë nënvizuan, se komunikohet për gjithçka mes Drejtoreshës dhe oficeres. Ato vunë në dukje, se mungojnë kompjuteri, printeri dhe kancelaria dhe materialet për dosje, bëhen me burime private. Po ashtu, në vlerësimin e tyre, të ardhurat e OS janë të ulëta.

Në Shkollën 9 vjeçare “Fan Noli”, Drejtoresha vuri në dukje se, mbështet çdo lloj nisme të Oficeres së Sigurisë. Ndërsa OS u shpreh, se ka nevojë për kompjuter, printer dhe kancelari.

Në Gjimnazin “Eqrem Çabej”, Drejtoresha u shpreh se, do e përfshinte Oficerin e Sigurisë në Komisionin e Disiplinës”, ndërkohë që, Oficeri i Sigurisë pohoi, se paga e tij nuk është e denjë për përgjegjësinë dhe kontributin që jep, ndërkohë që ka mungesa në kartoleri, printer, dhe se kompjuteri që ka nuk funksionon.

Në këtë takim u diskutua gjatë për problemin e përbërjes së Komisionit të Disiplinës dhe përjashtimit të OS nga kjo anëtarësi.

Në Gjimnazin “Arben Broci”, Oficerja e Sigurisë vlerësoi, se me Drejtoreshën e shkollës ndan marrëdhënie shumë të mira bashkëpunimi, porse kushtet e parashikuara në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit,

---

<sup>84</sup> Intervista e datës 06.05.2025

Sportit dhe Rinisë “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”, nuk janë përmbushur (ndr. i referohet nenit 7 “Mjete logjistike”). Ajo nënvizoi, se paga nuk është e denjë për përgjegjësinë dhe kontributin që jep dhe se ka mungesa në kartoleri, printer dhe se kompjuteri që përdor është i huazuar.

***Përfshirja e oficerëve të sigurisë në komisionet disiplinore*** u shtrua si nevojë e shprehur prej tyre, gjatë komunikimeve me OSH, sikurse dhe me drejtuesit e shkollave. Porse po t'i referohemi nenit 101, mbi Komisionin e Disiplinës në institucionet e arsimit parauniversitar, i Urdhrit Nr. 31, datë 28.1.2020, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vihet re, se “Komisioni i disiplinës ngrihet në çdo IA në çdo fillim të vitit shkollor dhe përbëhet nga 5-7 persona dhe se, anëtarë në përbërje të komisionit të disiplinës janë drejtori i IA-së, nëndrejtorët (nëse shkolla ka) dhe mësues të zgjedhur nga këshilli i mësuesve”. Po ashtu, “Komisioni i disiplinës në IA shqyrton rastet e konstatuara nga komisioni i etikës dhe sjelljes për shkeljet disiplinore të kryera nga ana e nxënësve, mësuesve dhe nëndrejtorëve”. Gjithnjë sipas përcaktimeve të këtij neni vërehet se “Në mbledhjen e komisionit të disiplinës, kur trajtohet shkelja e rregullave disiplinore nga ana e nxënësit, merr pjesë nxënësi për të cilin shqyrtohet shkelja, mësuesi kujdestar i tij, psikologu apo punonjësi social, si dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit.”<sup>85</sup>

Po të konsiderohet fakti se oficeri i sigurisë është figura e dedikuar, me një rol të posaçëm në garantimin e sigurisë në shkolla dhe se shkeljet disiplinore që janë objekt i vlerësimit të këtij komisioni, janë njëherësh shkelje të cilat cenojnë sigurinë, atëherë përfshirja e OS në këtë organizëm do ishte brenda logjikës së gjërave. Oficeri i sigurisë, njeh më mirë se kushdo tjetër, rrjedhën e ngjarjeve problematike, nxënësit problematikë dhe jo, historitë e tyre, komunikimet brenda dhe jashtë shkolle me aktorë të tjerë, ndaj edhe vlerësimi i këtyre të dhënave, me përfshirjen e OS në komisionin e disiplinës, do çonte në masa disiplinore objektive dhe të përpjesëtuara me shkeljet.

Në Gjimnazin “Eqrem Çabej”, gjatë takimit me grupin e auditimit, pasi u diskutua gjatë për problemin e përbërjes së Komisionit të Disiplinës dhe përjashtimit të OS nga kjo anëtarësi, Drejtoresha u shpreh se, do e përfshinte Oficerin e Sigurisë në Komisionin e Disiplinës”. Në këtë takim u diskutua.

➤ ***Shumë shkolla nuk janë të mbuluara nga shërbimi i oficerit të sigurisë, për shkak të vakancave***

Siguria në shkollë dhe lufta kundër dukurive të tilla, si përdorimi i drogave dhe i substancave abuzive, dhunës fizike, bullizmit, etj., mbeten një sfidë e hapur, për politikatat e Qeverisë dhe të gjithë aparatit të arsimit, duke përfshirë këtu Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, së bashku me institucionet e varësisë nga njëra anë, Ministrinë e Brendshme dhe institucioneve e saj të varësisë, nga ana tjetër. Fokusimi tek siguria në shkolla dhe roli i oficerit të sigurisë, është përkthyer në kohë me ndryshime të herëpashershme të VKM nr. 600, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë”, si më poshtë:

Me VKM nr. 553, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 600, datë 9.10.2018, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucione të arsimit parauniversitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë”, të ndryshuar, *numri i oficerëve të sigurisë u rrit nga 150, në 222.*

---

<sup>85</sup> Neni 101, paragrafi 8, i Urdhrit Nr. 31, datë 28.1.2020, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Institucionet arsimore të cilat do të kishin oficer sigurie pas këtij ndryshimi, u përcaktuan me *Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, nr.542, të datës 15.09.2022*, sipas sanksionimit: “Institucionet e arsimit parauniversitar, që kanë shërbim të sigurisë publike, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin”<sup>86</sup>.

Me miratimin e VKM nr. 433, datë 26.6.2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 600, datë 9.10.2018, numri i oficerëve të sigurisë u rrit nga 222, në 276. Në vijim Ministri i Arsimit dhe Sportit miratoi Urdhrin nr. 592, datë 06.12.2024, i cili në zbatimin të VKM nr. 600, përcaktoi institucionet arsimore ku do të vendoseshin oficerët e sigurisë.

Të pasqyruara në shifra, ndryshimet e numrit të oficerëve të sigurisë për efekt të miratimeve të dy VKM - ve të lartpërmendura, rezultojnë me shpërndarjen, sipas DRAP – eve

**Tabela 15:** Ndryshimi i numrit të oficerëve të sigurisë në vite, sipas ndryshimeve të VKM - së nr. 600, datë 9.10.2018, i ndryshuar

NR	DRAP	Numri i OS VKM nr. 600, datë 9.10.2018 Viti shkollor 2021-2022		Numri i OS VKM nr. 553, datë 29.07.2022 Viti shkollor 2022-2023		Numri i OS VKM nr. 553, datë 29.07.2022 Viti shkollor 2023-2024		Numri i OS VKM 433, datë 26.06.2024 Viti shkollor 2024-2025	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Durrës	61	54	113	103	113	100	138	104
2	Fier	23	21	37	33	37	33	44	33
3	Korçë	42	37	43	40	43	43	59	49
4	Lezhë	24	19	29	25	29	26	35	26
		<b>150</b>	<b>131</b>	<b>222</b>	<b>201</b>	<b>222</b>	<b>202</b>	<b>276</b>	<b>212</b>

Burimi: Të dhëna të vëna në dispozicion nga AKAP<sup>87</sup>.

Sikurse shihet nga tabela 15, numri i vendeve vakante ka pësuar rritje në vitin shkollor 2024-2025.

Nga ana e saj, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (ish DPAP) kryen procedurat e ofrimit të vendeve të lira në pozicionin e oficerit të sigurisë, sipas detyrimit të përcaktuar: “..për vendet e lira të oficerit të sigurisë, të paplotësuara DPAP-AKAP njofton për punësim kandidatët e certifikuar, por të papunësuar të të gjitha ZVAP-ve, (ish DAR/ZA), sipas listës së dërguar nga Ministria përgjegjëse për arsimin”<sup>88</sup>.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (ish DPAP) për periudhën shtator 2021-dhjetor 2024, ka kryer procedurat e si më poshtë:

**1.** Referuar informacionit të dërguar nga DRAP - et, për vendet e lira të mbetura, pas kryerjes së procedurave në zbatim të pikës 1 dhe 2 të shkresës Nr.1595.Prot., datë 17.03.2021- “Për procedurat e emërimit të oficerëve të sigurisë”, DPAP (AKAP) në datën **20.09.2021** ka njoftuar (me email nga adresa e DPAP - së), për çeljen e procedurës së punësimit, kandidatët e certifikuar por të papunësuar, të të gjitha ZVAP - ve (ish - DAR/ZA), sipas listës së dërguar nga MAS. Për 9 vende vakante, gjithsej ishin kandidatë potencialë 22 oficerë sigurie të papunësuar. Nga 22 oficerë sigurie të papunë, u paraqitën vetëm 3 oficerë sigurie. Nga 9 vende mbetën 6 vendet vakante.

<sup>86</sup> VKM nr. 553, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 600, datë 9.10.2018, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”

<sup>87</sup> Të dhëna të vëna në dispozicion nga AKAP, më datë 07.02.2025

<sup>88</sup> Pika 3, e shkresës së MASR (sot MAS) me nr. 1595 prot., e datës 17.03.2021- “Për procedurat e emërimit të oficerëve të sigurisë”

**2.** Referuar informacionit të dërguar nga DRAP - et Fier dhe Durrës, për vendet e lira të mbetura pas kryerjes së procedurave në zbatim të pikës 1 dhe 2 të shkresës Nr.1595 prot., datë 17.03.2021- “Për procedurat e emërimit të oficerëve të sigurisë”, DPAP (AKAP) në datën **13.01.2022** ka njoftuar (me e-mail nga adresa e DPAP) për mundësi punësimi kandidatët e certifikuar por të papunësuar të të gjitha ZVAP – ve (ish DAR/ZA), sipas listës së dërguar nga MAS. Për 6 vende vakante, gjithsej ishin kandidatë potencialë 16 oficerë sigurie të papunësuar.

*Nga 16 oficerë sigurie të papunësuar, nuk u paraqit asnjëri prej tyre, duke e bojkotuar procedurën e punësimit.* DPAP me shkresën nr.473/2 prot., datë 18.01.2022 ka njoftuar MAS për procedurat e ndjekura, vendet që mbeten të paplotësuara dhe listën e përditësuar të oficerëve të sigurisë.

**3.** Referuar informacionit të dërguar nga DRAP – et, DPAP në datën **24.02.2022**, ka njoftuar (me e-mail, nga adresa e DPAP) për punësim kandidatët e certifikuar por të papunësuar, të të gjitha ZVAP (ish DAR/ZA), sipas listës së dërguar nga MAS. Për 8 vende vakante, gjithsej ishin kandidatë potencialë 15 oficerë sigurie të papunësuar.

*Nga 15 oficerë sigurie të papunësuar, u paraqit vetëm 1 oficer sigurie.*

**4.** Lidhur me procedurën e kryer në **16.05.2022** konstatohet se për 12 vende vakante (8 pa afat dhe 4 me afat), gjithsej ishin kandidatë potencialë 14 oficerë sigurie të papunësuar.

*Nga 14 oficerë sigurie të papunësuar, nuk u paraqit asnjëri prej tyre, duke e bojkotuar procedurën e punësimit.*

Në zbatim të VKM nr. 553, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 600, datë 9.10.2018, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, të ndryshuar, numri i oficerëve të sigurisë u rrit nga 150, në 222. Në vijim Ministri i Arsimit dhe Sportit miratoi Urdhrin nr. 542, datë 15.09.2022, i cili përcaktoi institucionet arsimore ku do të vendoseshin oficerët e sigurisë.

Pas inventarit të bërë mbi vendet e lira të bartura dhe krijuara, rezultinin të ishin 86 vende vakante për oficerë.

**5.** Sikurse rezulton nga procedura e kryer më **22.11.2022**, për 5 vende vakante, gjithsej ishin kandidatë potencialë 19 oficerë sigurie të papunësuar, nga të cilët, nuk u paraqit asnjëri prej tyre, duke e bojkotuar procedurën e punësimit.

**6.** Sikurse rezulton nga procedura e kryer më **10.03.2023**, për 20 vende vakante, (19 vende vakante pa afat dhe 1 vend me afat, 1 leje lindjeje), gjithsej ishin kandidatë potencialë 63 oficerë sigurie të papunësuar, nga të cilët, u paraqitën vetëm 8 prej tyre, duke pranuar mundësinë e punësimit.

**7.** Sikurse rezulton nga procedura e kryer më **3.04.2023**, për 13 vende vakante, gjithsej ishin kandidatë potencialë 54 oficerë sigurie të papunësuar, nga të cilët u paraqit duke pranuar mundësinë e punësimit, vetëm 1 kandidat.

**8.** Sikurse rezulton nga procedura e kryer më **29.03.2024**, për 20 vende vakante, gjithsej ishin kandidatë potencialë 51 oficerë sigurie të papunësuar, nga të cilët, u paraqitën vetëm 5 prej tyre, duke pranuar mundësinë e punësimit.

**9.** Sikurse rezulton nga procedura e kryer më **14.09.2024**, për 28 vende vakante, gjithsej ishin kandidatë potencialë 45 oficerë sigurie të papunësuar, nga të cilët, u paraqitën vetëm 3 prej tyre, duke pranuar mundësinë e punësimit.

Sikurse rezulton nga procedura e kryer më **6.12.2024**, për 80 vende vakante, gjithsej ishin kandidatë potencialë 45 oficerë sigurie të papunësuar, nga të cilët, u paraqitën vetëm 12 prej tyre, duke pranuar mundësinë e punësimit.

*Në fund të 2024 numëroheshin 68 vende vakante.*

Grupi i Auditimit i ka drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit pyetjen: “Lidhur me mosplotësimin e vendeve vakante të oficerëve të sigurisë në shkolla, si një problematikë e konstatuar ndër vite, lutem të na bëni me dije, nëse MAS ka analizuar ndonjëherë shkaqet që e kanë krijuar këtë situatë dhe nëse është marrë ndonjë masë për t’u bërë punësimin si oficer sigurie, një perspektivë më me interes për kandidatët potencialë?”. GA iu drejtua ministrisë, meqë “Ministri është përgjegjës për realizimin e programit politik qeverisës në fushën e arsimit parauniversitar”<sup>89</sup> dhe meqë pikërisht urdhrat e tij nuk ishin pritur me interes, nga ana e oficerëve të sigurisë, të certifikuar por të papunë.

Nga ana e saj MAS është përgjigjur; “Në lidhje me problematikën më sipër AKAP ka konstatuar:

-Mungesë të kandidatëve të certifikuar dhe të papunësuar në ZVAP, ku është vendi vakant, p.sh. mund të përmendim ZVAP Dibër, Bulqizë, Dimal(Ura Vajguore), Tropojë, Pukë-Fushe Arrëz, Klos, Mat, Kavajë, etj.

-Mungesë interesi nga kandidatët për vendet provizore si leje lindje/ raporte.

-AKAP i’u ofron vendet e lira kandidatëve të certifikuar por të papunësuar të të gjitha ZVAP-ve (ish DAR/ZA), sipas listës dhe renditjes të dërguar nga MAS, pra i’u ofron vendet e lira kandidatëve që kanë aplikuar për ZVAP të ndryshme nga ajo ku është vendi vakant dhe në këto raste interesi është më i vogël.”<sup>90</sup>. Nga përgjigja është e qartë se MAS nuk ka bërë asnjë analizë për çështjen, e aq më pak të ketë planifikuar masa, për t’i dhënë përgjigje situatës.

**3. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit u konstatua, se në databazën e krijuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, mbi referimin e rasteve/incidenteve nga oficerët e sigurisë, seksioni “Shkolla” nuk është plotësuar si fushë identifikuese që prej vitit shkollor 2022–2023. Kjo ka ndodhur pasi, në link-un ku mblidhen të dhënat, ky element është hequr, si pasojë e shqetësimeve të ngritura nga oficerët e sigurisë, të cilët janë shprehur se kanë ndjerë presion nga drejtuesit e shkollave për të mos raportuar incidente, *pasi shkolla e tyre mund të cilësohet një shkollë jo e mirë*. Ky fakt tregon se procesi i raportimit vetëcensurohet nga oficerët e sigurisë dhe, si rrjedhojë, nuk pasqyron në mënyrë transparente dhe të besueshme situatën reale të problematikave që lidhen me sigurinë në shkolla.

**4. Gjetje nga auditimi:** Në Urdhrin<sup>91</sup> nr. 31, datë 28.1.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, është përcaktuar detyrimi që oficerët e sigurisë duhet të zhvillojnë kontrole fizike të nxënësve ose të mjediseve. Me përjashtim të dy rasteve, të regjistruara më datë 16.05.2023 dhe më datë 11.12.2024, në gjimnazin “Arben Broci”, në shkollat e tjera, nuk është ushtruar asnjë kontroll fizik ndaj nxënësve dhe asnjë kontroll i mjediseve të shkollave. Oficerët e sigurisë i shmangin kontrollin, për të shmangur konfliktin me prindërit, të cilët e konsiderojnë kontrollin si një akt që etiketon fëmijët. Mungesa e kontroleve shton rrezikun e qarkullimit dhe mbajtjes së mjeteve dhe lëndëve, që cenojnë sigurinë në shkolla.

**5. Gjetje nga auditimi:** Në “Udhëzuesin për praktikën e punës së Oficerëve të Sigurisë”<sup>92</sup>, pyetësorët/instrumentet matës përcaktohen si një hallkë tjetër e rëndësishme e realizimit të detyrës së oficerëve të sigurisë, të cilët mund të përdoren në fillim ose përgjatë vitit. Në

<sup>89</sup> Pika 1, e nenit 26, të Ligjit Nr. 69 /2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

<sup>90</sup> Përgjigje e ardhur me e-mail, më 7.05.2025 nga MAS

<sup>91</sup> Paragrafi 18, të nenit 33, “Detyrat dhe përgjegjësitë e oficerit të sigurisë”, të Urdhrit Nr. 31, datë 28.1.2020, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

<sup>92</sup> Miratuar me shkresën nr. 6155/3, datë 11.10.2023 nga Zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit

Shkollën e Bashkuar Zejmen dhe në Shkollën e Mesme të Bashkuar Gosë, rezultoi se nuk janë përdorur asnjëherë. Në Shkollën 9 vjeçare “Fan Noli”, nuk ka asnjë rezultat apo të dhënë mbi indikatorët e sigurisë në shkollë, të marrë prej tyre pas përgjigjeve të nxënësve. Në Gjimnazin “Eqrem Çabej” në vitet shkollore 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024 instrumentet matës nuk janë përdorur, ndërsa hera e vetme kur janë aplikuar (në dhjetor 2024) nuk ka prodhuar asnjë rezultat të dobishëm mbi gjendjen e sigurisë. Në Gjimnazin “Arben Broci”, megjithëse janë zhvilluar pyetësorë nga shërbimi psikosocial për tema si droga dhe bullizmi, nuk janë përdorur pyetësorë të dedikuar posaçërisht për sigurinë, duke e trajtuar këtë çështje vetëm në mënyrë tërthore. Mospërdorimi i instrumenteve matës, vështirëson procesin e identifikimit të problematikave dhe njohjen e nevojave të sigurisë në shkollë.

**6. Gjetje nga auditimi:** “Udhëzuesi për praktikën e punës së Oficerëve të Sigurisë”<sup>93</sup> përcakton që “raporti i incidenteve/problematikave i drejtohet organeve të Policisë së Shtetit (sipas vlerësimit të rastit)”, duke e lënë në gjykimin e oficerëve të sigurisë vendimin, nëse problematikën/incidentin t’ia raportojë policisë apo jo.

Porse nisur nga konstatimet, se oficerët e sigurisë:

vetë-censurohen, nga presioni i drejtuesve të shkollave, në ofrimin e të dhënave në raportimet e rasteve/incidenteve në ASCAP;

lënë me vetëdije të pazbatuara detyrime të parashikuara qartë në akte nënligjore, si ai i kontroleve fizike të nxënësve, për të shmangur konflikte me prindërit;

në raste të caktuara, e shohin me skepticizëm bashkëpunimin me policinë;

në raste të caktuara vuajnë nga një formim profesional i mangët.

Në mungesën e një kriteri të qartë, i cili duhet të përcaktojë se për cilat tipologji problematikash / incidentesh është i detyrueshëm raportimi në polici dhe nisur nga vlerësimi i integruar i fakteve të mësipërme, lehtësisht bihet dakord, se vendimi i oficerit për referimin ose jo të rastit, tek policia e shtetit, mbetet një zgjedhje subjektive e tij, duke bërë që bashkëpunimi me Policinë e Shtetit, të mbetet opsional, i pastandardizuar dhe joefektiv.

**7. Gjetje nga auditimi:** Në “Udhëzuesin për praktikën e punës së Oficerëve të Sigurisë”<sup>94</sup>, memoja është parashikuar si formë raportimi i brendshëm ndërmjet oficerit të sigurisë dhe titullarit të institucionit arsimor e cila shërben si një mjet për të regjistruar ngjarje, për të sinjalizuar situata të caktuara, për të tërhequr vëmendjen apo për të dhënë vërejtje lidhur me çështje specifike brenda institucionit. Nga auditimi i pesë shkollave u konstatua se gjatë periudhës shtator 2021 – dhjetor 2024, memoja si formë komunikimi është përdorur vetëm një herë, më 25.09.2024, në shkollën 9-vjeçare “Fan Noli”, për të kërkuar mbulimin me patrullim policie. Përveç këtij rasti, memoja nuk është përdorur më, çka evidenton mungesën e këtij instrumenti formal të komunikimit. Si rezultat, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet oficerit të sigurisë dhe drejtuesit të shkollës mbetet i pa dokumentuar, duke krijuar hapësirë për informalitet dhe paqartësi në ndarjen e përgjegjësisë.

**8. Gjetje nga auditimi:** Në “Udhëzuesin për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë”<sup>95</sup>, përcaktohet se “Plani vjetor është forma e cila do të përshkruajë objektivat e punës së oficerit të sigurisë dhe treguesit të përmbushjes së secilit objektiv”. Lidhur me procesin e planifikimit vjetor të veprimtarisë së oficerëve të sigurisë u konstatua sa më poshtë:

Në *Shkollën e Bashkuar Zejmen*, rezultoi se, për vitin 2021 - 2022 dhe për vitin 2022 – 2023 nuk ka asnjë planifikim vjetor të veprimtarive të oficerit të sigurisë. Për vitet 2023 – 2024 dhe 2024-2025, ka plane vjetore, ndërsa në dosjen e oficerit të sigurisë nuk ka asnjë dokument, që

<sup>93</sup> Miratuar me shkresën nr. 6155/3, datë 11.10.2023 nga Zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit

<sup>94</sup> Miratuar me shkresën nr. 6155/3, datë 11.10.2023 nga Zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit

<sup>95</sup> Miratuar me shkresën nr. 6155/3, datë 11.10.2023 nga Zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit

provon realizimin e aktiviteteve të parashikuara. Si i tillë procesi i planifikimit vjetor të veprimtarive të OS, në shumë raste mungon tërësisht, ndërsa në të tjera është formal, i pazbatuar dhe jo efektiv.

Në *Shkollën e Mesme të Bashkuar Gosë*, rezultoi se, nuk dokumentohen planet vjetore për veprimtarive për vitet shkollore, 2021 – 2022, 2022 – 2023, 2023 – 2024, ndërkohë që ka një plan për vitin shkollor 2024-2025. Nga verifikimi i realizimit të veprimtarisë së parashikuar në këtë plan, “Ndërgjegjësimi i nxënësve mbi fenomenin negativ të përdorimit, shitjes, prodhimit të substancave narkotike dhe masat që legjislacioni penal sanksionon” u vërejt, se në dosje e punës së OS, nuk dokumentohet zhvillimi i saj. Pra procesi i planifikimit vjetor të veprimtarive të oficerit të sigurisë, ose mungon fare, ose është formal, i pazbatuar dhe jo efektiv.

Në *Shkollën 9 vjeçare "Fan Noli"*, rezultoi, se janë përgatitur planet vjetore të veprimtarive të OS - së, për vitet në fokus auditimi.

Nga shqyrtimi i planifikimit vjetor 2023–2024, u verifikua realizimi i treguesit 3.1.3 “Takime me prindërit e nxënësve të identifikuar”, por u evidentua se takimet e planifikuara për periudhën shtator–qershor nuk rezultojnë të jenë realizuar, pasi mungojnë gjurmë dokumentare që të vërtetojnë zhvillimin e tyre.

Si i tillë, edhe në këtë shkollë, procesi i planifikimit vjetor të veprimtarive të OS, është formal dhe jo efektiv.

Në *Gjimnazin "Eqrem Çabej"*, planet vjetore të veprimtarive të OS janë të përgatitur. Nga planifikimi vjetor i veprimtarive të OS, për vitin 2024 - 2025, me zgjedhje u verifikua realizimi i veprimtarisë të programuar “Diskutim në lidhje me procedurën që do të ndjekim në raste problematikash që do të krijojnë nxënës të caktuar”. Ndarje dhe shkëmbim mendimesh me mësuesit e klasave kujdestare”, por, ashtu siç është konstatuar, nuk ka gjurmë dokumentare në dosje, që të vërtetojnë realizimin e tij. Si i tillë, edhe në këtë shkollë, procesi i planifikimit vjetor të veprimtarive të OS, është formal, dhe jo efektiv.

**9. Gjetje nga auditimi:** “Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë”<sup>96</sup>, përcakton detyrimin, që oficerët e sigurisë të përgatisin dhe përcjellin, raporte të incidenteve/problematikave, raporte javore dhe raporte vjetore.

Në *Shkollën e Bashkuar Zejmen* rezultoi se, gjatë vitit shkollor 2023-2024 mungonin raportet javore të periudhave nga 3.11.23 - 24.11.23 dhe 15.12.23 - 12.01.2024. Tek raporti javor i përgatitur më 06.10.23, tek “Pasqyra statistikore lloji i incidenteve”, referohet se ka 0 raste incidentesh/problematikash, ndërkohë tek “Përmbledhja javore”, referohet se ka raste të duhan pirjes.

Në *Shkollën e Mesme të Bashkuar Gosë* rezultoi se, raportet javore të oficerit të sigurisë nuk janë javore, por për periudha të ndryshme tre ose katër ditore. Në dosje u konstatuan raporte javore, për të njëjtën periudhë, me informacion që nuk përputhen mes tyre (raste dublim dokumentacioni) 20.11.2023 - 24.11.2023 dhe 21.10.2024 -25.10.2024. Mungonte numërtimi i rasteve, në pasqyrën statistikore. Raporti javor firmoset nga SPZ në të shumtat e rasteve, ndërkohë SPZ nuk firmoset raportet e incidenteve. Në raportin javor 9.9.2024-13.09.2024 nuk pasqyrohen raportimi i incidentit të datës 10.09.2024. pra ka mospërputhje dhe mungonte dhe proces verbali i incidentit.

Gjithashtu, në raportin vjetor 2023-2024, rubrika: “Raportimi i incidenteve gjatë vitit”, nuk përmban të dhëna për incidentet e regjistruara gjatë vitit shkollor dhe rubrika “Realizimi i planit vjetor”, ” rezulton pa informacion.

Në *Shkollën 9 vjeçare "Fan Noli"* rezultoi, se në raportet javore mungojnë shpesh firmat e OS. Gjithashtu, ka raste kur “Pasqyrat statistikore javore” nuk përputhen me “Përmbledhjen javore”, siç ndodh në dokumentin e datës 15.11.2025. Ndërkohë, raporti vjetor për vitin shkollor 2023–2024 përbëhet vetëm nga një faqe (në formë fotokopjeje), pa asnjë rubrikë të

<sup>96</sup> Miratuar me shkresën nr. 6155/3, datë 11.10.2023 nga Zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit

strukturuar. Pra sikurse konstatohet, procesi i raportimeve të OS – së jo rrallë herë është i munguar, formal, i pasaktë dhe i paplotë.

**10. Gjetje nga auditimi:** “Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë”<sup>97</sup>, përcakton detyrimin për oficerët e sigurisë “të përgatisin plane masash kur një situatë e caktuar, problematikë apo incident kërkon një sërë hapash dhe veprimesh të tjera për t’u ndërmarrë nga aktorë të ndryshëm brenda institucionit arsimor”.

- Në Shkollën e Bashkuar Zejmen rezultoi se, për shtatë rastet e problematikave/incidenteve të cilat kanë qenë relativisht problematike, gjatë periudhë shtator 2021 - dhjetor 2024, nuk administrohet asnjë plan masash.

- Në Shkollën e Mesme të Bashkuar Gosë rezultoi se, administrimi i rasteve problematike nuk shoqërohet me hartimin e planit të masave.

- Në Shkollën 9 vjeçare “Fan Noli”, se në vitin 2023-2024 janë raportuar 6 raste incidentesh për të cilat është vënë në dijeni edhe policia. Planet e masave nuk janë të firmosura dhe nuk dihet nëse personat e ngarkuar me përgjegjësinë, të kenë informacion për atë që duhej të bënin.

- Në Gjimnazin “Arben Broci” rezultoi se, në dosjen e punës, në rastin e raportimit të incidentit të datës 28.09.2023, mungojnë planet e masave (e ndërhyrjeve në nivel klase dhe shkolle) dhe planet e sigurisë, të cilat janë të shënuar nga OS me një shenjë dalluese, në raportin e incidentit. Në rastin e planit të masave të datës 26.11.2024 u konstatua se, plani i masave nuk është firmosur nga aktorët e tjerë të përfshirë në trajtimin e rastit, si zbatues.

Ashtu siç rezulton nga konstatimet, përgatitja e planit të masave ose mungon, ose është hartuar në mënyrë formale, pasi aktorët e brendshëm të shkollës, të cilët përmenden si të përfshirë në trajtimin e rastit, nuk dokumentohet të jenë në dijeni të rolit të tyre.

**11. Gjetje nga auditimi:** Neni 7 i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”<sup>98</sup>, parashikon detyrimin që oficerëve të sigurisë duhet t’u sigurohet logjistika e nevojshme (kompjuter, linjë telefoni për internet, kancelari).

- Në Shkollën e Bashkuar Zejmen, u konstatua se mungojnë kompjuter dhe printer, mbulimi me internet është i dobët, si dhe ka mungesa në kancelari.

- Në Shkollën e Mesme të Bashkuar Gosë, mungojnë pajisje bazë si kompjuteri, printeri dhe kancelaria. Materialet për dosje, bëhen me burime private

- Në Shkollën 9 vjeçare “Fan Noli” mungojnë pajisje bazë si: kompjuter, printer dhe kancelari.

- Në Gjimnazin “Eqrem Çabej”, ka mungesa në pajisje bazë si: kartoleri, printer dhe kompjuter.

- Në Gjimnazin “Arben Broci”, mungojnë pajisje bazë si: kompjuter, printer dhe kancelari.

**12. Gjetje nga auditimi:** Neni 101, mbi Komisionin e Disiplinës në institucionet e arsimit parauniversitar, i Urdhrit nr. 31, datë 28.1.2020, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk parashikon përfshirjen e oficerëve të sigurisë në përbërjen e këtij komisioni. Ky përcaktim anashkalon figurën e oficerit të sigurisë, i cili më drejtpërdrejtë se çdokush tjetër në shkollë, administron rastet/incidentet, njeh historitë dhe dinamikat e ngjarjeve dhe subjekteve, si dhe mund të bëjë edhe vlerësimin më objektiv lidhur me masën disiplinore që miratohet për rastet objekt vlerësimi i komisionit.

<sup>97</sup> Miratuar me shkresën nr. 6155/3, datë 11.10.2023 nga Zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit

<sup>98</sup> Miratuar më nr. 6068 prot., në datë 01.06.2018.

**13. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit u konstatua se në nëntë procedurat për punësimin e oficerëve të sigurisë, të realizuar gjatë periudhës objekt auditimi, ka munguar interesi për pjesëmarrje në këto procese përzgjedhjeje, nga të certifikuarit si oficer sigurie. Kjo qasje konstante ndër vite, ka krijuar vakanca të shumta dhe problematika e krijuar nuk është bërë kurrë objekt analize i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe institucioneve të varësisë.

**3. Konkluzion:** Mosplotësimi i fushave të data-bazës, të krijuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, të referimit të rasteve/incidenteve nga oficerët e sigurisë të cilët e aksesojnë nëpërmjet link-ut, me të dhënat përkatëse, cenon plotësinë dhe transparencën mbi të cilat gjenerohen statistikatat.

**4. Konkluzion:** Moszhvillimi i kontrolleve fizike të nxënësve dhe mjedisore të hapësirave të shkollës, nga ana e oficerëve të sigurisë, ka krijuar terren për tolerimin e mbajtjes së sendeve/lëndëve/armëve të cilat çenojnë shëndetin, sigurinë dhe jetën e komunitetit shkollor.

**5. Konkluzion:** Mungesa e përdorimit të pyetësorëve/instrumenteve matës, apo mospërpunimi i të dhënave, në rastet e rralla të përdorimit, i privon oficerët e sigurisë nga një burim informacioni i cili shërben për të diagnostikuar situatën në të gjithë shkollën, në klasa të caktuara, sikurse dhe ndikon, për të ndihmuar në ndërgjegjësimin e nxënësve, mësuesve dhe prindërve, duke u nisur nga gjendja reale e shkollës. Për pasojë procesi i planifikimit vjetor të veprimtarive dhe aktiviteteve të oficerit të sigurisë, në mungesë të këtij informacioni, rezulton joefektiv dhe i keqorientuar.

**6. Konkluzion:** Lënia në diskrecionin e oficerëve të sigurisë, e vlerësimit sipas rastit, se kur duhet ose jo, të referohen problematikat/incidentet, çënon standardizimin sipas kategorive, të tipologjive të ngjarjeve për të cilat raportimi në polici është i detyrueshëm, duke pamundësuar një bashkëpunimin të standardizuar dhe të rregullt me Policinë e Shtetit, aq i nevojshëm për zgjidhjen e rasteve, gjë e cila ul mundësitë për efektivitet në garantimin e sigurisë në shkolla. Pa standard të qartë nuk ka bashkëpunim të standardizuar me Policinë e Shtetit.

**7. Konkluzion:** Mosformalizimi i sinjalizimeve, propozimeve, i tërheqjeve së vëmendjes për çështje të caktuara, nëpërmjet dokumentit “memo” krijon premisa që shqetësimet e oficerit të sigurisë të mos përcillen tek drejtuesi i shkollës, apo të mos e ngarkojnë këtë të fundit me përgjegjësitë që i takojnë, duke kompromentuar trajtimin e çështjeve, që lidhen me sigurinë në institucionet e arsimit parauniversitar.

**8. Konkluzion:** Planifikimi vjetor i veprimtarisë së oficerëve të sigurisë, i munguar ose formal, pamundëson zhvillimin e aktiviteteve, të cilat synojnë arritjen e objektivave që garantojnë sigurinë në shkolla.

**9. Konkluzion:** Raportimet e munguara, formale, të pasakta, e të paplota nga ana e oficerit të sigurisë, krijojnë kushte për mosndarje të informacionit me aktorë të tjerë, për monitorim të munguar të punës së tij, për mosbashkëpunim me institucionet që kanë rol thelbësor në trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave, si dhe për një proces mbledhjeje dhe përpunimi të dhënash të paplota, me indikatorë të pasaktë mbi sigurinë në shkolla.

**10. Konkluzion:** Trajtimi i problematikave/incidenteve pa një plan masash, kur duhet të ndahen qartë detyra e përgjegjësi ndërmjet aktorëve ndryshëm, e vështirëson koordinimin e veprimtarive dhe arritjen e objektivit të zgjidhjes së rasteve.

**11. Konkluzion:** Mungesa e logjistikës e ballafaqon oficerin e sigurisë me pamundësinë materiale, për të ushtruar me efektivitet detyrimet funksionale.

**12. Konkluzion:** Mospërfshirja e Oficerit të Sigurisë në Komisionin e Disiplinës, mundet të çojë në marrjen e masave disiplinore nga anëtarë të Komisionit të cilët nuk kanë njohje të hollësishme mbi dinamikën e rasteve/incidenteve, duke dhënë një gjykim jo objektiv. Ndërkohë ky përjashtim krijon kushte që Oficeri i Sigurisë të anashkalohej, defaktorizohet dhe demotivohet, meqë nga njëra anë administron rastet dhe nga ana tjetër përjashtohet nga vlerësimi i tyre dhe i masave disiplinore ndaj personave që kanë shkaktuar.

**Konkluzion:** Mungesa e interesit nga ana e të certifikuarve si oficerë sigurie, për t'iu përgjigjur pozitivisht ofertave për punë, ka penguar mbulimin e shumë institucioneve arsimore me shërbimin e oficerit të sigurisë.

**3.1 Rekomandimi:** Drejtuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar të mundësojnë, që oficerët e sigurisë të raportojnë rastet/incidentet në link-un e vënë në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar të pandikuar, duke referuar çdo të dhënë dhe duke plotësuar çdo fushë të parashikuar në databazë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4.1 Rekomandimi:** Drejtuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar të garantojnë një angazhim efektiv të oficerëve të sigurisë, të cilët me nismën e tyre në raste emergjente, apo në rrethana të tjera, me lejen e drejtuesve të shkollave, duhet të zhvillojnë kontrolle fizike të nxënësve dhe të mjediseve, pa asnjë hezitim.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5.1 Rekomandimi:** Drejtuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar të kërkojnë nga oficerët e sigurisë që të përdorin sistematikisht pyetësorët/instrumentet matës për të njohur gjendjen reale të sigurisë në shkolla. dhe informacionin e marrë prej tyre, t'a përdorin për të orientuar masat e nevojshme, për identifikimin e problematikave, ndërgjegjësimin e nxënësve, mësuesve, prindërve dhe ndërshkrimin e shkaktarëve të rasteve/incidenteve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**6.1 Rekomandimi:** Ministri i Arsimit të miratojë ndryshimin e “Udhëzuesit për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë” duke përcaktuar qartë tipologjitë e problematikave/incidenteve për të cilat oficerët e sigurisë e kanë detyrim referimin e rastit në Policinë e Shtetit.

**Brenda vitit 2026**

**7.1 Rekomandimi:** Drejtuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar të kërkojnë nga oficerët e sigurisë, që komunikimet dhe bashkëpunimin me drejtuesit e shkollave t'i dokumentojnë edhe nëpërmjet memove, me qëllim garantimin e një komunikimi transparent dhe të aftë për të ndarë përgjegjësitë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8.1 Rekomandimi:** Drejtuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar të sigurojnë kushtet që oficerët e sigurisë, të jenë të angazhuar në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme në procesin e planifikimit vjetor të veprimtarive, pasi të kenë vlerësuar nevojat e shkollës, që lidhen me sigurinë dhe objektivat e programuara, t'i realizojnë me përpikmëri, duke dokumentuar zhvillimin e aktiviteteve.

**Në vijimësi**

**9.1 Rekomandimi:** Drejtuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar të kërkojnë nga oficerët e sigurisë, që të zbatojnë me saktësi kriteret që udhëheqin procesin e raportimeve të incidenteve/problematikave, raportet javore dhe ato vjetore, duke pasqyruar e raportuar me vërtetësi ngjarjet dhe gjendjen reale të sigurisë në shkolla.

**Në vijimësi**

**10.1 Rekomandimi:** Drejtuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar të kërkojnë nga oficerët e sigurisë që të përgatisin me rigorozitet plane masash, në të gjitha rastet problematike, kur është e nevojshme ndërmarrja e një sërë hapash dhe veprimesh nga aktorë të ndryshëm brenda institucionit shkollor, me qëllim trajtimin dhe zgjidhjen efektive të konflikteve.

**Në vijimësi**

**11.1 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, të aktivizojë një inventarizim të nevojave logjistike për oficerët e sigurisë dhe të parashikojë buxhet për mbulimin e këtyre nevojave.

**Brenda datës 31.03.2026**

**12.1 Rekomandimi:** Ministri i Arsimit të vlerësojë mundësinë e ndryshimit të Urdhrit<sup>99</sup> nr. 31, datë 28.1.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, përkatësisht të nenit 101, duke parashikuar përfshirjen e Oficerit të Sigurisë në Komisionet e Disiplinës së institucioneve arsimore.

**Brenda datës 31.03.2026**

**13.1 Rekomandimi:** Ministri i Arsimit të ngrejë një grup pune i cili të analizojë shkaqet që kushtëzojnë mosmbulimin e vendeve vakante të oficerit të sigurisë në shumë shkolla dhe të marrë masat që rrisin interesin për këtë punësim, duke siguruar mbulimin me këtë shërbim në shkolla.

**Brenda vitit 2026**

**Me shkresën nr. 2256/4 prot., datë 24.07. 2025** (shkresa nr. 126/9 prot., datë 25.07.2025, sipas protokollit të KLSH) **Ministria e Arsimit dhe Sportit, ka përcjellë këto observacione:**

➤ **Lidhur me Rekomandimin 3.1 të Projektraportit:**

“Të dhënat që grumbullohen nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar vijnë si rezultat i punës së përditshme të oficerëve të sigurisë në shkolla ndërmjet një instrumenti të standardizuar. Këto të dhëna paraqesin situatën reale në terren të konstatuar nga oficerët e sigurisë, të dhëna këto që korrespondojnë me raportimin e tyre sipas formateve të miratuara për raportimin e problematikave dhe incidenteve në shkollë. Të dhënat e grumbulluara nuk janë të dhëna subjektive, perceptime apo opinione, por janë të dhëna sasiore të cilat janë të mbështetura në dokumentacion dhe paraqesin një pamje të punës së përditshme të oficerëve të sigurisë.

Të dhënat e krahasuara midis atyre të mbledhura në një vit shkollor nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe atyre të Grupit të Auditimit ju bëjmë me dije si më poshtë:

1. Nuk është përdorur i njëjti instrument matës dhe si rrjedhojë këto të dhëna janë të

<sup>99</sup> Urdhri Nr. 31, datë 28.1.2020, i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

pakrahasueshme.

2. Procedura dhe metodologjia e përdorur është e ndryshme, ASCAP mbledh të dhëna faktike ndërsa instrumenti i GA ka mbledhur opinione perceptime subjektive.
3. Kampioni i përzgjedhur nuk është i njëjti dhe si rrjedhim këto të dhëna nuk mund të krahasohen”.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Lidhur me observacionin e ardhur nga MAS, vihet në dukje se është e vërtetë se procedura dhe metodologjia e përdorur vjeljen e të dhënave të krahasuara janë të ndryshme, por gjithësesi të dhënat e konstatuar nga GA, janë përfutur nga përdorimi i pyetësorit që gjendet në dokumentin “Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit”, pra miratuar nga MAS.

Duke marrë në konsideratë observacionin e MAS mbi gjetjen 3.1 të Projektraportit, grupi i auditimit ka reflektuar mbi materialin e Raportit heqjen e tij, por duke e zëvendësuar me gjetjen që fokuson mosplotësimin e fushës “Shkolla”, në data bazën e vënë në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, nëpërmjet link-ut të referimit të rasteve/incidenteve nga oficerët e sigurisë.

#### **➤ Lidhur me Rekomandimin 4.1 të Projektraportit:**

“Mbështetur më pikën nr. 14, të nenit 6 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike” ku thuhet:

*“Ai nuk do të zhvillojë kontrolle fizike apo të mjediseve, përveç rasteve të emergjencave dhe vendimit nga administrata e shkollës.”*

Mbështetur gjithashtu në Praktikën e Punës së Oficerëve të Sigurisë ku thuhet:

*“OS nuk do të zhvillojë kontrolle fizike apo të mjediseve përveç rasteve të emergjencave dhe vendimit nga administrata e shkollës.”*

Nga sa më sipër ana jonë konstatohet që nuk ka boshllëk ligjor apo pengesa për realizimin e kontrolleve fizike nga ana e oficerëve të sigurisë, si në kuadër të parandalimit, konstatimit apo edhe të raportimit të problematikave apo incidenteve të ndryshme”.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Konstatohet se MAS është në të njëjtën linjë me rekomanduar nga grupi i auditimit, i cili bën diferencimin e rastit midis kontrolleve në kushte emergjence, të cilat duhet të kryhen nga oficerët e sigurisë me nismën e tyre dhe kontrolleve në kushte të tjera, për të cilat është i nevojshëm autorizimi nga drejtuesi i shkollës. Grupi e konsideron të plotë kuadrin rregullator lidhur me administrimin e të tilla ndërhyrjeve, duke mos shquar asnjë boshllëk ligjor.

Sa referuar nga MAS nuk kundërshton asnjë aspekt të rekomandimit të lënë, ndaj jemi në kushtet e një parashtrimi, i cili nuk konsiderohet observacion.

#### **➤ Lidhur me Rekomandimin 5.1 të Projektraportit:**

“Në dokumentin “Praktika e Punës së Oficerëve të Sigurisë” janë dhënë modele të instrumenteve që mund të përdoren nga oficerët e sigurisë. Oficerët e sigurisë mund të përdorin dhe instrumente të tjera matëse gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, përveç atyre që janë këtij dokumenti, sipas nevojës dhe karakteristikave të shkollës. Oficerët e sigurisë mund të përdorin dhe bashkëpunojnë me shërbimin psiko-social për realizimin e matjeve të caktuara për qëllime profesionale.

Mbledhja e të dhënave do të bëhet vetëm për përpunime statistikore dhe që janë në përputhje me misionin e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Të dhënat e përfutur do trajtohen në respektim të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Informacionet e

mblledhur nga këta pyetësorë do të përdoren vetëm për qëllime statistikore, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për statistikat zyrtare dhe do të kryhet në mënyrë anonime. Përpunimi i të dhënave të deklaruara, në kundërshtim me qëllimin e sipërcituar përbën kundërvajtje administrative sipas nenit 39 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Nga sa më sipër konstatohet se oficerëve të sigurisë i është vendosur në dispozicion gjithë hapësira e nevojshme ligjore për të përdorur instrumente të ndryshme, gjithashtu i është kushtuar rëndësi lirisë dhe pavarësisë profesionale profesionale”.

### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Së pari, Grupi i Auditimit ka vënë në dukje, se oficerët e sigurisë nuk përdorin pyetësorët/instrumentet matës për të njohur gjendjen reale të sigurisë në shkolla, pasi ato vlejné “për të evidentuar konkretisht rreziqet me të cilat mund të përballen nxënësit, shpeshësinë e tyre, ambientet në të cilat ndodhin. Ky pyetësor shërben për të diagnostikuar situatën në të gjithë shkollën, në klasa të caktuara, gjithashtu ndikon për të ndihmuar në ndërgjegjësimin e nxënësve duke u nisur nga gjendja reale e shkollës. Rezultatet e pyetësorit mund t’i vihen në dispozicion edhe prindërve, oficerit të policimit në komunitet, kur problematikat ndodhin jashtë shkollës, për të hartuar plane masash sigurie... Pas mbledhjes së rezultateve, oficeri i sigurisë duhet të zhvillojë takime me mësues kujdestarë të klasave ku janë evidentuar problematikat dhe të informohet konkretisht rreth nxënësve dhe të hartojë plan masash për të zgjidhur problematikat apo ndihmuar më tej në minimizimin e tyre.”<sup>100</sup>.

Së dyti, nënvizimi nga MAS se, “...oficerëve të sigurisë i është vendosur në dispozicion gjithë hapësira e nevojshme ligjore për të përdorur instrumente të ndryshme, gjithashtu i është kushtuar rëndësi lirisë dhe pavarësisë profesionale profesionale...”, nuk e prek aspak thelbin e gjetjes (i pa kundërshtuar shkollat e audituar në fazë terreni) dhe rekomandimit dhe pikërisht se kuadri rregullator e i ka krijuar këto mundësi, rekomandimi i lënë u drejtohet oficerëve të sigurisë.

Sa referuar nga MAS nuk kundërshton asnjë aspekt të rekomandimit të lënë, ndaj jemi në kushtet e një parashtrimi, i cili nuk konsiderohet observacion.

#### **➤ Lidhur me Rekomandimin 6.1 të Projektraportit:**

“Referuar pikës nr. 1 dhe 2 e nenit nr. 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 578, date 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes” thuhet:

*“1. Pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, çdo person fizik ose juridik, si dhe çdo punonjës i institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën për shkak të profesionit, duhet të bëjë raportimin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës ose pranë organeve të Policisë së Shtetit.*

*2. Çdo mësues, ofruer i shërbimit psiko-social shkollor, punonjës i institucioneve shëndetësore apo i përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, duhet të bëjë raportimin pranë njësisë arsimore vendore, drejtorit të institucionit, organeve të Policisë së Shtetit, strukturave për mbrojtjen e fëmijës.”*

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar, oficeri i sigurisë i raporton titullarit të institucionit arsimor, personit të ngarkuar si anëtar i Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit në çdo ZVAP apo personit të ngarkuar nga ZVAP-ja për mbikëqyrjen e praktikës së punës së oficerëve të sigurisë në shkolla, organeve të Policisë së Shtetit (sipas vlerësimit të rastit), dhe strukturave për mbrojtjen e fëmijës (për rastet kur vlerësohet fëmijës i duhet dhënë mbrojtja).

<sup>100</sup> Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë, miratuar me shkresën nr.6155/3 datë 11.10.2023 të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit

Mbështetur në bazën ligjore të sipërcituar përcaktohet qartë që veprimtaria e oficerëve të sigurisë në strukturat e Policisë së Shtetit nuk është tërësisht e lirë, por është e mbështetur në formular të standardizuar që vlerësojnë rrezikun dhe nivelin e tij.

Nga ana tjetër, pavarësia e oficerit të sigurisë për të referuar rastet në Policinë e Shtetit është një mekanizëm që forcon sigurinë reale në shkolla, garanton trajtim të drejtë ligjor të incidenteve, ul rreziqet e keqpërdorimeve administrative dhe kontribuon në një ambient shkollor më të sigurt dhe më të përgjegjshëm.”.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Grupi i Auditimit ka vënë në dukje, se Udhëzuesi për praktikën e punës së Oficerëve të Sigurisë i cili përcakton, që “raporti i incidenteve/problematikave i drejtohet organeve të Policisë së Shtetit (sipas vlerësimit të rastit)”, e ka lënë në diskrecion të oficerëve të sigurisë vendimin, nëse problematikën/incidentin t’ia raportojë policisë apo jo. Pikërisht kufizimin e këtij diskrecionaliteti ka parasysh rekomandimi i lënë nga GA, për arsyet e shtjelluara më lart. Sa referuar nga MAS nuk kundërshton asnjë aspekt të rekomandimit të lënë, ndaj jemi në kushtet e një parashtrimi, i cili nuk konsiderohet observacion.

#### **➤ Lidhur me Rekomandimin 9.1 të Projektraportit:**

“Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 742, datë 3.12.2021 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP)”, i ndryshuar, pika 8 citohet se:

“i) Shërbimi psiko-social dhe oficeri i sigurisë:

i. shohin nxënësit e shkollës/ave ku punojnë;

ii. njoftojnë individualisht ose në grup për të gjithë nxënësit e klasës nëpërmjet SMIP-së, personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore me anë të “Fletores së komunikimit digjital” për t’i informuar ata në kohë reale për nxënësit, sipas detyrave dhe fushës së përgjegjësisë që mbulojnë””.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Së pari, Grupi i Auditimit, ka nënvizuar se dokumenti “Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë”, përcakton detyrimin që oficerët e sigurisë të përgatisin dhe përcjellin, raporte të incidenteve/problematikave, raporte javore dhe raporte vjetore, me të dhëna përmbajtësore dhe forme, të mirëpërcaktuara. Sa konstatuar nga GA, dëshmon se oficerët e sigurisë nuk zbatojnë kriteret, gjatë proceseve të raportimit.

Së dyti nuk ka asnjë objeksion të drejtpërdrejtë nga shkollat e audituara në fazë terreni, mbi rastet e konstatuara nga grupi i auditimit, ndaj nuk jemi në kushte e një objeksioni konkret mbi vërtetësinë e evidencës audituese.

#### **➤ Lidhur me Rekomandimin 13.1 të Projektraportit:**

“Sipas ndryshimeve të fundit të kuadrit ligjor, me vendim nr. 227, datë 17.04.2025 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 600, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, të ndryshuar” do të rritet numri i oficerëve të sigurisë në shkolla sipas kriterëve të reja të caktimit si më poshtë:

Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar, si më poshtë vijon:

a) institucionet e arsimit të mesëm të lartë gjimnaz, arsimit të mesëm profesional dhe arsimit të mesëm të orientuar, që kanë mbi 80 (tetëdhjetë) nxënës, të kenë 1 (një) oficer sigurie;

b) institucionet e arsimit bazë ose shkollat e bashkuara, që kanë mbi 350 (treqind e pesëdhjetë) nxënës, të kenë 1 (një) oficer sigurie;

c) institucionet e arsimit të mesëm të lartë gjimnaz, institucionet e arsimit të mesëm të orientuar, institucionet e arsimit bazë ose shkollat e bashkuara, që kanë mbi 900 (nëntëqind) nxënës, të kenë 2 (dy) oficerë sigurie;

ç) institucionet e arsimit të mesëm profesional, që kanë mbi 700 (shtatëqind) nxënës, të kenë 2 (dy) oficerë sigurie.

Institucionet e arsimit parauniversitar, që përfitojnë shërbim të sigurisë publike, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, përveç institucioneve të arsimit të mesëm profesional, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional. Shërbimi i sigurisë publike konsiston në monitorimin nga oficeri i sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar, të përcaktuara në këtë vendim, nëpërmjet ndërveprimit të vazhdueshëm të nxënësve, personelit mësimor dhe komunitetit.”.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Sa referuar nga MAS, nuk kundërshton asnjë aspekt të rekomandimit të lënë, ndaj jemi në kushtet e një parashtrimi, i cili nuk konsiderohet observacion.

### **4.3 A ka pasur koordinim, bashkëpunim dhe raportim efektiv midis institucioneve përgjegjëse, lidhur me aktivitetin e oficerëve të sigurisë?**

Rritja e sigurisë si brenda ashtu edhe jashtë perimetrit të institucioneve arsimore nëpërmjet pranisë së policisë është një ndër elementet e shumtë të sigurisë në shkolla. Menaxhimi i sigurisë në shkolla kërkon një ndërveprim dhe koordinim të vazhdueshëm të të gjithë aktorëve të përfshirë në proces. Një ndër objektivat e vendosura në SKAP 2021-2026 ka qenë forcimi i rolit dhe shtimi i numrit të oficerëve të sigurisë në shkolla, dhe në kushtet aktuale ky duhet të jetë ndër prioritetet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Brendshme.

Duke synuar rritjen e sigurisë nëpërmjet ndërveprimit dhe parandalimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me anë të marrëveshjes së firmosur midis palëve, nr. 6068 prot., datë 01.06.2018, “Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”, krijuan një qasje të re për sigurinë në shkolla.

Me anën e VKM-së nr. 600, datë 9.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, i ndryshuar, u standardizua pozicioni i oficerit të sigurisë në shkolla, numri dhe shpërndarja e tyre në institucionet e arsimit parauniversitar. Grupi i parë i oficerëve të sigurisë të vendosur në shkolla i përket muajit mars të vitit 2019.

#### **➤ Zyra e Koordinimit dhe Monitorimit (ZKM) në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit**

Bazuar në Urdhrin nr. 531, datë 04.09.2018 “Për ngritjen e zyrës së koordinimit dhe monitorimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme për oficerët e sigurisë në shkollat publike”, i ndryshuar, pranë MAS u ngrit Zyra e Koordinimit dhe Monitorimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me MB, e cila gjatë periudhës së auditimit, 2021-2024 ka pasur për detyrë: hartimin e kriterëve të punësimit, të procedurave të aplikimit, koordinimin me AKAP, Akademinë e Sigurisë, organizatat partnere për planifikimin e trajnimeve për OS, si dhe raportimin te ministri përgjegjës për arsimin për ecurinë e zbatimit të marrëveshjes., fillimisht çdo muaj dhe më pas dy herë në vit.

Nga auditimi në terren, disa DRAP-e dhe ZVAP-e nuk kanë as koordinatore për OS e jo më një strukturë, të ngritur dhe të dedikuar si “zyrë koordinimi”. Kjo strukturë e ashtuquajtur “Zyrë koordinimi”, përfaqësohet nga një individ “oficeri i sigurisë”, ku në disa ZVAP-e mungon dhe ky i fundit. Në disa zyra arsimore ende procesi i koordinimit të punës së oficerëve të sigurisë nuk është në nivelet e pritura. Në disa zyra mungon personi përgjegjës i

cili të koordinoj punën e oficerëve të sigurisë apo të mbledhë informacionet që vijnë nga terreni<sup>101</sup>.

Nga takimet me përfaqësuesit e DRAP-ve dhe ZVAP-ve, si dhe oficerët e sigurisë në shkolla, u konstatua se disa prej tyre nuk kishin informacion për ekzistencën e Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit të marrëveshjes pranë MAS.

Pavarësisht se kjo strukturë është ngritur me urdhër ministri dhe jo me VKM, me këtë emërtim si strukturë e MAS dhe e institucioneve të varësisë, nuk përfshihet as në rregulloren e ministrisë, ku përcaktohen detyrat funksionale bazuar në përshkrimet e punës së anëtarëve të saj. Termi “Zyrë koordinimi dhe monitorimi” është përdorur dhe për strukturat në DRAP dhe ZVAP.

Nga auditimi në terren vihet re se disa DRAP-e, ZVAP-e nuk kanë komunikim të vazhdueshëm për OS. Një hallkë e dobët në këtë komunikim është dhe AKAP-i, pasi disa drejtori shkollash kanë dërguar njoftime për punësim për OS dhe nuk marrin përgjigje nga AKAP brenda afateve kohore të lejuara.<sup>102</sup> Në raportet e dërguara nga AKAP-i, vetëm në dhjetor të vitit 2024 ka kryer inspektim në disa shkolla, për oficerët e sigurisë.

Emërtim i kësaj strukture si “zyrë koordinimi dhe monitorimi” me urdhër ministri, referuar akteve në fuqi, nuk gjen mbështetje ligjore dhe për pasojë nuk është përcaktuar drejtë, pasi, sipas marrëveshjes:

- ✓ Në pikën 6 të nenit 4 të saj “Detyrimet e MB”, përcaktohet se: “Akademia e Sigurisë, në përfundim të trajtimit, do të realizojë testimin dhe pajisjen me certifikata vlerësimi të oficerëve të sigurisë, në bashkëpunim me ZKM në MAS”. Referuar nenit 5 përcaktohet se “Kandidatët e përzgjedhur, do të kryejnë testimin me shkrim dhe intervistën para strukturave të caktuara paraprakisht nga palët”. Ky është një bashkëpunim me një strukturë që nuk ishte krijuar ende dhe nuk është detyrim i MB të shprehet për këtë, por i MAS<sup>103</sup>, si ministri përgjegjëse për arsimin dhe OS.
- ✓ Referuar pikës 1, pikës 2 dhe pikës 5 të nenit 24 të Ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ndryshuar, institucionet e administratës shtetërore bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me institucionet e tjera shtetërore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e bashkëpunimit për secilën nga format e parashikuara në pikën 2 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave<sup>104</sup>”.
- ✓ Sipas pikës 10 të nenit 6 të marrëveshjes “Oficeri i sigurisë përpilon raporte javore, vjetore dhe të situatës / incidentit, të cilat do t’ia dërgojë Zyrës për Koordinim dhe Monitorim, pranë njësisë arsimore vendore.

Në përgjigjet e dhëna nga eprorët e MAS, citohet se: “Emërtimi i kësaj strukture “zyrë” është vendosur në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, me qëllim caktimin e pikave të kontaktit për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu, kjo zyrë është ngritur nisur dhe nga neni 5, i marrëveshjes së sipërcituar, ku parashikohet që aplikimi i hapur dhe procedura e rekrutimit për kandidatët për oficerë sigurie, do të kryhet sipas standardeve të vendosura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në kohën e nënshkrimit të marrëveshjes). Që nga momenti i ngritjes dhe strukturimit të ZKM nuk janë raportuar raste ankesash për mosfunksionimin e zyrës për shkak të emërtimit. ZKM ka ushtruar të gjitha detyrat, sipas urdhrit të miratimit dhe kuadrit ligjor në fuqi. Në rast se shihet e arsyeshme dhe nga strukturat e politikave, për ndryshimin e emërtimit të kësaj strukture, jemi dakord që mund të merren në konsideratë rekomandimet e grupit të auditit të KLSH-së. Pasi koncepti

<sup>101</sup>Përgjigje pyetësi ASCAP

<sup>102</sup> Shkresë nr. 1106 prot., datë 15.06.2024

<sup>103</sup> “Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike””.

<sup>104</sup> Ligj nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

“Zyrë” nuk parashikonte mundësinë e krijimit të një strukture organizative në kuptimin formal, ajo është konceptuar si një grup pune i ngritur me urdhër të ministrit, por që ka në përbërjen e tij përfaqësues nga të gjitha drejtoritë MAS, por edhe nga institucionet e varësisë si: AKAP dhe ASCAP, që janë struktura të cilat mundësojnë koordinimin dhe monitorimin/vlerësimin e sistemit arsimor parauniversitar, zbatimin e politikave ndër të cilat është edhe siguria e institucioneve nëpërmjet OS”.

Referuar sa më sipër, lidhur me raportimin e ankesave që nga momenti i ngritjes dhe strukturimit të ZKM-së, duhet theksuar se shumë prej DRAP-ve, ZVAP-ve edhe OS-të nuk kishin dijeni për ekzistencën dhe funksionimin e saj. Në këtë kontekst, është e kuptueshme pse nuk ka pasur ankesa që lidhen me rolin dhe funksionin e saj, pasi mungesa e informacionit e ka bërë të pamundur adresimin e tyre.

Në konkluzion, konstatohet se emërtimi “Zyrë koordinimi dhe monitorimi” në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, referuar marrëveshjes nuk është korrekt dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi:

- Në pikën 6 të nenit 4 të marrëveshjes përcaktohet bashkëpunimi midis Akademisë së Sigurisë dhe ZKM në MAS, bashkëpunim mbi një strukturë që nuk ishte krijuar ende dhe nuk është detyrim i Ministrisë së Brendshme të shprehet për këtë, por i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.<sup>105</sup>

- Zyra e Koordinimit dhe Monitorimit të zbatimit të Marrëveshjes nuk përfaqëson një strukturë të posaçme, brenda strukturave aktuale të ministrisë përgjegjëse për arsimin apo institucioneve të saj të varësisë si dhe nuk përfshihet as në rregulloren e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Disa Drejtori Rajonale të Arsimit Parauniversitar/Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar nuk kanë informacion për ekzistencën e Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit, pasi dhe komunikimi midis tyre nuk është shumë funksional.

#### ➤ ***Procedurat, koordinimi dhe raportimi i ZKM për punësimin e OS***

Një nga detyrat e ZKM është hartimi i kritereve të punësimit dhe procedurave të aplikimit në koordinim me AKAP, DPPSH dhe AS. Nga informacioni i vënë në dispozicion, MAS, nëpërmjet shkresave drejtuar AKAP (ish-DPAP), konkretisht: shkresa me nr. 1595 Prot., datë 17.03.2021 “Për procedurat e emërimit të oficerëve të sigurisë” dhe shkresa me nr.5979/2 prot., datë 29.9.2022 “Për zbatimin e procedurave të emërimit të oficerëve të sigurisë”, përcakton procedurat që do të ndiqen për vendet e lira të punës që krijohen për pozicionin OS në shkolla.

Për periudhën objekt auditimi 2021-2022, me Urdhrin nr. 542, datë 15.09.2022 “Për përcaktimin e IAP të cilat do të kenë oficer sigurie”, u përcaktuan gjithsej 150 shkolla. Ky urdhër është shfuqizuar me Urdhrin nr. 589/2024, ku u përcaktuan 271 shkolla, të cilat do ta kenë këtë shërbim<sup>106</sup>.

Me urdhrin nr. 598, datë 5.10.2022 “Për përcaktimin e mënyrës dhe afatit të dorëzimit të dokumentacionit, si dhe për procedurat e konkurrimit për pozicionin vakant të oficerit të sigurisë në IAP publik”, u përcaktuan zyrtarisht procedurat e emërimit, afatet kohore, institucionet përgjegjëse, fazat e konkurrimit, intervistat, shpallja e rezultateve dhe mënyra e komunikimit të tyre, për emërimin e OS.

Miratimi i urdhrin të sipërpërmendur, vendosi një standard ligjor, që çoi në institucionalizimin e procesit dhe koordinimin ndërinstitutional midis aktorëve në proces (AKAP, ASCAP, AS, DRAP dhe ZVAP). Publikimi i kritereve dhe procedurave do të bëhet në faqen zyrtare web të MAS.

<sup>105</sup> Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”.

<sup>106</sup>Urdhri nr. 589, datë 03.12.2024 “Për përcaktimin e IAP të cilat kanë shërbimin e sigurisë publike”.

Me shkresën nr. 5979/2 prot., datë 29.09.2022 të MAS drejtuar AKAP, kërkohet lista e IAP publike që kanë nevojë për oficerë sigurie, proces i cili duhej të përfundonte më datën **03.10.2022**.

Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion, paraqitja e dokumenteve të kandidatëve konkurrues do të bëhej brenda datës 17.10.2022, me postë ose dorazi në MAS dhe lista e tyre i përcillet AS brenda datës **03.11.2022**.<sup>107</sup>

Drejtoria e burimeve njerëzore në MAS, me shkresën nr. 7458 prot., datë 09.11.2022 ka dërguar në AS listën e kandidatëve fitues për OS në IAP publike. Shkresa duhej të dërgohej në dt. 03.11.2022 por është dërguar më dt. 09.11.2022, jashtë afateve kohore të përcaktuara. Akademia e Sigurisë me shkresën nr. 3174/1 prot., datë 30.12.2022 dërgon në MAS rezultatet përfundimtare të testimit me shkrim të Kursit “OS në shkolla publike”.

Në vijim, për periudhën objekt auditimi 2022-2024, MAS me shkresën nr. 98/2 datë 20.01.2023 dërgon në AKAP shkresën “Për punësimin e oficerëve të sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar publik”.

Me shkresën nr. 98/5 prot., datë 28.02.2023, MAS ridërgon përsëri në AKAP shkresën për vijimin e punësimit të OS në institucionet arsimore parauniversitare publike për oficerët që kanë mbetur të papunësuar dhe për punësimin e tyre të zbatohen procedurat e përcaktuara në shkresën nr. 1595 prot., datë 17.03.2021 të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Në vijim, MAS ka dërguar në AKAP (ish-DPAP) shkresën<sup>108</sup> ku kërkohet përditësimi i listës së OS në shkolla. DRAP Durrës, Fier, Korçë dhe Lezhë, lidhur me këtë përditësim, kthejnë përgjigje për informacionin e kërkuar, me shkresat përkatëse<sup>109</sup>.

Siç vihet re nga komunikimi shkresor përshkruar më sipër, por dhe nga auditimi në terren, procesi i përditësimit dhe emërimit të OS kthehet në një proces zinxhir që bëhet me thirrje me afate kohore të pacaktuara. Ky fakt bie në kundërshtim me VKM nr. 600/2018 ku në pikën 6 të tij përcaktohet se “Marrëdhëniet e punës së oficerëve të sigurisë fillojnë pas përfundimit me sukses të trajnimit pranë Akademisë së Sigurisë dhe rregullohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës”. Gjithashtu ky proces krijon zvarritje dhe mosfinalizim të tij duke cënuar mbarëvajtjen e sigurisë në shkolla. Mungon koordinimi ndërinstitutional, pasi menaxhimi i marrëveshjes pranë MAS duhet të bëhet nga ZKM, si struktura përgjegjëse për këtë proces.

Nga ana e MAS/ZKM, si dhe e AKAP dhe DRAP, mungon një procedurë e rregullt dhe e mirëpërcaktuar, që të zhvillohet një herë në vit ose çdo gjashtë muaj, për të cilën të jenë të informuar edhe kandidatët e interesuar. Si pasojë e thirrjeve të papërcaktuara, ka mjaft raste të shumta kur OS emërohen në pozicionet e tyre, por më pas japin dorëheqje për t’u regjistruar në portalin 'Mësues për Shqipërinë' dhe emërohen si mësues.

Referuar pikës 12 të shkresës nr. 1595/2021<sup>110</sup> “Dokumenti për procedurat e punësimit, ruhet në drejtorinë e shkollës dhe në DRAP dhe është objekt inspektimi”.

<sup>107</sup> Paraqitja e dokumenteve do të bëhej brenda datës 17.10.2022, me postë ose dorazi në MAS.

Verifikimi paraprak i dokumentacionit do të bëhej nga 19.10.2022-21.10.2022.

Bëhet publikimi i listës për kandidatët që do të vazhdojnë fazën vijuese.

Njoftimi i kandidatëve të kualifikuar dhe skualifikuar do të bëhet brenda datës 21.10.2022.

Pas ankimeve më datën 26.10.2022 në faqen zyrtare të MAS web, do të bëhet shpallja përfundimtare e listës së kandidatëve dhe afati i intervistës, i cili publikohet në faqen e MAS.

ZKM në MAS shpallë fituesit në faqen zyrtare të MAS brenda datës 02.11.2022.

Njoftimi bëhet individual elektronikisht.

Lista i përcillet AS brenda datës 03.11.2022.

<sup>108</sup> Shkresa nr. 1595 Prot., datë 17.03.2021 “Për procedurat e emërimit të oficerëve të sigurisë”

<sup>109</sup> DRAP Durrës shkresa nr. 456/13 datë 10.03.2023, DRAP Lezhë shkresa nr. 3078 prot., datë 19.10.2023, DRAP Korçë shkresa nr. 1581/1 Prot., datë 18.10.2023 dhe DRAP Fier shkresa nr. 1107/1 prot., datë 16.10.2023..

ZVAP dhe drejtoritë e shkollave kanë kontratat e punës si dhe njoftimin zyrtar të MAS nga AKAP (ish DPAP), por siç e përmendëm më lart, gjithçka bëhet me afate kohore të pacaktuara dhe ky proces nuk monitorohet nga asnjë strukturë përgjegjëse. Oficerët e sigurisë në shkolla nuk monitorohen as nga drejtuesit e IAP as nga strukturat përkatëse në AKAP dhe DRAP.

Në mungesë të monitorimit nga strukturat përkatëse, si në IAP ashtu edhe në DRAP dhe ZVAP, nuk ekziston një pasqyrë e qartë mbi statusin e punësimit të tyre. Kjo reflekton mungesën e një mekanizmi të qëndrueshëm monitorimi dhe koordinimi ndërinstitucional ndërmjet MAS, ZVAP-ve, shkollave, prindërve dhe komunitetit, duke penguar ndërtimin e një kulture të qëndrueshme sigurie.

Referuar në sa më sipër, vihet re se gjatë periudhës 2021-2022, koordinimi i punës midis MAS dhe AKAP për emërimin e OS ka qenë shkresorë dhe jo i institucionalizuar, me procedurë dhe afate kohore të papërcaktuara.

Gjatë kësaj periudhe, Zyra e Koordinimit dhe Monitorimit të marrëveshjes, nuk ka të dokumentuar raportim të eprorët, përjashtuar MEMO nr. 98/1 prot., datë 20.1 2023 dërguar Sekretarit të Përgjithshëm në MAS ku bën me dije ecurinë e procesit për punësimin e kandidatëve. Nga 128 kandidatë të kualifikuar nga faza e parë, janë kualifikuar për të vijuar punësimin 118 prej tyre, deri në këtë periudhë.

Me Urdhrin nr. 592, datë 06.12.2024 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 589, datë 03.12.2024 “Për përcaktimin e IAP të cilat kanë shërbimin e sigurisë publike”, shërbimi i sigurisë publike u ofrua në 276 shkolla.

Me Urdhrin nr. 593, datë 06.12.2024 “Për shpalljen e vendeve vakante për OS në IAP publik”, u përcaktuan procedurat për emërimin e OS në shkolla, të cilat do të fillonin me paraqitjen e dokumenteve brenda datës 18.12.2024, me postë ose dorazi në MAS dhe do të përfundonte brenda vitit 2024<sup>111</sup>.

Me shkresën nr. 282 prot., datë 15.01.2025, Drejtoria e BNP ka dërguar në DPPSH dhe AS listën e kandidatëve fitues që do t’i nënshtrohen trajnimit dhe certifikimit, jashtë afateve të përcaktuara kohore. Në vijim, AS, me shkresën nr. 141/2 prot., datë 27.01.2025, drejtuar DPPSH-së, me objekt: “Mbi verifikimin e listës së kandidatëve të OS-ve në IAPP që i nënshtrohen trajnimit dhe certifikimit”, ka kërkuar informacion mbi përshtatshmërinë e personelit të OS-ve të paraqitur nga MAS.

Lidhur me pretendimin e sipërcituar, gjykojmë se nga ana e MAS/ZKM, në përcaktimin e afateve kohore për procesin e verifikimit të pastërtisë së figurës së kandidatëve për OS (vërtetimi i besueshmërisë) për vitin 2024–2025, nuk janë marrë në konsideratë afatet ligjore dhe procedurale që i nevojiten DPPSH-së për kryerjen e verifikimeve të plota.

Nga ana tjetër, edhe vetë DPPSH ka pasur vonesa në përpunimin e kërkesave, çka ka ndikuar drejtpërdrejtë në zvarritjen e procesit të verifikimit të kandidatëve. Kjo situatë, e përkeqësuar nga mungesa e një koordinimi të qartë ndërinstitucional ndërmjet MAS/ZKM dhe DPPSH-së, ka reflektuar negativisht në të gjithë procesin e përzgjedhjes dhe certifikimit të OS, duke sjellë vonesa të pajustificuara në realizimin e fazave të mëtejshme të procedurës.

- 
- ✓ <sup>111</sup> Paraqitja e dokumenteve do të bëhet brenda datës 18.12.2024, me postë ose dorazi në MAS.
  - ✓ Verifikimi paraprak i dokumentacionit do të bëhet nga 19.12.2024-23.12.2024.
  - ✓ Bëhet publikimi i listës për kandidatët që do të vazhdojnë fazën vijuese.
  - ✓ Njoftimi i kandidatëve të kualifikuar dhe skualifikuar do të bëhet brenda datës 24.12.2024
  - ✓ Pas ankimeve më datën 27.12.2024 në faqen zyrtare të MAS web, do të bëhet shpallja përfundimtare e listës së kandidatëve dhe afati i intervistës, i cili publikohet në faqen e MAS.
  - ✓ ZKM në MAS shpallë fituesit në faqen zyrtare të MAS dy ditë pas përfundimit të intervistës.
  - ✓ Njoftimi bëhet individual elektronikisht.
  - ✓ Lista i përcillet AS brenda dy ditëve kalendarike pas shpalljes fitues

Në informacionin e vënë në dispozicion nga DPPSH citohet se: “.....Për parandalimin e ngjarjeve, uljen e dinamikës së incidenteve, përmirësimin e situatës, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, etj, numri aktual i OS në shkolla nuk i përgjigjet dinamikës në rritje.

Numri i oficerëve të sigurisë në shkolla, nuk është i mjaftueshëm dhe duhet të mbulohet me shërbim të tillë çdo institucion arsimor me mbi një numër të caktuar nga vetë drejtoria arsimore. Duhet të vendosi drejtoria arsimore rajonale se cila shkollë ka nevojë për oficerë sigurie, jo siç janë përcaktuar nga Ministria e linjës që mbulohen me oficer sigurie vetëm shkollat me një numër të caktuar nxënësish (500). Bile disa shkolla kanë nevojë të mbulohen me më shumë se një oficer sigurie.

Duhet theksuar se performanca e oficerëve të sigurisë në shkolla nuk i përgjigjet situatës në nivelet e kërkuara për të garantuar në maksimum sigurinë në shkolla dhe nuk vihet re në të gjitha rastet të zbatohen njohuritë e përfuara nga trajnimet policore në kohën e certifikimit të tyre, për protokollin, procedurën dhe mënyrën e kryerjes së detyrës, në garantimin e sigurisë në shkolla.

Theksojmë se në disa raste kanë ndodhur ngjarje me pasoja të cilat janë trajtuar nga OS dhe Policia e Shtetit, por vihet re që bashkëpunimi ka çeduar ndërmjet hallkave të OS dhe SPZ-së, sepse njoftimi është përcjellë në momentin kur janë bërë evidente pasojat e situatës dhe jo kur ka filluar krijimi i situatës.....”.

Referuar në sa më sipër, si dhe nga auditimi në terren, problematikat lidhur me oficerin e sigurisë dhe sigurinë në shkolla janë të shumta. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se raportimi tek ministri është bërë vetëm një herë me MEMO nr. 98/1 prot., datë 20.1 2023 dërguar sekretarit të përgjithshëm në MAS, edhe pse referuar shkronjës e) tek urdhri i ministrit ZKM duhet të raportoj dy herë në vit lidhur me ecurinë e marrëveshjes. MAS/ZKM nuk ka ndonjë dokumentacion për mbledhje të përbashkëta të dokumentuara ZKM, sa herë është mbledhur ky grup për të marrë vendime kolegjiale, apo për të vendosur për menaxhimin e zinxhirit të proceseve të punësimit dhe koordinimit të OS, referuar marrëveshjes.

Me miratimin e në fazën e përgatitjes së Projektraportit, të Urdhrit nr. 280, datë 26.6.2025 “Për përcaktimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për oficerët e sigurisë në shkolla”, kompetencat e ndjekjes së procedurave të punësimit, të cilat zbatohen nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar përkatëse i kalojnë Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, pasi ky urdhër shfuqizon Urdhrin nr. 541, me të cilin krijohet Zyra e Koordinimit dhe Monitorimit të zbatimit të Marrëveshjes, në ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

#### ➤ *Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP)*

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, AKAP, krijuar me VKM nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, ka për mision kryesor të ofrojë shërbim cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit. AKAP organizon punën e tij në menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe të koordinojë administrimin e burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar publik, sipas legjislacionit në fuqi<sup>112</sup>.

Bazuar në sa më sipër AKAP në koordinim me ZKM, DRAP dhe ZVAP është pjesë e procedurave të emërimit dhe punësimit të OS në shkolla.

---

<sup>112</sup> VKM nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.

Grupit të auditimit iu vunë në dispozicion katër raporte vlerësimi të AKAP me disa ZVAP-e, respektivisht me shkresat: nr. 405/8, datë 23.02.2024 për gjimnazin “5 Tetori”, ZVAP Kuçovë; nr. 405/10, datë 23.02.2024 për gjimnazin “Kristaq Çapo”, ZVAP Berat; nr. 405/4, datë 23.02.2024 për gjimnazin “Muhamer Janina”, ZVAP Dimal, Kuçovë, si dhe raporti i vlerësimit për procedurat lidhur me OS në shkolla.

Nga raportet e sipërpërmendura, vihet re se AKAP nuk ka pasur komunikim të vazhdueshëm brenda afateve kohore të përcaktuara me DRAP dhe ZVAP, për procedurat e emërimit dhe monitorimit të punës së OS. Përfunduar dhjetorin e vitit 2024, ku AKAP ka kryer inspektime në disa shkolla,<sup>113</sup> nuk dokumentohet ndonjë monitorim i kryer prej tyre lidhur me OS. Për periudhën tjetër objekt auditimi AKAP nuk ka kryer monitorime, vlerësime apo inspektime për të organizuar punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi<sup>114</sup>, përfshirë dhe OS, si detyrë funksionale e saj.

Bazuar në pikën 12 të shkresës nr. 1595 Prot., datë 17.03.2021 “Për procedurat e emërimit të oficerëve të sigurisë”, dokumenti për procedurat e punësimit, ruhet në drejtorinë e shkollës dhe në DRAP dhe është objekt inspektimi. Referuar në sa më sipër AKAP nuk ka kryer rregullisht inspektime, pasi GA nuk iu vu në dispozicion ndonjë dokumentacion lidhur me këtë.

AKAP gjithashtu nuk ka siguruar të dhëna nga raportimi i bërë nga proceset e punës së oficerëve të sigurisë, qoftë nga format e raportimit të incidenteve dhe problematikave të ndryshme nëpërmjet një formulari tip raportimi, ashtu dhe nga monitorimi dhe inspektimi i tyre. AKAP, DRAP, ZVAP si institucione përgjegjëse për vlerësimin e jashtëm të cilësisë në shkolla, nuk kanë një raport vlerësimi për kontributin e OS në krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë dhe përreth saj. Gjithashtu, bazuar në nenin 54 të rregullores së IAPU, miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, e ndryshuar, një herë në vit kryhet vlerësimi i brendshëm vjetor i institucionit arsimor, i cili përfshin të gjithë punonjësit arsimorë, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin. Referuar në sa më sipër AKAP nuk ka ndonjë raport monitorimi dhe analiza konkrete për vlerësimin e brendshëm të shkollës, lidhur me OS.

---

<sup>113</sup> Raportin e vlerësimit të AKAP nr. 405/8, datë 23.02.2024 për gjimnazin “5 Tetori”, ZVAP – Kuçovë; Raportin e vlerësimit të AKAP nr. 405/10, datë 23.02.2024 për gjimnazin “Kristaq Çapo”, ZVAP Berat. Raportin e vlerësimit të AKAP nr. 405/4, datë 23.02.2024 për gjimnazin “Muhamer Janina”, ZVAP Dimal, Kuçovë.

- Shkresën nr. 98/2 prot., datë 20.01.2023 të MAS, drejtuar DPAP me lëndë: “Për punësimin e oficerëve të sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar publik”.

- Shkresën nr. 5979/2 prot., datë 29.09.2022 me lëndë: “Për zbatimin e procedurave të emërimit të oficerëve të sigurisë”, drejtuar DPAP.

- Shkresën e MAS nr.6380/1 prot., datë 2.12.2020 “Një ndryshim në shkresën e MASR-së me nr. 6380 prot., datë 26.11.2020 “Për procedurat e emërimit të oficerëve të sigurisë”.

- Raport të AKAP për oficerët e sigurisë.

- Shkresën nr. 456/13 prot., datë 10.03.2023 të AKAP me lëndë: “Për njoftimin dhe zbatimin e procedurave të emërimit të oficerëve të sigurisë”

- Shkresa nr. 2084 prot., datë 16.10.2023 të DRAP Durrës me lëndë: “Dërgojmë informacion për OS”.

- Shkresa nr. 1107/1 prot., datë 16.10.2023 me lëndë: “Lista e përditësuar e oficerëve të sigurisë”.

- Shkresa nr. 1581/1 prot., datë 18.10.2023 të DRAP Korçë me lëndë: “Lista e përditësuar e Oficerëve të Sigurisë”.

- Shkresa nr. 3078 prot., datë 19.10.2023 të DRAP Lezhë me lëndë: “Lista e përditësuar e Oficerëve të Sigurisë”.

- Shkresa e MAS nr. 1595 prot., datë 17.03.2021 me lëndë: “Për procedurat e emërimit të oficerëve të sigurisë”.

<sup>114</sup> VKM nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar

- Shkresa nr. 3601/6 prot., datë 14.11.2024 të AKAP, me lëndë: “Informacion për procedurat e punësimit të oficerëve të sigurisë, nëntor 2024”.

➤ **Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP)**

Oficerët e sigurisë në shkolla deri në vitin 2023 e kanë zhvilluar veprimtarinë e tyre profesionale bazuar në instrumente jo zyrtare dhe dokumentimi i punës së tyre si një element mjaft i rëndësishëm i procesit për sigurinë në institucionet arsimore, ka lënë për të dëshiruar. Me miratimin e Udhëzuesit për Praktikën e Punës së Oficerëve të Sigurisë, u krijua një kornizë konceptuale e hapësirës profesionale të kësaj strukture brenda institucionit arsimor. Ky dokument është hartuar duke u mbështetur në përvojën praktike të oficerëve të sigurisë që nga fillimi i funksionimit të këtij shërbimi, në praktikatat ndërkombëtare, si dhe në nevojat e identifikuar të punonjësve, në përputhje me rolin e tyre në institucionet arsimore (IA).

➤ **Zhvillimi profesional dhe trajnimi i OS.**

Me miratimin e udhëzuesit të mësipërm, janë përcaktuar objektivat e përgjithshëm, të detajuar dhe treguesit përkatës lidhur me OS. Janë miratuar planet e punës së ASCAP për periudhën 2021-2024, respektivisht me: Urdhrin nr. 48, datë 07.02.2022 , Urdhrin nr. 42 datë 24.01.2023 , Urdhrin nr. 42 datë 15.01.2024.

Drejtoria e Vlerësimit të Cilësisë, ASCAP, në përmbushje të detyrave të saj funksionale, në vitin 2020, ka hartuar Paketën e vlerësimit të Cilësisë së Shkollës, e miratuar me Urdhrin nr. 268, datë 28.08.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit e Rinisë. Në kornizën e vlerësimit të cilësisë së Shkollës<sup>115</sup>, është përcaktuar fusha e cilësisë “Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve” ku, një ndër treguesit e cilësisë për të cilin vlerësohet shkolla është: “Oficeri i sigurisë kontribuon në krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë dhe përreth saj”. Ky tregues është objekt vlerësimi si nga institucionet vlerësuese të jashtme (ASCAP, AKAP, DRAP, ZVAP) po ashtu edhe në vlerësimin e brendshëm të shkollës, e cili realizohet çdo vit nga shkolla.

Nga auditimi në terren u konstatua se shumica e oficerëve të sigurisë në shkolla nuk kishin eksperiencë dhe vjetërsi pune minimumi 5 vjet dhe shumë prej tyre e kishin fillimin e karrierës profesionale në këtë pozicion.

Në përgjigjet e pyetësorëve të ardhura nga institucionet e varësisë thuhet se zhvillimi i vazhduar profesional organizohet çdo vit, përfshin të gjithë punonjësit dhe është i fokusuar në fushën e veprimtarisë së oficerëve të sigurisë në shkolla. Konkretisht ky zhvillim profesional i tyre fokusohet në: Praktika e punës së oficerit të sigurisë, abuzimi seksual, komunikimi, vetëvlerësimi, menaxhimi i stresit, aftësitë psiko-sociale të oficerit të sigurisë dhe ndihma e parë psikologjike.

Programi i trajnimit të oficerëve të sigurisë është hartuar nga Akademia e Sigurisë dhe kjo kryen formimin fillestar të tyre, por është ASCAP<sup>116</sup> institucioni që merret me zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë, përfshirë dhe oficerët e sigurisë. Në kushtet e rritjes së dinamikës së incidenteve, apo problematikave që shfaqen përditë në IAP, ASCAP nuk ka zhvilluar trajnime dhe në fusha të tjera në përputhje me standardet e sigurisë në shkolla.

Referuar në sa më sipër, në informacionin e ardhur nga DPPSH vihet në dukje se është i nevojshëm trajnimi e kualifikimi i oficerëve të sigurisë në vijimësi në varësi të problematikave që shfaqen.

Përveç të tjerash, në raportet e paraqitura për vitet 2021-2024, ASCAP<sup>117</sup> ka përcaktuar si sfida trajnimin e oficerëve të sigurisë mbi mënyrat e raportimit dhe të dokumentimit të punës

<sup>115</sup> <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/05/7-Mars-2020-Korniza-e-vleresimit-te-cilesise-se-shkollës-1-1-1.pdf>

<sup>116</sup> VKM nr. 98, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të cilësisë së arsimit parauniversitar”( ASCAP); Pika b) Paragrafi II, Paragrafi III

<sup>117</sup> Raportet e punës së ASCAP, vitet 2021-2024

së tyre, hartimin e politikave dhe programeve për shkollat përsa i përket disiplinimit pozitiv, menaxhimit të konfliktit, menaxhimit të klasës, menaxhimit të sjelljes, mendimit kritik, etj, por nuk kanë kryer ndonjë trajnim të mirëfilltë për OS.

Nga informacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se ASCAP, në kuadër të punës kërkimore, studimore dhe bashkëpunimit me institucione të arsimit të lartë apo të tjera, ka realizuar analiza dhe raporte vjetore mbi punën e oficerëve të sigurisë. Janë përcaktuar instrumentet matës dhe është kryer vlerësimi i performancës së tyre. Megjithatë, këto gjetje nuk janë shoqëruar me ofrimin e një ekspertize të plotë për strukturat politike, vendimmarrëse dhe aktorët e tjerë përkatës. Po ashtu, mungojnë tryezat e rumbullakëta dhe shpërndarja e këtyre analizave tek strukturat përgjegjëse, çka ka kufizuar mundësinë për përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional. Në dokumentacionin e paraqitur nga ASCAP, nuk evidentohet ndonjë propozim për module trajnimi referuar dinamikës së incidenteve, apo *feed back-ut* nga institucionet e tjera bashkëpunuese dhe koordinuese.

Në përgjigjet e pyetësorëve, eprorët e ASCAP shprehen se: “Nga eksperiencia e deritanishme e oficerëve të sigurisë dhe nga informacionet që janë mbledhur nga terreni vihet re se:

- Në disa zyra arsimore ende procesi i koordinimit të punës së oficerëve të sigurisë nuk është në nivelet e pritura.
- Në disa zyra mungon personi përgjegjës i cili të koordinoj punën e oficerëve të sigurisë apo të mbledhë informacionet që vijnë nga terreni.
- Në disa raste komunikimi dhe bashkëpunimi mes OS dhe Policisë së Shtetit lë për të dëshiruar, fakt ky i vënë në dukje dhe nga DPPSH, lidhur me njoftimin dhe finalizimin e situatës së incidenteve, për parandalimin e tyre, etj”.

Drejtorja e Vlerësimit të Cilësisë, pranë ASCAP, në përmbushje të detyrave të saj funksionale, ka hartuar gjatë vitit 2023 “Manualin e Riskut të Institucioneve Arsimore Parauniversitare”, i cili është miratuar me Urdhrin nr. 317/2, datë 19.05.2020, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Bazuar në këtë manual, oficeri i sigurisë është identifikuar si një faktor risku për sigurimin e mirëqenies së nxënësve në shkollë.

Rritja e incidenteve në shkolla mund të interpretohet si pasojë e mungesës së mekanizmave të mirëstrukturuar për menaxhimin e sigurisë ndër vite, një fushë që ka qenë shpeshherë e nënvlerësuar ose trajtuar në mënyrë të fragmentuar.

Nga monitorimet e kryera nga ASCAP (nëntor 2024 – janar 2025), është vërejtur se oficerët e sigurisë janë perceptuar nga shumica e ZVAP-ve dhe shkollave si faktorë risku dhe mosmarrja parasysh e vetëvlerësimit të oficerit të sigurisë përbën një tjetër element risku që ndikon në cilësinë e menaxhimit të sigurisë<sup>118</sup>. Kjo nuk nënkupton që prania e tyre përbën vetvetiu një rrezik, por tregon se mungesa e trajnimit adekuat dhe e kuptimit të qartë të rolit të tyre mund të shkaktojë paqartësi, tensione ose mosfunksionim të strukturave të sigurisë në shkollë. Ky fenomen është veçanërisht i theksuar në shkollat AML, ku sfidat sociale janë më të thella dhe dinamika më komplekse.

Procesi i vlerësimit të riskut është një nismë e re në sistemin arsimor, i aplikuar për herë të parë gjatë vitit shkollor 2023-2024. Kjo tregon se institucionet janë ende në fazën e përvetësimit dhe zbatimit të vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve në shkolla.

Rritja e incidenteve është një sinjal që duhet interpretuar jo vetëm si problem sigurie, por edhe si tregues për mungesën e përgatitjes profesionale të stafit dhe aktorëve në shkolla për të trajtuar në mënyrë të efektshme incidentet (konfliktet, bullizmin), ndikimet e jashtme apo çështje të tjera të ndjeshme. Oficeri i sigurisë ende nuk konceptohet si pjesë përbërëse e komunitetit shkollor. Ai nuk duhet të konceptohet thjesht si figurë mbikëqyrëse apo “roje”, por si një bashkëpunëtor aktiv në procesin edukues. Ai përfaqëson një hallkë të

---

<sup>118</sup> Përgjigje pyetësori të ASCAP:Në treguesin nr. 7, “Vlerësimi i Brendshëm i shkollës”, mosmarrja parasysh e vetëvlerësimit të oficerit të sigurisë përbën një tjetër element risku që ndikon në cilësinë e menaxhimit të sigurisë

domosdoshme në ndërtimin e një klime të sigurt, edukimin për qytetari, respekt të ndërsjellë dhe bashkëjetesë brenda shkollës.

➤ ***Akademia e Sigurisë (AS)***

Akademia e Sigurisë është përgjegjëse për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të personelit të strukturave të agjencive të tjera ligjzbatuese. Programet e studimit për trajnimin e OS miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin sipas legjislacionit në fuqi, duke respektuar statusin e veçantë të Akademisë së Sigurisë. Kjo Akademi, në bazë të marrëveshjes ndërmjet MAS dhe MB kryen trajnimin dhe certifikimin e oficerëve të sigurisë.

Nga sa konstatohet, nga të dhënat e oficerëve të sigurisë në shkolla, raportet vjetore të ASCAP dhe auditimi në terren, dhuna fizike e cila përllogaritet në shifrat rreth 42.2% është më e përhapur në mjediset e shkollave si dhe në perimetrin jashtë tyre se dhuna psikologjike, e cila përllogaritet në shifrat rreth 13.1%. Gjithashtu dhuna fizike është dhe më pak e menaxhueshme se dhuna psikologjike. Në takimet e zhvilluara në shkolla dhe ZVAP-e konstatohet se dhuna fizike nuk menaxhohet dot nga OS pa praninë e SPZ. Sipas oficerëve të sigurisë mospërballimi i dhunës fizike vjen përveç të tjerash, edhe nga përgatitja jo e mjaftueshme fizike në trajnimet e zhvilluara në Akademinë e Sigurisë.

Në kuadër të marrëveshjes, AS ka ofruar programet e studimit për specializimin e OS në fushën e rendit dhe sigurisë publike dhe ka zhvilluar trajnime me ta, por këto nuk janë azhurnuar referuar dinamikës së incidenteve, apo feed backut nga institucionet e tjera bashkëpunuese dhe koordinuese, gjë e cila do të ndihmonte në përballimin e dhunës fizike.

➤ ***Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH)***

DPPSH është pjesë e zinxhirit të menaxhimit të OS. Për sa i përket listës së kandidatëve fitues që do t'i nënshtrohen trajnimit dhe certifikimit, ka pasur vonesa në përpunimin e vërtetimeve të besueshmërisë, duke ndikuar në realizimin e fazave të mëtejshme të procedurës nga AS.

DPPSH, me shkresën nr. 19/4, datë 13.03.2025, i ka dërguar AS-së listën e plotë të OS-ve së bashku me konfirmimet përkatëse për 84 kandidatë. Siç vërehet nga komunikimi zyrtar, ka një vonesë prej 42 ditësh pune nga data e nisjes së shkresës së BNJ/MAS në drejtim të DPPSH-së, vonesë e cila ka ndikuar në zvarritjen e procesit të verifikimit dhe, për rrjedhojë, edhe në nisjen e procedurës së certifikimit nga AS.

Në komunikimet zyrtare nuk evidentohet një arsyezim i qartë për shkakun e vonesës në këtë proces, gjë që ndikon në llogaridhënien dhe mundësinë për të marrë masa korrigjuese në kohë.

Sipas Urdhrit nr. 17, datë 10.01.2024, “Për rastet, modalitetet dhe strukturat që hartojnë vërtetimin e besueshmërisë”, në kreun V, pika 13, përcaktohet se: “Vërtetimi i besueshmërisë përgatitet brenda 15 ditëve pune nga data e mbërritjes së kërkesës zyrtare në Komisaratin e Policisë”. Ky dokument ka si qëllim verifikimin e pastërtisë së figurës së kandidatit për OS dhe është pjesë e dosjes që administron AS por që kryhet nga DPPSH.

Nga auditimi në terren si dhe përgjigjet e pyetësorëve, eprorët e DPPDH shprehen se, ky shërbim duhet të ofrohet në çdo shkollë, pavarësisht numrit të nxënësve. Drejtoritë arsimore rajonale, që e kanë të qartë situatën në shkollat e tyre, duhet ta vendosin vetë ato dhe jo Ministria e linjës.

Gjithashtu, ata shprehen se performanca e oficerëve të sigurisë në shkolla nuk i përgjigjet situatës në nivelet e kërkuara për të garantuar në maksimum sigurinë në to dhe nuk vihet re në të gjitha rastet të zbatohen njohuritë e përfutuara nga trajnimet policore në kohën e certifikimit të tyre, për protokollat, procedurën dhe mënyrën e kryerjes së detyrës.

Në disa raste kanë ndodhur ngjarje me pasoja të cilat janë trajtuar nga OS dhe Policia e Shtetit, por vihet re që bashkëpunimi ka dështuar ndërmjet hallkave të OS dhe SPZ-së, sepse njoftimi është përcjellë në momentin kur janë bërë evidente pasojat e situatës dhe jo kur ka filluar krijimi i situatës<sup>119</sup>.

**14. Gjetje nga auditimi:** Gjatë periudhës 2021–2024, lidhur me procesin e punësimit të oficerëve të sigurisë në shkolla nuk ka patur një mekanizëm të mirëfilltë monitorimi dhe koordinimi ndërinstitucional ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe aktorëve të tjerë përgjegjës (Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit, Akademia e Sigurisë, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar). Në këtë proces janë tejkaluar afatet ligjore për punësim dhe është raportuar vetëm një herë gjatë periudhës objekt auditimi<sup>120</sup>. Kjo bie në kundërshtim me germën e) të Urdhrit nr. 541, datë 15.09.2022 i Ministrit të Arsimit dhe Sportit<sup>121</sup>, si edhe me pikën 6 të VKM-së nr. 600/2018<sup>122</sup>.

- Në disa shkolla mungojnë oficerët e sigurisë, ndërsa në Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar nuk janë të emëruar koordinatorë përgjegjës për mbikëqyrjen e tyre. Si rrjedhojë, mungojnë personat e ngarkuar si anëtarë të Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit të zbatimit të Marrëveshjes, ose përfaqësues të caktuar nga Zyra Vendore për mbikëqyrjen e praktikës së punës së oficerëve të sigurisë në shkolla.

#### **15. Gjetje nga auditimi:**

- Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, si institucion përgjegjës, nuk ka siguruar të dhëna të strukturuar nga proceset e punës së oficerëve të sigurisë, përmes raportimeve periodike. Nga auditimi rezultoi se, mungonte një formular standard raportimi për incidentet dhe problematikat e evidentuara, i cili do të mundësonte organizimin dhe menaxhimin më efektiv të veprimtarisë së tyre, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

- Oficerët e sigurisë në shkolla u konstatua se nuk monitoroheshin as nga drejtuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar dhe as nga strukturat përgjegjëse si, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar. Këto institucione, të ngarkuara me detyrën e vlerësimit të jashtëm të cilësisë në shkolla, si dhe në kuadër të procesit të vlerësimit të brendshëm të përvitshëm, nuk kanë realizuar asnjëherë vlerësime, analiza apo raporte vjetore që të reflektojnë rezultatet e punës së oficerëve të sigurisë.

**16. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar ka kryer analiza, raporte dhe vlerësimin e punës së oficerëve të sigurisë, por të pashoqëruara me trajnime specifike apo ofrimin e një ekspertize të plotë për strukturat vendimmarrëse dhe aktorët e tjerë të përfshirë në proces<sup>123</sup>. Mungesa e diskutimeve të strukturuar, tryezave të rumbullakëta dhe mos shpërndarja e problematikave në nivelin institucional ka kufizuar propozimet për module trajnime referuar dinamikës së incidenteve, apo *feed back-ut* nga institucionet e tjera aktorë në proces.

<sup>119</sup> Përgjigjet e pyetësorëve nga DPPSH

<sup>120</sup> MEMO nr. 98/1 prot., datë 20.1 2023 dërguar sekretarit të përgjithshëm në MAS.

<sup>121</sup> Urdhri nr. 541, datë 15.09.2022 i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për Ngritjen e zyrës së koordinimit dhe monitorimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”, i ndryshuar

<sup>122</sup> 6. “Marrëdhëniet e punës së oficerëve të sigurisë fillojnë pas përfundimit me sukses të trajnimit pranë Akademisë së Sigurisë dhe rregullohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës”.

<sup>123</sup> VKM nr. 98, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të cilësisë së arsimit parauniversitar”( ASCAP); Pika b) Paragrafi II Paragrafi II, Paragrafi III, si dhe planet e punës, vitet 2021-2024.

**17. Gjetje nga auditimi:** Dhuna fizike në shkolla, si dhe në perimetrin jashtë tyre, është më e përhapur dhe më e vështirë për t'u menaxhuar nga oficerët e sigurisë, pa mbështetje nga strukturat e tjera, si Shërbimi i Policisë së Rendit. Në kuadër të marrëveshjes, Akademia e Sigurisë ka ofruar programet e studimit për specializimin e oficerëve të sigurisë dhe ka zhvilluar trajnime me ta, por këto nuk janë azhurnuar referuar dinamikës së incidenteve, apo *feedback-ut* nga institucionet e tjera bashkëpunuese dhe koordinuese, gjë e cila do të ndihmonte në përbalimin e dhunës fizike.

**18. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk ka respektuar afatin ligjor të përcaktuar në Urdhrin nr. 17, datë 10.01.2024, për lëshimin e vërtetimit të besueshmërisë, duke ndikuar në zvarritjen e procesit të verifikimit dhe trajnimit me vonesë nga momenti i dërgimit të kërkesës nga Ministria e Arsimit dhe Sportit/Zyra e Koordinimit dhe Monitorimit të zbatimit të Marrëveshjes.

**14. Konkluzion:** Komunikimi ndërmjet MAS/ZKM dhe AKAP për punësimin e OS në formë shkresore dhe jo përmes një mekanizmi të institucionalizuar, me procedura dhe afate të përcaktuara, ka sjellë zvarritje e mungesë përfundimi të procesit, duke ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e sigurisë në shkolla. Pamjaftueshmëria e OS në shkolla, mungesa e personit përgjegjës në ZVAP-e i cili të koordinoj punën e oficerëve të sigurisë apo të mbledhë informacionet që vijnë nga terreni, si dhe mungesa e monitorimit të vazhdueshëm nga strukturat përkatëse, bën që të mos ketë një pasqyrë të qartë mbi efektivitetin dhe statusin e punësimit të oficerëve të sigurisë, si edhe mosfunksionimin në kohë ndërmjet hallkave të OS dhe SPZ-së, lidhur me menaxhimin e incidenteve në shkolla, nga momenti i konstatimit deri në zgjidhjen përfundimtare. Kjo situatë pasqyron mungesën e një mekanizmi të mirëfilltë monitorimi dhe koordinimi ndërinstitutional.

**15. Konkluzion:** Mungesa e të dhënave nga raportimet e bëra nga proceset e punës së oficerëve të sigurisë, qoftë nga format e raportimit të incidenteve dhe problematikave të ndryshme nëpërmjet një formulari tip raportimi, ashtu dhe nga monitorimi dhe inspektimi i tyre, mungesa e monitorimit nga drejtuesit e IAP as nga strukturat përkatëse në AKAP, DRAP, ZVAP, si dhe mungesa e analizave dhe raporteve periodike vjetore mbi rezultatet e punës së oficerëve të sigurisë, japin një pasqyrë jo të qartë mbi organizimin e punës për menaxhimin e veprimtarisë së tyre në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**16. Konkluzion:** Mungesa e mekanizmave të mirëstrukturuar për menaxhimin e sigurisë në shkolla, e parë si një fushë që ka qenë shpeshherë e nënvlerësuar ose trajtuar në mënyrë të fragmentuar ka bërë që të rritet numri i incidenteve në shkolla. Rritja e incidenteve është një sinjal jo vetëm si problem sigurie, por edhe si tregues i mungesën së përgatitjes profesionale të stafit dhe aktorëve në shkolla për të trajtuar në mënyrë të efektshme incidentet, ndikimet e jashtme apo çështje të tjera të ndjeshme. Shpeshherë OS nuk konceptohet si pjesë përbërëse e komunitetit shkollor, si një bashkëpunëtor aktiv në procesin edukues, por thjesht si figurë mbikëqyrëse apo "roje". OS nuk shihet si një hallkë e domosdoshme në ndërtimin e një klime të sigurt, edukimin për qytetari, respekt të ndërsjellë dhe bashkëjetesë brenda shkollës.

**17. Konkluzion:** Në kushtet e sotme, dhuna fizike në shkolla, është më e përhapur se dhuna psikologjike. Kjo lloj dhune është më e vështirë për t'u menaxhuar nga oficerët e sigurisë (OS) pa mbështetje nga strukturat e tjera, si Shërbimi i Policisë së Rendit (SPZ). Pamjaftueshmëria e trajnimeve, mungesa e trajnimit adekuat, përgatitjes fizike dhe e kuptimit të qartë të rolit të tyre mund të shkaktojë paqartësi dhe përbën një rrezik për sigurinë në shkollë. Ky fenomen është veçanërisht i theksuar në shkollat AML, ku sfidat sociale janë më të thella dhe dinamika më komplekse.

**18. Konkluzion:** Mosevidentimi i qartë i shkakut të vonesës në procesin e verifikimit, ndikon në llogaridhënie dhe mundësinë për të marrë masa korrigjuese në kohë. Keqfunksionimi i bashkëpunimit ndërmjet OS dhe SPZ në zinxhirin e menaxhimit të procesit për parandalimin e ngjarjeve dhe incidenteve, sjellin pasoja të rënda për qytetarët.

**14.1 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, të ngrenë një grup pune për të rishikuar marrëveshjen dhe aktet nënligjore lidhur me planifikimin e harmonizuar të afateve kohore për procedurat e emërimit, me qëllim shmangien e vonesave dhe thirrjeve me afate kohore të pacaktuara në procesin e certifikimit dhe punësimit të oficerëve të sigurisë.

**Brenda vitit 2026**

**15.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, bazuar në detyrat funksionale, të sigurojë të dhëna dhe të kryejë monitorime, inspektime apo vlerësime për organizimin e punës dhe ndjekjen e veprimtarisë së oficerëve të sigurisë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi<sup>124</sup>, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**16.1 Rekomandimi:** Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar së bashku me strukturat politike dhe aktorët e tjerë të përfshirë në proces, të marrë masat për:

- Organizimin e trajnimeve të detyrueshme dhe ofrimin e ekspertizës së plotë për përgatitjen e oficerëve të sigurisë, jo vetëm në aspektin teknik, komunikim, etj, por dhe referuar dinamikës së incidenteve, apo feedback - ut nga institucionet e tjera.
- Organizimin e diskutimeve të strukturuar, si tryezat të rrumbullakëta, takime institucionale dhe ndërinstitucionale për shpërndarjen e problematikave në të gjitha nivelet, me synim përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit midis tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**17.1 Rekomandimi:** Akademia e Sigurisë në bashkëpunim me strukturat e tjera ligjzbatuese, si Shërbimi i Policisë së Rendit dhe Ministria e Arsimit/Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, të marrin masat për të përmirësuar nivelin e trajnimeve praktike dhe përgatitjes fizike, duke përfshirë simulime dhe trajnime të specializuara për menaxhimin e situatave të dhunës fizike, në shkolla dhe perimetrin jashtë tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**18.1 Rekomandimi:**

-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masat për të respektuar afatin ligjor për lëshimin e vërtetimit të besueshmërisë.

-Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim Ministrinë e Arsimit/Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, të marrin masa për të forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet oficerëve të sigurisë dhe Shërbimit të Policisë së Rendit, Specialistëve të Policimit të Zonës, për të siguruar reagime të shpejta dhe të koordinuara ndaj incidenteve, ndërhyrje të menjëhershme në rast të situatave emergjente në përmirësim të menaxhimit të sigurisë në shkolla.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

---

<sup>124</sup> VKM nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar

**Me shkresën nr. 2256/4 prot., datë 24.07. 2025** (shkresa nr. 126/9 prot., datë 25.07.2025, sipas protokollit të KLSH) **Ministria e Arsimit dhe Sportit, ka përcjellë këto observacione:**

➤ **Lidhur me Rekomandimin 14.1 të Projektraportit:**

Është miratuar urdhri nr. 280, datë 26.6.2025 “Për përcaktimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për oficerët e sigurisë në shkolla”.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Me miratimin e në fazën e përgatitjes së Projektraportit, të Urdhrit nr. 280, datë 26.6.2025 “Për përcaktimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për oficerët e sigurisë në shkolla”, kompetencat e ndjekjes së procedurave të punësimit, të cilat zbatohen nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar përkatëse i kalojnë Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, pasi ky urdhër shfuqizon Urdhrin nr. 541, me të cilin krijohet Zyra e Koordinimit dhe Monitorimit të zbatimit të Marrëveshjes, në ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Rrjedhimisht nga grupi i auditimit, gjetja 14.1 kalohet si konkluzion në pjesën narrative të raportit, meqë një pjesë e rekomandimit të lënë më herët nuk ka fushë zbatimi, pas ndryshimit ligjor.

Ndryshimi u reflektua në Raport dhe **observacioni merret në konsideratë**, vetëm për sa më lart.

➤ **Lidhur me Rekomandimin 16.1 të Projektraportit:**

“Zhvillimi i vazhduar profesional i oficerëve të sigurisë është i përvitshëm dhe fokusohet tek fusha e veprimt të oficerëve të sigurisë në shkolla ku përfshihen të gjithë punonjësit. Oficerët e sigurisë në shkolla janë trajnuar për tematikat si më poshtë vijon:

- Praktika e punës së oficerit të sigurisë
- Abuzimi seksual
- Komunikimi
- Vetëvlerësimi
- Menaxhimi i stresit
- Aftësitë psiko-sociale të oficerit të sigurisë
- Ndihma e parë psikologjike”.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Grupi i auditimit vëren se mungesa e diskutimeve të strukturuar, tryezave të rrumbullakëta dhe mos shpërndarja e problematikave në nivelin institucional ka kufizuar propozimet për module trajnimi referuar dinamikës së incidenteve, apo *feed back-ut* nga institucionet e tjera aktorë në proces, ndaj ajo që rekomandohet ka në fokus pikërisht këto aspekte.

Rrjedhimisht, **observacioni nuk merret në konsideratë**.

**Me shkresën nr. 1777/1 prot., datë 28.07. 2025** (shkresa nr. 126/10 prot., datë 04.08.2025, sipas protokollit të KLSH) **Akademia e Sigurisë, ka përcjellë sa më poshtë:**

➤ **Lidhur me Rekomandimin 17.1 të Projektraportit:**

“Në Akademinë e Sigurisë, deri në momentin e programit të Auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, nr. 126/4, datë 03.04.2025, në zbatim të marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 6068, datë 01.06.2018, “Për oficerët e Sigurisë në Shkollat Publike”, **nga ana e MAS nuk ka pasur asnjë kërkesë për**

***përmirësim apo rishikim të kurrikulës.***

Megjithatë nga ana e Akademisë së Sigurisë është rishikuar 2 herë programi i parë “Për trajnimin e oficerëve të sigurisë në shkollë”, miratuar me urdhër të Drejtorit/ Rektorit të Akademisë së Sigurisë nr. 79, datë 21.02.2018, që përmbante në total 49 orë mësimore dhe konkretisht:

1. Është miratuar me Urdhrin e Drejtorit/Rektorit të Akademisë së Sigurisë, nr. 55/1, datë 10.01.2019, kurrikula e kursit “Trajnimi i Oficerëve të Sigurisë në Shkollat Publike”, që ka 120 orë mësimore.
2. Rishikuar dhe miratuar me Urdhër të Rektorit të Akademisë së Sigurisë nr. 83, datë 10.02.2025, kurrikula e kursit “Trajnimi i Oficerëve të Sigurisë në Shkollat Publike”, që ka 120 orë mësimore.

Në vijim të bashkëpunimit me MAS, Akademia e Sigurisë me shkresë nr. 1112, datë 07.05.2025. “Kërkesë për bashkëpunim në kuadër të rishikimit të kurrikulës “Trajnimi i Oficerëve të Sigurisë në Shkollat publike”, i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve bashkëpunim dhe vënien në dispozicion të 2 specialistëve të saj me qëllim përmirësimin dhe pasqyrimin e të gjitha problematikave të dala gjatë, pas përfundimit të trajnimit si dhe problematikave të tjera të hasuara nga OS gjatë ushtrimit të detyrës.

Në vijim në ambientet e Kolegjit Profesional të Formimit Policor më datë 11.06.2025, u zhvillua takimi mes përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Kolegjit Profesional të Formimit Policor dhe Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit, ku palët ranë dakord për rishikimin e kurrikulës dhe morën detyrimet për përgatitjen e temave përkatëse sipas fushës që mbulon secili institucion.

Në lidhje me rekomandimin tuaj 17.1, ku kërkohet marrja e masave për të rritur nivelin e trajnimeve praktike dhe përgatitjes fizike përfshirë simulime dhe trajnime të specializuara për menaxhimin e situatave të dhunës fizike, në shkollë, pas dakordësisë me MAS, do të pasqyrohen në kurrikulën e re që po përgatitet nga të 2 institucionet”.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Sa përcjellë nga Akademia e Sigurisë me këtë parashtrim, grupi i auditimi vlerëson se informacioni i dërguar, nuk kundërshton rekomandimin e lënë, por thjeshtë bën një panoramë të hapave të ndërmarrë për një bashkëpunim më të frytshëm me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me synim përmbushjen e rekomandimit të lënë.

**Me shkresën nr. 3772/2 prot., datë 15.08. 2025** (shkresa nr. 126/11 prot., datë 18.08.2025, sipas protokollit të KLSH) **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**, ka përcjellë një informacion i cili në pjesën më të madhe të tij, riprodhon sa dërguar nga Akademia e Sigurisë, rrjedhimisht dokumenti i lartpërmendur nuk konsiderohet observacion, por një shprehje e gatishmërisë për të ndërmarrë hapa me synim zbatimin e rekomandimit 17.1.

Për sa me sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

**KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT**

## V. SHTOJCA 1 - PYETËSOR PËR NXËNËS

(Rezultatet e marra nga përgjigjet e 227 nxënësve, të 10 klasave, të 5 shkollave)

Zona:

- Urbane  
 Rurale

Gjinia:

- Femër  
 Mashkull

Klasa:

- I  
 II  
 III  
 IV  
 V  
 VI  
 VII  
 VIII  
 IX  
 X  
 XI  
 XII

1. Sa jeni të informuar për bazën ligjore të sigurisë në shkollë (Ligjet, Strategjitë, Rregulloret e shkollës, Kodin e mirësjelljes, etj.)?

- a) Shumë mire **132**  
b) Mirë **85**  
c) Pak **9**  
d) Aspak **1**

2. Sa ndjeheni të sigurt?

	Shumë të sigurt	Të sigurt	Të pasigurt	Shumë të pasigurt
Gjatë shkuarjes në shkollë	117	89	7	4
Në shkollë	114	96	9	5
Gjatë kthimit në shtëpi	114	94	10	4

3. Specifikoni shpeshësinë e incidenteve/problematikave gjatë periudhave të mëposhtme?

	Çdoherë	Shpesh	Nganjëherë	Kurrë
Para mësimimit	9	9	76	132
Gjatë mësimimit	4	20	81	119
Gjatë pushimit (orët e lira)	8	27	103	84

Gjatë aktiviteteve shkollore	2	18	57	145
Pas mësimit	12	32	100	87

#### 4. Në cilat hapësira brenda shkollës ndodhin incidente?

	Çdoherë	Shpesh	Nganjëherë	Kurrë
Në hyrje dhe dalje të shkollës	5	28	90	95
Në klasë të zbrazët	5	9	47	148
Në shkallë	3	18	29	154
Në korridor	3	17	67	111
Në laborator	2	12	34	158
Në fushën e sportit	6	25	75	93
Në tualet	4	24	65	106
Në oborr	8	32	80	77
Tjetër (shëno)	-	-	5	15

#### 5. Që nga fillimi i vitit shkollor, sa herë në shkollë keni hasur vështirësitë në vijim?

	Kurrë	Një apo dy here gjatë vitit	Një apo dy here gjatë muajit	Një apo dy here gjatë javës	Çdo ditë
Ju ka shtyrë dhe penguar dikush?	166	42	14	7	2
Ju ka sulmuar fizikisht (goditur)?	178	15	-	-	3
Ju ka kërcënuar dikush?	201	19	2	2	2
Ju ka prekur apo ngacmuar seksualisht?	217	5	1	-	2
Ju ka detyruar dikush që të bëni diçka kundër vullnetit tuaj?	205	12	5	1	4
Ka bërë thashetheme për ju?	113	67	17	12	9
Qeshin me ju dhe ju drejtohen me emra fyes?	174	29	6	4	2
Dikush ka shpërndarë te të tjerët përmes telefonit, internetit informacione apo foto që ju lëndojnë juve?	196	12	1	3	4
Dikush ka thyer qëllimisht diçka që ju takon juve?	201	19	2	1	3

#### 6. Gjatë vitit shkollor a keni bërë këto gjëra ndaj dikujt në shkollën tuaj?

	Kurrë	Një apo dy here gjatë vitit	Një apo dy here gjatë muajit	Një apo dy here gjatë javës	Çdo ditë
Keni shtyrë apo penguar ndokënd?	171	21	1	-	2
Keni sulmuar fizikisht (goditur)?	216	6	2	-	2
Keni kërcënuar ndokënd në qoftë se nuk u jep diçka që është e tij (p.sh para, telefon, etj.)?	217	5	2	-	2

Keni prekur apo ngacmuar ndokënd seksualisht?	220	2	-	1	3
Keni detyruar ndokënd që të bëjë diçka kundër vullnetit të tij?	207	6	1	-	2
Keni bërë thashetheme për të tjerët?	173	25	5	4	3
Jeni tallur me ndokënd dhe i jeni drejtuar me emra fyes?	187	19	2	2	1
Keni shpërndarë informacionet apo fotot e ndokujt tjetër përmes telefonit, internetit?	199	7	-	2	4
Keni thyer apo dëmtuar qëllimisht gjërat e ndokujt?	205	3	-	-	1

**7. A keni vërejtur se në shkollën tuaj nxënësit bartin me vete?**

	Kurrë	Një apo dy herë gjatë vitit	Një apo dy herë gjatë muajit	Një apo dy herë gjatë javës	Çdo ditë
Armë të ftohta	189	36	4	4	5
Armë zjarri	204	5	3	1	2
Drogë	194	13	3	4	3
Alkool	195	10	3	4	4
Duhan	126	36	13	16	24